


398
H 28.



XHA SELIMI I BRATAJT

BARDHOSH GAÇE

388

H 2 P.


BARDHOSH GAÇE

XHA SELIMI I BRATAJT



SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»

**Redaktorë: Agim Shehu
Nexhmije Muça**
**Reçenzentë: Dritëro Agolli
Kozma Vasili
Qemal Haxhihasani**
Kopertina: Pleurat Dervishi



Udhëheqësi i dashur i Partisë dhe i popullit shoku Enver Hoxha,
në kabinetin e punës me xha Selimin, 1947.

**TELEGRAM DËRGUAR FAMILJES SË PATRIOTTIT
SELIM HASANI (BRATAJ)¹**

Brataj-Vlorë

4 dhjetor 1965

Familjes së të ndjerit, patriotit xha Selim,

Mësova me hidhërim lajmin për vdekjen e patriotit dhe rapsodit të shquar, këngëtarit zemërziarr të trimërive legjendare të popullit shqiptar në luftërat për liri e pavarësi kundër pushtuesve të huaj e tradhtarëve të vendit, birit të nderuar të popullit të Vlorës, xha Selimit tonë.

Marr pjesë në pikëllimin e familjes suaj dhe ju dërgoj ngushëllimet e mia të dhimbshme.

Le të jetëjeta e luftëtarit partizan, pjesëmarrësit qysh në ditët e para në Luftën Nacionalçlirimtare, vjershëtorit populor, xha Selimit, një shembull frymëzimi për brezin e ri të vendit tonë!

Le të rrojë kujtimi i tij brez pas brezi në këngët e bukura popullore revolucionare që ai me dashurinë e zemrës thuri tërë jetën e tij për lavdinë e Partisë e të atdheut dhe që sot ia lë trashëgim të vyer popullit të vet që aq shumë e deshi dhe i këndoi.

ENVER HOXHA

1) Enver Hoxha, «Letra të zgjedhura», vëll. 1, f. 132-133.

NDERIM SELIM HASANIT

Poezinë popullore e kanë krijuar ata mjeshtër, të shquar të vargut që ne nuk ua dimë emrat. Ata kanë vëtëm një emër, emrin e popullit poet. Me poezinë udhëton në shekuj shpirti, i tyre i madh, i cili mahnit brezat që vijnë njëri pas tjetrit valë-valë. Herë-herë në këtë udhëtim mes qindra anonimesh, shkëlqen edhe emri i ndonjë poeti që del si kërcu i madh i ndezur, duke e ruajtur të pashuar zjarrin e tij të veçantë.

Njëri nga këta është Selim Hasani nga Brataj i Vlorës. Ai nuk u interesua për emrin, po për këngën. E ngriti këngën dhe e dërgoi nëpër Labëri; kënga hyri shtëpi më shtëpi e stan më stan, fluturoi nëpër çetat, batalionet dhe brigadat partizane; e kënduan djemtë dhe vajzat në shtigjet e lirisë dhe në udhët e revolucionit dhe erdhi kënga gjer në ditët tona. Udhëtoi me këngë në gojë e me dyfek në dorë më 1920-tën, në Luftën e Vlorës, kur Selam Musai «zinte topin nga grika», udhëtoi në Drashovicë më 1943 dhe zuri istikamin, tek vërsheyllen plumbat dhe predhat duke e plagosur rëndë; udhëtoi me partizanët në Kurvelesh, Lunxh, Zagori e Përmet; eci me Brigadën V në Sulovë, Gramsh e Dumre... Prandaj kënga e tij bart erën e kuleve dhe vërsheyllimin e plumbave, gurët e maleve dhe dertet e njerezve, pikëllimin për shokun e vrarë dhe dufin për armikun e mundur, trishtimin për varférinë dhe mallin

për ditët e lumtura, shqetësimin për gërmadhat e lëna nga pushtuesi dhe besimin në revolucionin dhe në socializmin. Me këtë, vargjet e xha Selimit janë dëshmi poetike të ngjarjeve të zakonshme të jetës dhe të ngjarjeve të mëdha historike, ku ishte dhe vetë pjesëmarrës. Këto dëshmi nuk janë regjistrime të thjeshta, por dokumente poetike me një figuracion të pasur të një origjinaliteti të veçantë, me një gjuhë plot lëng, me figura të ndezura, me kundërvënie të papritura e plot lëvizje. Tek i lexon vargjet e tij të duket sikur e ka thithur nektarin e shëndetshëm të gjithë poezisë populllore dhe pastaj, këtë nektar të transformuar përmes sitës së shpirtit të vet, ua ka dhënë këngëve të tij burrërore. Kështu, ai nuk përsërit ato që kanë thënë të tjerët, edhe të bukura të kenë qenë nuk i përsërit. Poeti popullor është krendr. Ai nuk pranon të thotë gjëra të stërhëna. Ato që kanë thënë kolegët e tij anonimë ai i përvetëson që në fëmijëri, siç përvetëson sjelljen, zakonet, mënyrën e jetesës, historinë, kulturën dhe filozofinë populllore. Këngëtar i popullit nuk e mëson këngën kur është bërë burrë me fëmijë, por rritet me këngën që në vegjeli. Pastaj këtë këngë e do si gruan dhe fëmijën. Dhe këngën e përkëdhel si të voglin. Një herë i kam folur xha Selimit për një këngëtar. Ai më dëgjoi i hështur me buzën pak në gaz dhe më tha: «Mirë këndon. Vetëm nuk e përkëdhel këngën. Sikur ta përkëdhelte do të merrte më shumë nam. Eh, kënga! Kjo lanete i do përkëdhelitë si vajza!»

Ta përkëdhelësh këngën nuk do të thotë ta sheqerosësh, por ta duash dhe ta çmosh: të të burojë nga shpirti vëvetiu. Kënga është si e qeshura dhe e qara. Njeriu nuk qesh dhe nuk qan më irdhër. Neve na mannit poezia popullore, pasi këndalë nga shpirti. E qeshura dhe e qara nuk imitojen. Dua të them se Selim Brati këndonte më fjalën dhe zërin e vet. Kjo fjalë është ky zë dallohej nga gjithë të tjerët. Atdheut, Partisë, popullit, bijve dhe bijave të tij ai do t'u këndoje më fjalën e vet të papërsëritshme. Janë të një poetike të rrallë popullore vargjet me patos qytetar, si këto:

E tunde, Parti, e tunde:
Përpara si pak e zure,
Me ca të rralla kobure,
Ca prita, ca mina vure,
Me djemtë e vajzat si nure,
Ato që mbathën potüre,
Me dyfek, me sakature,
Me opinga prej lëkure.

Një poezi lapidarike si këtë, me një origjinalitet të veçantë, me një mendim të qartë e plot lëvizje dhe me fjalë si gurë të rëndë e plot reflekse e ngjyra, nuk mund ta gjesh në poetët e tjerë popullore: ata kanë vulën e tyre, xha Selimi ka vulën e tij. Këtu qëndron edhe bukuria, përndryshe do të kishim monotonë, siç ndodh ndonjëherë në poezinë e kultivuar. Poezia e kultivuar ka variacione metrike në vargje, që nga vargjet tradicionale tetërrokësh, gjashtërrokësh, dhjetërrokësh dhe gjerte vargjet jambikë dhe të lira. Por variacioni i metrit nuk të siguron variacionin e përbajtjes, të mendimit dhe ndjenjës. Mund të përdorësh të gjithë metret dhe mund të mos jesh poet. Është si në pikture. Mund të dish të vizatosh dhe të piktuosh e të mos jesh piktor. Poezia popullore i ka të kufizuar metret e vargut. Shkruhet me gjashtërrokësh, tetërrokësh dhe ndonjëherë me dhjetërrokësh, ose me variantet e tyre. Por ajo është shumë e larmishme, pasi e ka përbajtjen dhe mendimin e larmishëm, pasi e ka brenda shpirtin e madh të popullit, shpirtin shumëshekullor. Këto gjëra xha Selimi nuk i kishte mësuar në shkollë, por i kishte fituar në universitetin e folklorit. Prandaj është nuk pranonte të këndonte vargje standarde, të përsëritura dhe pa fizionomi. Kur ne ia rrëmbenim armët armikut dhe me to e vinim poshtë, Selim Hasani nuk mund të thoshte: «Q. burra, t'ua marrim armët», por do të kushtronte me zërin e tij të pashëmbëllyer, me ndonjë zë tjetër:

Mitralozat me tri këmbë
O djem, t'i martim me dhëmbë!

Për tradhtarët e vendit që u bashkuán me pushtuesit, nuk mund të bërtiste dhe të shante me një gjuhë pa ngjyrë, pasi ajo nuk do të bënte efekt dhe nuk do të mbahej mend. Selim Brati do t'u fliste me gjuhën e poezisë therëse, duke dhënë edhe portretin e tyre, duke i nxjerrë ata nga hotelet ku hanin e pinin për t'ia tre-guar popullit. Ja se cilët janë këta «patriotë»:

Tradhtarët e vatanit
Vijnë rrëth hotel «Ballkanit»,
Shuan verën e dyqanit,
Vozat e Pavllo Bezhani.

Poezinë, Selim Hasani i Bratajt nuk e shkroi, por e këndoi: Botohej a s'botohej, nuk donte të dinte. Shtëpi botuese për të ishin ata që e këndonin. Nuk vinte ai te redaktorët, vñin ata tek ai. Nuk do të rrinte me laps në dorë për t'i kreher vargjet, se as nuk i kishte shkuar ndërmend një gjë e tillë dhe as dinte ta bënte. Siç i vinte fjala, ashtu e thoshte. Fjala e këngës fluturonte dhe ndoshta edhe këngëtarët e tjerë diçka i shtonin. Prandaj herë-herë ka edhe vargje të tepërtë, ka edhe mbingarkesa me njëfarë agijacioni të kohës. Por të gjitha këto pastrohen nëpër botime për të shkëlqyer më tepër xhevahiri. Eshtë e çuditshme se edhe në këngët më të zakonshme shkëlqejnë ndonjëherë vargje të një force të madhe shprehëse. Po jap një shembull. Për të treguar varfërinë e punëtorëve argatë në të kaluarën, ai këndon:

Ku gdhihi, more të mjerë?
Në mullar kini hotelë.

Ose le të marrim tri vargje, ku jepet mundja e arrmive. Poeti na thotë se ja ç'u bëri ideali komunist arrmive:

C'i këpüte bisqe-bisqe,
Mos i nga se i ujdise,
Xhadeve pa gunë i nise.

ose:

Po ballistët nga na vanë,
Festebardhë e mantobranë?

Kënga e Selim Hasanit është anketa e biografisë së tij në mes të ngjarjeve të mëdha të kohës të Luftës Nacionallirimitare, të viteve të para të Çlirimtë dhe të fillimit të marshimit të madh të socializmit. Mes gjithë këtyre ngjarjeve u ngrit kënga e tij dhe në vargje la gjurmë koha e jetuar nga poeti ynë popullor. Edhe sot ne i lexojmë dhe i këndojmë këngët e tij, që ruajnë freskinë dhe ngjyrën e ndezur të luftërave, trishtimeve, gëzimeve dheëndrrave tona. Vargjet e tiju bënë mësim nga shumë poetë popullorë të Labërisë. Ndonjëherë këto vargje merren dhe vihen të pandryshuara nëpër këngët popullore, por ne i kuptojmë se të ç'mjeshtri janë. Edhe po të ishte gjallë, xha Selimit nuk do t'i mbetej hatri, por do të thoshte: «Merrini, bij! Unë për ju i këndova! Pasuria private po të ndahet, pakësohen. Kënga po të ndahet, shtohet!» Jam i bindur që kështu do të thoshte mjeshtri i shquar i vargut popullor!

Selim Brati lindi me këngën, u rrit me këngën, udhëtoi me këngën dhe vdiq me këngën. Kur mbylli sytë përgjithmonë, atij i kënduan mbi trup ligje. Dhe pas vdekjes, kur udhëtarë këngëtar kalon andej nga varri i tij, padashur këndon këngët e xha Selimit. Më 1965, kur vdiq Selim Hasani, shoku Enver në ngushëllimin që i jep familjes së poetit thatë: «Le të rrojë kujtimi i tij brez pas brezi në këngët e bukura popullore revolucionare që ai me dashurinë e zemrës thuri tërë jetën e tij përlavinë e Partisë e të Atdheut dhe

që sot ia lë trashëgim të vyer popullit të vet që aq shumë e deshi dhe i këndoi.¹⁾

Ky trashëgim përherë do të shkëlqejë në valët e mëdha të këngës popullore labe, të këngës gjithmonë në lëvizje dhe në shqetësim, të këngës plot èndrra stërgjyshore që na ngacmojnë dhe na prekin mendjet dhe zemrat, të këngës që është djepi i parë i poetëve që kanë lindur dhel do të lindin. Selim Hasani tani bën gjumin e përjetshëm, por shpirti i tij, i shkrirë në këngët, udhëton. Atje në Brataj, në varrin e tij, thonë se vjen në pranverë mëngjes për mëngjes një zog dhe këndon këngë. Thonë, por këtë zog edhe unë e kam parë. Mbështetë një rastësi. Por edhe rastësi të jetë, përpunhet me të vërtetën...²⁾

Dritëro Agolli

25.03.1984

1) Enver Hoxha, «Letra të zgjedhura», vell. I, f. 132

2) Shih, gazeta «Zëri i Popullit», 30.3.1984.

MJEDISET KU U RRIT SELIM HASANI DHE KËNGA E TIJ

Selim Hasani (Minga) lindi në fshatin Brataj të Lumit të Vlorës, më 30 mars të vitit 1884, në një familje të varfër e atdhetare. I ati i tij, Hasan Minga, gjithë jetën e kaloi staneve duke kullotur bagëtinë. Me arën që kishin te ledhet e konakëve mezi bënin dy muaj bukë në vit. Herë si barë e herë duke djegur kaminat e gëlqeres në malet e Bratit, së bashku me moshatarët e tij, Selimi që në rini provoi të zezat e varfërisë. S'mori dot asnje gërmë shkollë. Babai i Selimit mbahej mend si fjalëpakët, i zgjuar e i matur. Dinte shumë këngë, përralla e histori që kishin ndodhur në Lumin e Vlorës e Kurvelesh. Gdhendte cula dyjare e lugë nga druri i panjës. Vëllai i madh i Selimit, Matoja, ngrinte vargje e bejte, së bashku me nënën, Haxhiken, hignin valle në dasmat e gëzimet e fshatit, Haxhikja ka qenë ndër (vajtojcat) e ligjërueset e gjëmave, e dëgjuar jo vetëm në Brataj, por edhe në krahinën e Mesaplikut.

Qysh në moshën 8-9 vjeç Selim Hasani njihej në fshat si fëmija që dinte t'i binte culës dyjare më mjeshtëri. «Në rini ka pasur zë shumë të mirë, i binte culës dyjare dhe i pëlqenin lodrat; po sidomos tregimet dhe muhababetet e pleqve. Në këtë ambient, ndër shokë e miq, ai mësoi këngët popullore të vendit¹ dhe² u formua si rapsod.»¹ Nuk i kishte mbushur 13-14 vjec,² e filloj të

1) «Rapsodë popullorë», Institut i Folklorit, Tiranë, 1968, f. 5.

2) Po aty.

ngrejë këngë sipas atyre modeleve të këngëve, «thumbave» e të «çpuarave» që kishte mësuar e këndonte në për dasma e kuvendime. Mësoi që herët ngjarje, histori e rrëfime për dëbimin e taksidarëve e të sipërmarrësve të kullotave në Mesaplik e Kurvelesh. Dëgjonte i etur historitë e tregimet e më të mëdhenjve dhe ato i rrëfente aq bukur, saqë bashkëfshatarëve u dukej sikur ngjarja u zhvillohej para syve. Xhaxhai i tij, Shuaip Sakoja, atdhetar i njohtur, kishte vënë re me kohë se si Selimi ua rrëfente figjärjet băshkëmoshatarëve me vargje. Prandaj duke bisseuar edhe me Maton, vendosën që bisedat me Selimin të dy vëllezërit t'i bënин në vargje. Selimi zuri të këndonte që i ri në dasma e gëzime dhe fshatarët e Bratit vunë re se në mes këngëve të njojhura po shfaqeshin edhe disa vargje, të cilat ai i krijonte aty për aty, si vazhdim i logjikshëm i këngës. Kur Matoja e pyeti Selimin përsë e bënte këtë gjë, ai i tha se kështu këngët dalin më të qëlluara për të ndezur muhabetin. I nxitur edhe nga këngët që po ngrinte i vëllai, tok me rapsodët e tjerë të kësaj treve, që në atë kohë ishin të shumtë, si Demir Ago Mystehaku, Tar tar Zeke, Ali Dinoja, Hysxo Salati, edhe Matoja filloi vargjet e tij. Merrte brumë për këngët nga ngjarje e njërrëz të fshatit, nga gëzimet e zënkat që krisnin nëpër mëhallë.

Një mëngjes në fshat u zunë katër bashkëfshatarë dhe Selimit i qëlloi të gjendej në vendin e ngjarjes. Kur shkonte për në lumin e fshatit, xhaxhai e pyeti: «Ç'kemi andej atij mëngjesi?». Ai ia kthëu me vargje aty për aty:

*Xhafer Cania si thump thesi,
iu hodh Beqirit për mesi,
Kanani si ujë avdesi,
Sefedini qe serbesi.*

(domethënë, Xhaferi u grind me Beqirin, Kanani u trembo, Sefedini i ndau).

Aty nga vjeshta e vitit 1900, ai shkoi me nënën te

daja, Halili, i cili që i sëmurë rëndë nga lija. Kur u kthyte në shtëpi, Matoja e pyeti me vargje:

C'bënte dajua inë, atje në Xhublimë?

Selimi iu përgjigj me atë monedhë, humoriz:

I Ziu Halil Hesap, moshë 80 e lart, e vuri lija qebap, i ra lëkura si rrap, pse s'e hoq të bën sevap.

Me shaka e humor, Selimi luan me shokët e tij të fëmijërisë pas bagëtive, në çukat e stërkat e malit të Çekut e në Tranajo. Po asnjëherë ata nuk i zemërohe-shin. Një ditë, duke kullotur dhitë në mal me shokun e tij të fëminisë, Xhafer Canin, që vinte i dobët në trup dhe jetonte si mos më keq, i ngriti këtë këngë:

O Xhafer, more Xhafer, me gazep që kur ke lerë, deje-deje si skifter, s'e ngope barkun njëherë.

Një ditë Selimi thurte opingat me tela te dera e stanit. Vjen dhe e thumbon një shoku i tij, Nuredini, duke i thënë së më mirë pa opinga se me ato, që is'kishte ku ësia kapte qeni. Selimi ia ktheu:
Nuredin, o nuri vetë, bëre sharku fletë-fletë, sikur e kan ngrënë zgërbejtë.

— Selim, mos më se do të më tallin të tjerët! — tha ai. Por Selim Hasani vazhdoi të tijën, t'i shkonte vargut në fund:

Sështë këngë, sështë vas,
të është c'qepur sharku pas,
je bëre si ujku në mars.

U bënë të njohura në këtë kohë këngët: «Moj e bija e nënës» dhe «Mbi shtëpi të shkova prëmë», të kënduara në një dasëm në lagjen Kongolém rrëth viteve 1911-1913, kur nusja po shkonte të dhëndri.

«Në korrik të vitit 1911, kur katërqind kryengritës u nisën nga fshati Brataj nëpër Lumin e Vlorës e Drashovicë, ai, (Selim Hasani — Red.), së bashku me të vëllanë dhe bashkëfshatarë të tjerë, u futën në radhët e tyre e morën pjesë në mitingun e madh të patriotëve të Jugut, tek ura e Drashovicës... Kjo lëvizje antiturke shënoi një ngritje të mëtejshme të ndërgjegjes kombëtare në përgatitjen shpirtërore të popullit për kryengritjen e vitit 1912 dhe ngritjen e flamurit nga Ismail Qemali në Vlorë.»¹⁾

Më 28 nëntor të vitit 1912 Selim Hasani zbriti në Vlorë me bashkëfshatarët në ditën e shenjtë të ngritjes së flamurit. Aty pa me sytë e tij Ismail Qemalin, që i dha «drithë flamurit me shkabë» dhe «bëri të llamit në mes të botës», «ta shohë bota bajrakun tonë». Nga gjëzimi, Selim Hasani dhe fshatarët e tjerë shkuan rrugë më rrugë e sokak më sokak të Vlorës pas flamurit dhe thërrisin: «Rroftë flamuri!»

«Sa herë vinte festa e flamurit, xha Selimi merrte prapë udhën për në Vlorë. Takohej me shokët e tij e të rinjtë, të cilët kujtojnë përon një ditë të tillë: «Bisedoj me një plak të thinjur 70-vjeçar, por i fortë, si luan. Eshtë xha Selimi, Selim Hasani nga Brataj i Vlorës, partizan i vjetër me tri medalje, patriot i flaktë. Ai mban mend shumë gjëra që i përkasin 28 Nëntorit 1912 e sidomos gojëdhana dhe vjersha që janë të tijat.»²⁾

1) Gazeta «Zeri i Vlorës» «Me pushkë e këngë për Shqipëri-në», 20.I.1980.

2) Gazeta «Bashkimi», 29.II.1949.

Po në këtë burim lexojmë këto episode të S. Hasanit:

«Kur erdhi Ismail Qemali, në Vlorë zemrat tona u ndezën flakë se ishin djequr për Shqipërinë. Nga ballkoni i shtëpisë plaku i thinjur nxori bajrakun e kuq me shqipe, neve s'na mbahej gëzimi dhe nga gëzimi na ridhnin lotët rrëke. Për të parën herë në qellin e Vlorës valoi bajraku ynë i lirë...»

Në Paris, njëherë, bëhej një mbledhje dhe aty ishin mbledhur nga të gjitha shtetet. I thanë Qemalit: «Ç'janë këto punëra që bën? Ç'është kjo propagandë?». Ai u thotë: «Jam shqiptar dhe e dua Shqipërinë, kjo është propaganda ime». «Po, Shqipërinë», i thanë atij «e ka Turqia e ti je turk, nga do këputesh ti mënjanë?». Ai u përgjigj: «Jam shqiptar dhe biri i shqipes». Ndaj unë i këndova:

*Qemal, shqiptarët të erdhë
kur të rrëthosi Turqia,
Cili je ti more burrë,
që merr pallatet e mijë
Unë jam Ismail Qemali
Prapa, më vjen historia...*

Datën nuk ia mbaj mend kur erdhi për herë të parë Ismail Qemali në Vlorë. Te shefi i Pashallarëve mbloodi parinë e gjithë fshatrave, dhe u tha: «Qysh mund ta rregullojmë këtë punë që është kçjap e ta bëjmë dash», e kemi Turqi e ta bëjmë Shqipëri». I ka dhënë përgjigje Murat Tartari nga Vranishti: «Vetëm mendja joste, se neve, atje ku e ke ti nuk arrimë dot.» Shumë u përpooq Ismail Qemali, po aty ishin shumë bejlerë e në gjuhën e tyre fshihej helm. Që atë ditë ai u nis për në Vllahi...

... Pasi qiti në drithë e llamit flamurin në Vlorë, Ismail Qemali bëri një vizitë në krahinën e Mesaplikut. Mesapliku e priti me bujari dhe e siguroi se ishin të gatshëm për ta mbrojtur me gjak flamurin e lirisë.

Ismail Qemali mëri udhën për në Vranisht. Nga fshati ynë e shoqëruan Ahmet Cane Kamaj dhe Hysen Sherif Lila. Në Vranisht, ku ishin mbledhur nga dy përfaqësues nga çdo fshat e bënë një mbledhje në konakun e Veli Ademit. Sa herë vjen 28 nëntori, unë kujtoj fjalët e Ismail Beut, të gjalla: «Shqipërinë e kemi me vete, dhe kështu do ta mbajmë ne shqiptarët. Për këtë ne jepim edhe gjakun, edhe jetën.»¹

Në vitet 1912 e njojur është në krahinën e Lumit të Vlorës edhe kjo këngë e thjeshtë e Selim Hasanit, vëtëm këtë katër vargje:

*Flamuri ynë me shkabë,
o flamur, more,
llamburitë në çd' anë,
të qiti Malua mejdan...*

Sipas kujtimeve të bashkëkohësve të rapsodit, kjo është valle e kënduar. Rreth viteve 1938 kur hiqej valle, fshatarët e Bratit e të Mesaplikut thoshin: «Atë vallen bratçë të Selimit, që ka ngritur atëherë...»

Në ditët e para të dhjetorit të vitit 1912 Qeveria e Vlorës krijoi forcat e para të armatosura, të cilat i dërgoi për të ruajtur kufijtë e zonës së Vlorës. Çeta e Bratit, ku bënte pjesë edhe luftëtarë Selim Hasani, u vendos në brëgun e majtë të Vjosës, në kodrat e fshatit Armen. Selimi furnizonte çetën me ushqime. U nis një ditë së bashku me komandantin e çetës, Ahmet Kamaj, për në fshatin Picar. Rruga mes moçaleve e kënetës ishte e vështirë. Nëpër ara rrropateshin buqit e mjerë. Selimi pyeti komandantin se të kujt ishin ato ara. Të agait, i tha ai. Dhe Selimi ngriti këngën «Aty arë e këtu arë», ku, midis të tjerash thuhet:

*Aty arë, e këtu arë,
s'ka lënë pëllëmbë pa marrë,*

1) Gazeta «Bashkimi», 29.11.1949.

*ky agai ynë i shkretë,
hëngërka sa shtat'a tetë,
e pikë gjithë një det.*

Varfëria është si një darë në duart e agallarëve për të mbajtur nën zgjedhë fshatarët, thoshte Selim Hasani. Ai shihte se si një fshatar nuk lejonte të shkonë rruga e fshatit te një copë toke bri shkëmbinjve, se i prishnin të mbjellat. Për këtë u ndez një rrahje. Qe viti 1913. Xha Selimi, kundër grindjeve të kota, thuri vargjet:

*U shkulën Serajt u münçe (të gjithë),
Rrahnë X... çifutçe,
ca me shqelma, ca me grushte,
prishnë katimin e turqe.*

Pikërisht në këtë shtrat shohim se «poezia e Selim Hasanit nisi ushtrimet e para, bëri të vetat ngjarjet e ndodhitë e përditshme të fshatit tonë malor, u ushqye edhe ajo, po me ato derte e halle, po me ato mersele e vasiljete, që krisnin nëpër mëhallë, me ato thumba e të gërrisura gati të zakonshme nëpër miqësira, dasma e vdekje».¹

Në fshatin Brataj, ashtu si dhe në fshatra të tjera të Labërisë qe një zakon i këndshëm që shumë fshatarë flisnin me vargje. Në humor fshihejjeta e gjallë, hallet, zakonet, dramat.

Shkuan katër fsbatarë në një shtëpi në Kongolëm për muhabet. Sa hynë, i pari fshatar thotë: Derëziu o Kongolëm; fshatari i dytë: Xhaferri me një takëm; fshatari i tretë: bërë shtëpia hamëm dhe në fund Selim Hasani ua kthen: në mes i shkon një llagëm, domethënë brenda rriddhës qëka binte jashtë. Një herë tjetër i vëllai. Matoja, një fshatar, Dervishi, si dhe Selimi shkuau në

1) Fatos Arapi, «Selim Hasani dhe Lufta Nacionalçirimitare», «Nëntori», Nr. 10 1973, f. 36.

BIBLIOTEKA E RRETHIT

GIROKASTER

NR. 43878

një dasmë në Smokthinë. Aty u thanë të këndonin një këngë. E filloi këngën Matoja me vargun e parë: Besimi, dhëndëri inë; ia ktheu Dervishi; po zbardhon si përcëllimë, dhe e vazhdoi Selimi: si kopaç i zi në brinjë.

Shkaktarët e shfrytëzimit të fshatarëve që e shkojnë jetën me «tre ledhe në kocimare .../ke ndarja dhjetë ko-zare/ të gjithë të pavinare...» e bënë atë të pohojë se fshatari mezi merr një «gjysmare» bëreget e në rastin më të mirë «pesë grosh i bën kësula njëzetë e pesë i bën guna»:

Në këto vite fshatarët përleshën me sipërmarrësit e taksidarët. Këngën «Andare-via të thonë», Selim Hasani e ngriti për një ngjarje të rëndësishme në jetën e fshatarëve të Bratit. Ata nuk i dhanë bëreget si taksë tak-sidarit, por e përcollën me «thumba» e «hostenë» në formë revolte. Kjo ngjarje ndikoi edhe në fshatrat përreth: Tërbaç, Vranisht e Kuç, Bolenë e Lepenicë, për të mos paguar taksat.

Në mars të vitit 1913, kur çeta e fshatit Brataj së bashku me çetat e fshatrave të Rrëzës me porosi të Ismail Qemalit, u dërguan në zonën e Kurveleshit për të luftuar kundër shovinistëve grekë edhe Selim Hasani mori pjesë me armë në dorë me bashkëfshatarët e tij. Ismail Qemali, për të drejtuar luftimet në Qafën e Urtës, midis Çorrajt e Kuçit, caktoi luftëtarin Memo Metja nga Brati. Selim Hasani ngriti këngën «Atje do ngrini flamurë», e cila përjetëson porositë e Ismail Qemalit. Kënga u bë e dashur në radhët e luftëtarëve.

Po në këtë kohë rapsodi ngriti edhe këngët e para për trimat dhe trimëritë e tyre. Për këto ai thoshte që ishin «këngë tamam», se «bejte fshati kishte bërë që kur ishte 14 vjeç.»¹

Atë copë tokë bri shkëmbinjve Selim Hasani dhe i ati e lëronin me par mendë dhe me qe. Fshatarët siguronin bukë vetëm për 2-3 muaj të vitit. Ajo që u mban-

1) «Rapsodë popullorë, — Selim Hasani», Institut i folklorit, 1966, f. 5.

te fryshtën gjallë ishte blegtoria. Por në dhjetorin e 1914-ës kur Italia pushtoi Sazanin e Karaburunin e zbarroi në Vlorë, edhe ajo kafshatë që ishte mbjellë e pritej të korrej nga fshatarët në verë, u mbeti në grykë. Fshati Brataj u bë qendra e pushtuesve, si nyja që lidhë gjithë krahinën.

Pushtuesit nxorën jashtë nga shtëpitë shumë fshatarë dhe ndërtesat i përdorën për qëllimet e tyre. Ata filluan të ndërtonin fushime repartesh, transhe, fortifikata, poligone. Kështu shkaterruan edhe atë pak tokë që fshatari i Bratit mezi ia kishte rrëmbyer malit. Selim Hasani me shokë i mbyllën dhitë në vathë e me pikëllim të madh shikonin fortifikimet ushtarake, që prishën kullotat në majat e Boshe, në qafë të Paliskës, në Vaskë e deri në Ledhe, në vargun e lugjeve. Për përgatitjen e këtyre objekteve duhej edhe lëndë druri. Xha Selimit dhe fshatarëve të tjerë u pikonte në zemër kur shikonin pushtuesin që priste pyjet e fshatit. Prandaj më 28 Nentor të vitit 1916, nën drejtimin e demokratit revolucionar Halim Xhelio, në fshat u organizua demonstrata anti-italiane. Pushtuesit pushkatuan Elmaz Xhebron. Ata internuan për katër vjet në Itali Myrte Memon, Damën Xhelon dhe Goxho Alinë. Rapsodi u prek thëllë nga fatkeqësia e bashkëfshatarëve të tij. Atëherë ngriti një këngë të bukur për këta djem të fshatit, që e këndonin vater më vater të shtëpive të Bratit. Në ato pak vargje që njihen edhe sot thuhet:

*Myrte, Goxho e Damën,
N'internim i kanë shpënë,
qaj, mor, qaj fshati i tërë,
Ç'na e helmuancë vendë.*

Në janar të vitit 1919, komanda pushtuese italiane, duke parë qëndresën e masave popullore, shpalli zonë lufte tokat e pushtuara dhe ndaloi qarkullimin pa leje nga një krahinë në tjetrën. Fshatarët e Bratit, për të lëvizur brenda fshatit dhe për në fshatrat fqinj duhej të

pajiseshin me leje qarkullimi. Bile edhe për të shkuar në muli të Berzes duhej të merrnin leje në komandë. Fshatarët filluan të largohen nga qendra e fshatit dhe i ndërtuan kasollet e tyre pranë arave, ledheve e staneve.

Pushtuesit deshën të italianizonin edhe shkollën. Një ditë, në oborrin e shtëpisë së xhaxhait, Selimi gjeti njërin nga fëmijët me një libër italisht në dorë. Xhaxhai e qortonte djalin që të mos fliste italisht rrugës kur ktheheshin në shtëpi, madje i kishte këputur ca pëllëmbë se e kishte parë që i kishte folur një ushtari italian.

— Pse e rreh djalin? — i tha Selimi.

— Ja, shikoje, — i tha xhaxhai dhe i zgjati librin që mbante në dorë. Në kapak shkruhej: «Ju jeni stërnipërit e Skënderbeut, i cili, kur vdiq, Shqipërinë ia la amanet Italisë, prandaj italianët si miq po vënë tani në jetë amanetin e tij.» Selimit i hip gjaku në kokë dhe nga nervozizmi ia grisi kapakun librit. Në të gjithë fshatin prindërit filluan t'u flisnin fëmijëve që të mos takohen gjékund e as rastësish me ushtarët italianë, të mos flisnin italisht. U treguan fëmijve qëllimet e italianeve. Fshatarët e Bratit u mbështetën te patrioti revolucionar Halim Xhelio Tërbaçi. Në atë kohë ai ishte sekretar krahinor në Brataj, qëndronte afër fshatarëve e u tregonte rrezikun e qëllimet e Italisë. Një ditë Selimi dhe Ahmet Cane Kamaj me disa bashkëfshatarë të tjerë, tek rrinin te shkëmbi i Bratit, dëgjonin Halim Xhelon që u mësonte fëmijëve këngë patriotike. Të dy patriotët panë njëri-tjetrin. Ahmeti i hodhi dorën në sup Selim Hasanit duke i thënë:

— E more vesh? Halim Xhelua nga Tërbaçi po na tregon edhe ne se Shqipëria është gjallë.

— Ashtu është, o Ahmet, — iu kthyte Selimi, duke iu përgjigjur me vargje:

S'lidhet shqipja në litare.

I thonë shqipe shqipëtare...

SELIM HASANI NË LUFTËN E VLORES TË VITIT 1920

«Kur kujtoj Selim Hasanin në luftën e Vlorës më 1920 them: Me plumb dhe këngë ne shtimë mbi Italinë» thotë veterani Muço Delo, Hero i Punës Socialiste.

Shtëpi më shtëpi e stan më stan bisedohej kokë më kokë pér krijimin e çetës së fshatit. Në çetën e fshatit u rreshtuan 70 veta. Komandant u caktua Memo Metja. Në rreshtat e çetës zunë vend dhe dy vëllezërit, Matoja dhe Selimi. Ata hodhiën martinat në sup dhe bënë tutje, ku kristë pushka, drejt Vlorës. Luftuan përkrah bashkëfshatarëve në Kotë, Gjormë, Kallafet e Kallanë e Kaninës. Në Kotë ata panë me sytë e tyre luf-tëtarin hero Kanan Mazen, me nofull copa-copa që bënte kërdinë mbi pushtuesin. Në këto luftime u vranë dy nga bashkëfshatarët e tyre. Komandanti Memo Metja, u qëndronte pranë. Trimat «snajperë», sic i quante ai, i kishte prerë plumbi i armikut. Selimi tek i pa trupat e tyre të mbuluar me gjak, iu afrua pranë dhe, duke u ledhatuar fytyrën bashkë me të vëllanë, Maton, ia morën këngës:

*S'iu tund këmba kur luftoi,
italianët i drithmoi,
Lumin e Vlorës nderoi.*

Këndonin e mbanin iso edhe luftëtarët e tjerë.

— Bukur i qëllon këngët ti, Selim, po ia kalon dhe Matos, — bëri shaka komandanti i çetës.

— E, o komandant. Jo vetëm me plumba, por edhe me këngë ne qëllojmë mbi Italinë, — ia ktheu Selimi. Mbrëmja kishte rënë në luginë. Në këmbët e kodrave dëgjohej shushurima e ujit të Shushicës dhe zilet e karvanit të mushkave, që shkonin për në udhën e Kaninës. Italianët zunë kodrat në ullishtat përballë. Luftëtarët me dyfje qe mbi supe u kishin marrë Kotën e Drashovicën dhe tanë kishin zënë pozicionet e reja. Në sulmin që kishin bërë një ditë më parë ishin vrarë dy shkëfshatarë të tyre. Një tjetër, u plagos rëndë dhe u la në fshatin fqinj. Që nga pozicionet fshati nuk ishte larg. Ja, tek dukeshin edhe mullarët e ullinjtë. Midis ullinjve ishin shtepitë.

Në qìell u dukën gjurmët e ndritshme që fishek-zjarret-sinjal linin pas. Te çezma në bërryl të rrugës u dëgjuan ca zile mushkash.

— C'janë ato? — pyeti komandanti i çetës.

— Fshatarë të Sherishtës, — tha Selim Hasani, që ishte takuar me ta kur po mbushte ujë në çezmë.

Komandanti Memo Mete, ulur te trungu i një ulliri, këndonte këngën e Zenel Gjolekës, të Grykës së Kucit! Dikush i foli nga ana e përroit. Ai u ngrit dhe bëri tutje nga pozicionet, me cigare në buzë. Gjithë atë natë as Kanina, as fshatrat përreth nuk patën gjumë. Të nesërmen ndaj të gdhirë u bë sulmi. Gjylet binin në Vreshtat e Médha. Te shtepitë në fund të kodrave, grata po mbushnin ujë në çezmë. Një predhë erdhi e u ngul te kanali i rrugës.

— U shofshin! — tha Xhikoja. Kështu e quanin gruan, që luftëtarët e çetës së Bratit kishin dërguar në fshat për të strehuar të plagosurit. Ajo bëri tutje nga pozicionet e luftëtarëve. Predhat e gjyleve kishin përzhitur ullinjtë e vende-vende, u kishin këputur degët. Kur doli në qafë të fshatit, në ullishtat përballë, pa luftëtarët në pozicione. Iu kujtua 1912-a. Edhe ajo kishte

qenë në Vlorë, kur plaku Ismail Qemali ngriti flamurin. Ja, matanë atyre kodrave ishte Vlora.

Pranë një gorrice të djegur ajo pa dy arka me fishekë gjysmë të mbuluara nga dheu dhe ca gaveta të ushtarëve të huaj. I nxori të dy arkat me munication në një ledh dhe pastaj i ngarkoi. Ishin të rënda. Mori me vete edhe një gavetë.

Kur po zbriste në përrua, dëgjoi gjylet e tjera që ranë në vreshta. Ktheu kokën pas. Atje tej u hapën dy gropat të mëdha. Komandanti Memo Metja hodhi sytë poshtë, nga udha e Sherishtes.

— C'është ai njeri te përrroi që po vjen drejt nesh?

— pyeti ai.

— Do të jetë ndonjë nga ata të fshatit, — u përgjigj dikush.

— Bëni tutje, se qenka ngarkuar! — u tha Memoja luftëtarëve. Ata hodhën vështrimin nga ledhi i përroit. Mato Hasani ia bëri me kokë të vëllait. Selimi u ngjit mbi llogore dhe bëri tutje nëpër ullinj. Pas tij shkuau dhe dy të tjerë. Komandanti i çetës u gëzua kur pa municationin. Ai e shtrëngoi fort në kraharon Xhikon.

— Si është Hasani, moj? — e pyeti për njërin nga të plagosurit.

— Mbrëmë ishte më mirë. Nëna e ka vënë në odën e saj. — tha Xhikoja.

Përbullë luftëtarëve të çetës së Bratit dhe çetave të tjera, qëndronte kalaja e Kaninës. Në mendjen e Selim Hasanit, që ndau fishekët dhe zuri pozicionin te një ledh pranë ullinjve, kishin mbetur të gjalla fjalët e komandantit Sali Vranishti: «Dëgio, Memo Mete, Kaninën do ta shtjemë në dorë deri nesër a pasnesër. Me trimi të tillë ne e kemi Kaninën në dorë.»

Ja tek ishte kàlaja e Kaninës. Ja dhe komandanti i çetës së Bratit, Memoja, që kalonte llogore më llogore. Atë pasdreke u erdhë munication dhe luftëtarët e shpërndanë në të gjitha pozicionet. Luftëtarët dhe pushtuesit ishin aq afër njëri-tjetrit, saqë dhe bisedat midis tyre dëgjoheshin mirë.

«Kalaja duhet marrë gjallë à vdekur», u kishte thënë komandant Memoja përpëra se të fillonin sulmin. Selimit dhe luftëtarëve të tjerë u kishte bërë vërshtypje të madhe trimëria e kapedan Sali Vranishtit, i cili kishte rrëthuar portën e kalasë. Kjo ishte ndër bisedat e para që luftëtarët tregonin llogore më llogore. Selim Hasani qëndronte përballë frengjisë së kalasë. Sinjali i sulmit nuk ishte dhënë. Përmbi murin anësor të frëngjisë nxori kokën një ushtar italian dhe iu drejtua luftëtarëve të çetës së Bratit:

— O, albanez! Po të zura, do të të këput plumbint ty dhe Memo Metes.

Selim Hasanit i hipi gjaku, u ngrit mbi llogore e i bërtiti:

— Dëgjo, more! Po të kapëm, në hell do të të shkojmë ty dhe gjeneralin tënd.

Komandant Memoja i tërroqi vëmendjen Selimit se nuk duhej të dilte mbi llogore. Po atë nuk e mbante vendi.

— Kur do të fillojë sulmi? — pyeste Selimi komendantin.

— Më të ngrysur.

Selimi në llogore kushedi sa herë e mbushi çibukun e shqoptë me duhan. Pastaj dikush i tha: «Po merrja, mor Selim, merrja të këndojmë!» Dhe ai, pasi vështroi njëherë mbi Sazanin dhe Karaburunin që e kishin akoma në duar italianët, hoqi thellë në zemër dhe filloi këngën e njobur «Kanina ndënë kala».

Kënga u përhap llogore më llogore, sikur paralajmëroi fillimin e betejës.

Erdhi 3 shtatori i vitit 1920. Të gjithë luftëtarët patën zbritur në festë, në Sheshin e Flamurit. Luftëtarët e Bratit kënduan aty këngën e njobur «Nuk e bëjmë kabull na», e cila është e gjallë edhe sot. Selimi ishte kthyesi i këngës. Atë e ngriti aty për aty i vëllai, Matoja. Zëri i ngrohtë, kumbues e karakteristik i Selim Hasanit i bëri luftëtarët ta shikonin në dritë të syrit.

Kënga përhapej shesh më shesh e rrugë më rrugë të
Vlorës, me ison e saj të zgjatur.

*Nuk e bëjmë kabull na,
të jemi për nënë botë,
llafi Qemalit që tha,
historia ashtu thotë.*

• • • •

Thonë se bejlerët e Risilisë u bétuan për t'u hak-marrë ndaj Mato e Selim Hasanit. Dërguan edhe njerëz në Brataj për t'i vrarë, por s'u arrinte plumbi gjer aty.

Trimëria popullore la gjurmë të thella tek ai, prandaj dhe ngriti këngë për të e njëkohësisht pohonte:

«Kënga do gatuar mirë, se edhe mielli është i mirë. Që nga Ismail Qemali ka ndodhira të mëdha, ndaj dhe unë kur ngre një këngë, e vraç mendjen që kur ta këndojmë, të na duket vetja sikur jemi në luftë ...»

VUAJTJET, HALLET E LUFTERAT NE KËNGE

Selim Hasani, me një hejbe në krah e me mushkën e tij, zbriti në Vlorë. Iшин muajt e parë të vitit 1923, kur në të gjithë fshatrat e Vlorës ra kriza e bukës. U end në pazar tri ditë rresht, po një karroqe misër nuk gjeti dot. Shpresëhumbur mori udhën drejt fshatit. Aty te xhamia e Tabakes i doli ballë për ballë bushkëfshatari Goxho Aliu. E dinte se Goxho Aliu bënte pjesë në Shoqërinë «Bashkimi», që kishte krijuar në Vlorë patrioti i shquar revolucionar Avni Rustemi. Për këtë shoqëri Selimit i kishte folur edhe një tjetër bashkëfshatar. Në këtë shoqëri atdhetarë kishte edhe fshatarë të tjerë nga Brataj. Goxho Aliu i tregoi Selim Hasanit për mitingun e protestës që bënë 3000 fshatarët e rrethit të Vlorës disa ditë më parë, më 19 mars 1923. Ata sulmuan depot e spekulatorëve dhe ndanë bereqetin falas. Selim Hasani dëgjonte Goxhon tek fliste për qëllimet e shoqërisë «Bashkimi» dhe mbushej me krenari. Shqipëria kishte njerëz që ia dinin hallet dhe i dalin zot. Ka Shqipëria njerëz që luftonin kundër taksave. Taksat, ato e rrethonin njeriun që nga lindja gjer në vdekje. Xhelepi — taksa për çdo kokë bagëti, vergji-taksa për çdo shtëpi, e dhjeta — taksa për çdo prodhim bujqësor, edhe për barin, edhe për kashtën. Taksat për martesa, për lindje, për vdekje, për hoxhën ...

«Këto, more Goxho, e bëjnë jetën tonë një varr të hapur ...», i pat thënë Selim Hasani. Ata bisede-

nin dhe ecnin të dy në rrugën e spitalit me hejbet bosh. Atëherë Goxho, Aliut iu kujtuan vargjet e një këngë, që njerëzit e këndonin kur lindte fëmija:

*E zeza në derën time,
kush do t'i ngopë më hime!*

Arritën në Qafën e Koçiu. Ballë tyre doli gryka e Lumit të Vlorës, që ziente nga hallet e vuajtjet e fshatarëve të Labërisë.

— Në jetën tonë shfrytëzimin dhe mjerimin na i sjellin «oxhaqet», o Selim Hasani.

— Ashtu është, o Goxho. Ndaj duhet t'u vëmë pushkën këtyre oxhaqeve, se ndryshe më shumë do të na zihet fryma, — ia ktheu Selim Hasani dhe e pa drejt në sy. I folën mushkës dhe morën udhën për në fshat.

Në nëntorin e vitit 1937 në familjen e Mato dhe Selim Hasanit bisedohej për revolucionarin Halim Xhelio Tërbaçi. Ky patriot kishte vdekur. Pas asaj dite shumë fshatarë të Bratit, të cilëve ai u kishte folur sa e sa herë për «flamurin e Smail Qemalit» dhe «Shqipérinë e lirë», për «Opingën e popullit fukara» që do të bëhet zot, morën udhën për në fshatin Tërbaç, në familje e te të afërmit e tij për të ngushëlluar. Selim Hasani u hoqi mushkës e dhive zilet në shenjë zie dhe i lëshoi në bokërrimat e Sirolakut. Pas disa ditësh, daja i Halim Xhelos zbriti në qendrën e krahinës në Brataj, e në udhë takoi Selim Hasanin, i cili s'kish veç dy ditë që ishte ngritur nga shtrati.

— Pse s'më ke ardhur në shtëpi, o Selim Hasani? — e pyeti ai.

— E pse të të vija, — iu përgjigj Selimi.

— Më vdiq nipi, Halimi, e u çkullën nga anë e anës dhe erdhën.

— Aha, për këtë të ka mbetur qejfi? Unë do të vija në shtëpinë tënde dhe po të vdiste ndonjë shoku yt, ndërsa Halimi është edhe i yni. Jemi edhe ne për t'u ngushëlluar, e jo vetëm ti.

Për të përjetësuar kujtimin e Halim Xhelos, Selimi ngriti këngën «Halim Xhelo komunisti».

Fshatarëve të Bratit nuk u hiqeshin nga mendja fjalët e Halim Xhelos, bisedat e takimet me të për flamurin dhe për Ismail Qemalin. Selimi me shokë, te fjalët e bisedat e Halimit kishin gjetur një dritë për të parë nga vinin hallet e vuajtjet dhe te sytë e tij kishin parë një shpresë për të ardhmen.

Ditën e 28 Nëntorit, tek fliste në sheshin e Bratajt kryetari i komunës, Selimi e bashkëluftëtarët e tjerë ndienin një lëmsh të madh në fyt.

— Këta na i pinë gjakun dhe i zënë dritën flamurit tonë që nuk llamit, u tha Selimi bashkëfshatarëve.

— ... Madhëria e tij, mbreti Zog, tregon kujdes të madh për Shqipërinë dhe shqiptarët. Për këtë ai ka merrit si atdhetar i madh, si patriot nga i cili duhet të mësojmë. Ja, ky flamur që valon sot në sheshin e komunës sonë është ngritur me urdhrin e tij ..., dëgjohej zëri i kryetarit të komunës në sheshin e fshatit Brataj.

Fshatarët e ardhur nga Brati, Tërbaçi, Vranishti, Gjormi, Lepenica, Velça, Ramica e Smokthina, bënë një poterë, ndërsa kryetari i komunës, duke vazhduar bisedën më tej, iu drejtua rapsodit Mato Hasani:

— Ja, ti Mato, sot ke rastin t'i këndosh të madhit Zog.

Matoja i hodhi një vështrim Selimit dhe ky ia ktheu:

— Këta na e turpërojnë flamurin, Mato.

Të dy vëllezërit i dhanë dorën njëri-tjetrit. Bashkë-fshatarët hapën udhën dhe Mato Hasani doli në krye. Kryetari i komunës dhe qeveritarët po e shikonin Mato Hasanin që kishte marrë në duar flamurin dhe i ledhatonte kokën shkabës. E shtriu në hapërirë dhe filloj të këndoje aty për aty:

*Shkabë e zezë kryelartë,
përse gojën e ke hapë?
Armiqtë kërkoj të kap!*

Selim Hasani dhe fshatarët e tjerë të Bratit e pa-suan nga sheshi i fshatit me një iso të zgjatur. I thirrën disa herë në komunën e Bratit për këto «trazira» që shkaktonin kundër qeverisë në krahinën e Mesaplikut dhe i paralajmëruan se do t'u tretnin kockat në burgjet e Vlorës.

Në vitet 30', kur gjendja e masave popullore sa vinte e keqësohej Selimi nuk mund të rrinte pa kënduar për vuajtjet e dertet: Jemi irritur me të keqe /Me bejlerë e në oxheqe. Për këto vite ai pohonte më vonë me të drejtë: «Në kohën e Zogut unë dhe këngët e mia kemi qenë të vdekur e të pakallur.»

Po vuajtjet iu shtuan edhe më shumë popullit më 7 prill të vitit 1939. Selim Hasani ndodhej në Dukat. Natën e kishte gdhirë në stanet e Tërbaçit. U hidhërua shumë kur mori vesh pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste. Fshat më fshat e në tërë krahinën u përhap kënga e tij e njobur, e kënduar nga grupi i Bratit. Pastaj ajo u përhap edhe në Gjorm, Velçë, Ramicë, Se-vaster, Kotë, Drashovicë, Dukat, Tërbaç, Vranisht, Kuç Kallarat, Bolenë, Vërmik, Armen e fshatrat e tjera të Kurveleshit.

*Qaj, moj Sqelë aty tek moli,
nga Sazani vjen pamporri,
fashizmi në Vlorë dolë,
bërtet Duçe bagabondi:
— Do ta bëj fushë futboll!
Barbarë, mos e harroni,
Njëzetën pse s'e kujtoni?
Me dhen e me dhi do shkonin,
me bucela do ngarkoni,
tokën tënë do pleroni.*

Bashkëfshtarët e tij shikonin te kjo këngë fillimin e revoltës së tyre. Ata bënë sa e sa qyfyre e shaka me rapsodin, kur kapitulloi Italia fashiste, dhe me ushtari-t fashistë që punonin nëpër fshatrat e Labërisë për

bukën e gojës. Një nga këta ushtarë mori edhe Selimi pér të lëruar arën me që. Po ai ishte dembel.

— Hë, lëro, jepi parmandës se nuk të bien vithjet! — i thoshtë xha Selimi. Ai merrte parmandën e bënte tutje. Xha Selimi, në rrëzë të lëdheve të arës ia merrte këngës «Në Vlorë Italia doli».

— Ç'është kjo këngë? — e pyeste Xhovani, kur dëgjonte që aty flitej pér Italinë.

— Është kënga juaj, Xhovani. Ne, shqiptarët, kështu ua këndojmë këngën atyre që vijnë pér të na pushtuar.

NJË KËNGË NË BURGUN E BRATAJT

Në mbrëmjen e 27 Nëntorit të vitit 1942 në shtëpitë e lagjes Kongolem këshilli nacionalçlirimtar lajméronte pér mitingun që Qarkori i Partisë pér Vlorën do të organizonte në krahinën e Mesaplikut. Matoja doli nga konakët dhe e gjeti të vëllanë, Selimin, duke mbyllur vathën e dhive. Atë natë, në ato shtëpi të gurta në shpatin e maleve, s'kishte gjëzim më të madh sesa ajo që në fshat kishte ardhur Besniku.* Gjithë fshati e dinte ku ishte ai atë natë; ja, në atë shtëpi të thjeshtë të Derajve, në rrëzë të malit. Sa zbardhi dita e 28 Nëntorit shoku Hysni Kapo, i shqëruar nga anëtarët e këshillit të fshatit, zbriti pér në vendin e quajtur vreshtat e Tojes, diku pranë shkollës së fshatit. Që aty iu dërgua një letër marshallit të karabinerisë italiane, Guxonit, me anë të një pionieri të shkollës fillore. Marshalli shkoi në vendin e takimit. Hysni Kapoja, duke iu drejtuar në emër të popullit të krahinës së Mesaplikut, e paralajmëroi atë:

«Në emër të popullit shqiptar milicia dhe karabineria fashiste janë të izoluara në kazerma dhe nuk lejohen të bëjnë as më të voglën lëvizje, pérndryshe do të përdorim armët. Nga ana tjetër nuk u lejojmë të ngrini as flamurin italian, as atë shqiptar. Populli do ta ngrejë vetë flamurin kombëtar dhe do të festojë përvjetorin e

* Pseudonimi i shokut Hysni Kapo.

pavarësisë kombëtare.»¹ Marshall Guxoni s'kish ç'bënte para një ultimatumi të tillë energjik.

Pjesëtarët e njësitit të Çetës Plakë e fshatarët e Bratit u nisën nga lagjja Mahmutaj kur dielli sa kishte dalë. Në ballë të fshatarëve të Bratit ecte Hysni Kapoja, duke mbajtur flamurin në duar. Ndërsa dy luftëtarë të Çetës Plakë të Vlorës mbanin një pllakatë mbi të cilën shkruhej «Vdekje fashizmit e tradhtarëve». Në sheshin e fshatit po grumbulloheshin grupe fshatarësh duke kënduar këngë labe, revolucionare e patriotike. Vinin nga Smokthina, Tërbaçi, Vranishti, Velça, Gjormi, Lepenica. Midis grumbullit të njerëzve që rrëthonin flamurin e mori fjalën Besniku:

«Armiku ka ngrënë grushte të rënda nga lufta e popullit shqiptar, por mos harroni se ai është akoma i fortë dhe në fuqi. Për t'i arritur fitores dhe çlirimt përgjithmonë, na duhet të bëjmë sakrifica akoma më të mëdha nga sa kemi bërë deri nashti.»²

Kjo ngjarje e vitit 1942 i mbeti në mendje Selimit. Kur ecte me bashkëfshatarët e tjerë pas flamurit në 1912, kur rendnin nëpër rrugët e Vlorës pas flamurit të Ismail Qemalit.

Tek e shikonte flamurin me shkabën e zezë, në mes të popullit të fshatit dhe të krahinës së Mesaplikut, iu mbushën sytë me lot.

— Ç'shikon ashtu, Selim? — i tha bashkëfshatori Damen Xhelajo.

— Shikoj flamurin e Ismail Qemalit që e mbajnë në dorë djemtë e Partisë, — iu përgjegj rapsodi.

— E tha mirë Besniku, o Selim. Vetëm lufta e nxjerr në dritë flamurin e Shqipërisë.

— Mirë e ke, o Damën. Vetëm pushka i jep dritë flamurit të Shqipërisë, — tha Selimi. Pranë tyre erdhë bashkëfshatari Laze Nuro*.

1) Arkivi i Muzeut historik të Vlorës.

2) Arkiv i Muzeut historik të Vlorës.

* Dëshmor i Luftës Nacionalçirimitare.

* Hero i Popullit.

Selim Hasani më 1962.



Hito Selimi, djali i xha Selimit, rënë në Mamurras kundër bandave kriminale, më 14 shtator 1951.



Selim Hasani me të
shoqen, Sofien, duke
għendur dyjare, curle
e vegla tē tjera muzi-
kore populliore.

Xha Selimi me një grup
bashkëfshatarésh.



— Po merrja një këngë, o Selim, merrja, të buçasë mbi shkëmbinjtë e Bratit! — i tha Lazja dhe iu afrua pranë.

— Po hajdeni, djemtë e babait, hajdeni t'ia marrim njëherë! Dhe Selimi, siç e kishte zakon, e ngriti aty për aty këngën e tij për flamurin me shkabë e yll:

*Flamur, të mbuloi zia,
o flamur, more.
Që kur erdhi Italia,
të vu sëpatat e tia,
po do t'i heqë rinia,
ndaj po bën luftën Partia.*

I vëllai, Matoja, duke i hedhur dorën në qafë, nuk e la këngën të mbaronte me kaq. Shihte me mallëngjim flamurin e lirë dhe aty për aty shtoi:

*Tundu, tundu, o flamur,
marshalla ç'lëshoke nur,
përmbi shkëmb e përmbi gur!*

Atë ditë, në sheshin e fshatit, kënga e Selim Hasani u këndua disa herë. Rapsodi popullor Sinan Gjondedaj tregon: «Në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare këtë këngë e kemi kënduar pas luftimeve në Gjirokastër, Përmet, Elbasan, kur kaluam Shkumbinin e gjetkë. Pasi u plagosa, më shtruan në spitalin partizan të Pezës. Një ditë, këtë këngë e dëgjova të kënduar edhe nga disa të plagosur partizanë të Divisionit I Sulmues që ishin në spital. Në një bllok e kishte të shkruar edhe Hysen Çinoja, Hero i Popullit, nga i cili e mësuau edhe partizanë të tjera.

Në janar të vitit 1943 në Vlorë kishin ardhur forca të mëdha bashibozuke, nën komandën e kriminelit Halil Alia. Ata sulmuau trevat e çliruara të Mesaplikut. Te një çezmë ku Selim Hasani po i jepte ujë gomarit, ata u turrën me shamatë e me potere.

— Heu, c'janë këta? — pyeti Selim Hasani njërin që u ul në një gur aty pranë e rrinte rëndë-rëndë.

— Kanë ardhur për me shtrue Vlorën e Labërinë, — tha Halil Alia.

— Gabim kanë bërë, — ia ktheu Selimi. — Popullin nuk e shtroi dot Italia, e jo këta ...

Më vonë Selimi mori vesh se ai me të cilin bisedonte ishte Halil Alia.

Në marsin dhe në prillin e vitit 1943, pas aksionit të Selenicës, Selim Hasani mori pjesë me çetën e fshatit në tërheqjen e materialevë të zëna italianëve dhe i fshehën në një dyqan. Postkomanda e Bratit u lajmërua nga prefektura e Vlorës se materialet ndodheshin në Brataj e duhej të gjendeshin patjetër. Karabinierët italianë arrestuan 70 burra të fshatit, që do t'i pushkatonin sa të gjendeshin materialet e municioni. Por gratë trimëresha, për tërë natën, i shpunë materialet në mal. Pas disa ditësh fashistët i nxorën fshatarët, por mbajtën shtatë më të moshuarit në burgun e postkomandës. Midis tyre edhe Selim Hasanin.

«S'ka gjë, djemtë dolën e do të luftojnë për Shqipëri edhe për ne, që jemi pleq», dhe për të bërë shokët me humor në burg, ngriti këto vargje me qesëndi, që u përhapën gojë më gojë:

*Italia c'burra muarr,
ç'i deshi tymet e shuar,
Razi Mazen hundë pluar,
dhe Selimnë e përcëlluar,
Rrofshin djemtë, se e fituam.*

NË BETEJËN E DRASHOVICËS DHE NË SPITALIN PARTIZAN TË RAMICËS

Ato ditë shtatori të vitit 1943, Selim Hasani ishte luftëtar në çetën e Bratit. Më 12 shtator mori pjesë në luftimet për shpartallimin e garnizonit armik në Selenicë. Pas betejës, çeta mori urdhër për t'u nisur në Mavrovë. Në kodrat dhe pyjet e Treblovës ndenjën një copë herë për të pushuar. Aty partizanët ia morën labçë këngës «Ç'heq e ç'vuan, mo i mjerë», të cilën Selim Hasani e ngriti për jetën plot vuajtje e halle të minatorëve të Selenicës. Dhe kënga mori udhë si zakonisht.

Në brigjet e Shushicës, te rrepët e mogme në Drashovicë, lajmi për plagosjen e Besnikut u përhap si vetëtimë. Ata e njihnin sekretarin politik të Qarkorit të Partisë për Vlorën. Dikush kishte ndenjur në stanet e Shushicës e tregonte për netët që kishin kaluar atje. Një tjetër tregonte se si atë natë dimri në fushën e Lubonjës kishin kaluar lumin e fryrë nga ujërat e borës që po shkrinte.

Selim Hasani e partizanë të tjerë të batalionit të Rrëzës dëgjonin bashkëluftëtarët dhe sillnin ndër mend takimet me të. Po ato ditë, aty në vlogoret e luftës, kur ai dëgjoi për plagosjen e shokut Hysni Kapo, ngriti këngën e famshme popullore «Moj Mavrovë e Drashovicë», e cila u përhap në të gjithë Labërinë si «qarkore», si «bulletin» i atypëratyshëm për betejën frontale,

epopenë e luftës së Drashovicës. Ato vargje i dilnin nga shpirti Selim Hasanit.

Muço Deloja, komisari i batalionit të Rrëzës, një ditë shkroi një copë letër: «Në qoftë se ju vijnë lajme për Beşnikun, më njoftoni! Islam Harizi është plagosur rëndë, dhe ndodhet në pozicionet e armiqve; duhet ta tërheqim patjetër. Unë ndodhem te mulliri».

Selim Hasani e mori letrën dhe nëpër natë çau shtegun me driza e ferra në Qafën e Dardhëve dhe mori udhën për te ledhet, buzë arave nga ana e Peshkëpisë. Luftëtarët i mbanin ato pozicione fort, sepse aty armiqtë u sprapsën disa herë.

Ekte bregut të Shushicës dhe pas gjysmë ore u gjend tek arat përpara mullirit të fshatit. Nata po thyhej. I vetmi vend i mbrojtur që duhej të mbahej fort ishin ato ledhe dhe ai mulli buzë lumit. Sa çeli dita, dy predha mortajash krisën poshtë arave duke dhënë flakë. U ndezën edhe shkurret e drizat që ishin pranë.

— Hë, ju shoftë lufta, ju shoftë! — shante xha Selimi nëpër dhëmbë.

Te ledhet buzë lumit u ndez lufta. Forcat e shumta ishin përqendruar në atë krah dhe gjermanët filluan të zembrapsen.

— Kjo është dita e fundit në këtë breg, — tha Muço Deloja dhe urdhëroi tre partizanë të zënë pozicionet më tutje. Një mortajë me zhurmë të thatë krisi njëzet metra para tyre. Një tjetër ra fare pranë dhe Selim Hasanit. Ajo e kishte goditur në të dyja këmbët. Filloi t'i rrjedhë gjak. Sado i plagosur edhe nënofull, edhe në krah, me qetësi të madhe tha: — S'ka gjë, haka e nënës më zuri, se kur isha i vogël nuk lija dy gurë bashkë dhe ajo e varfëra më thosh «Të hëngërt mortaja, Selim!». Dhe ja ku më gjeti. — Shokët s'kish si të mos qeshnin. Muço Deloja e hodhi në krah dhe u thirri dy djemve nga Mesapliku:

— Çojeni te mushkat e hipeni për në Lapardha!

Djemtë e mbështollën me një velenxë rapsodin partizan, të cilin po i rridhët shumë gjak. E çuan deri në buzë të lumit të Shushicës. Për t'u bindur në ishte

gjallë apo jo (aq keq qe plagosur), shokët ngritën cepin e velenxës dhe e pyetën si ishte. Ai u përgjigj me vargjet: «Drashovicë e ura mbanë, /ç'bëre moj, ti paç belanë?/ plagose Selim Hasanë...» dhe shpërtheu gazi te të gjithë. Hipur mbi mushkë, Selim Hasani mori udhën në bregun e lumit, drejt grykës së Kotës.

Në korrik së bashku me çetën ai luftoi në Selenicë. Sa u gjëzua atë ditë kur çetën e Bratit për trimërinë e saj e përgëzoi Besniku.

Në gusht mori pjesë në luftimet që u zhvilluan në Tragjas kundër fashistëve e ballistëve. Më 12 shtator 1943 përsëri mori pjesë në luftimet e Selenicës për shpartallimin e garnizonit armik. Më 14 shtator — në luftimet e Mavrovës. Më 16-20 shtator Selim Hasani luftoi përkrah shokëve në Vodicë, Drashovicë, Sherishtë ... dhe ja tani, i plagosur shkonte në spitalin partizan.

Xha Selimi qëndroi dhjetë ditë në një shpellë. Safa, e shoqja, dhe Hitoja, i biri, i qëndronin te koka dhe ia mjekonin plagët me ilaçet e vendit, derisa ta çonin në spitalin partizan të Ramicës. Rruja ishte ca e gjatë, ndaj ata u nisën herët. Në samar i vunë një shilte. Meqë plaga i dhimbte, xha Selimi hipi çobanë. Hitoja e cte përpara, mbante mushkën për kapistalli dhe habitej si nuk e dëgjoi një herë të rënkonte, me ato **plagë të rënda**.

— **Mushkën mbaje nga Qafa, mbi shkëmbinj, në rrugën e staneve, se nuk dihet, piqemi me ndonjë nga ata të Ballit, bir i babait.**

— Mirë, baba, do të dalim mbi urë, — i tha i biri.

Ata ecën nëpër mjegullën e mëngjesit që hapej në dy anët e lumit të Shushicës. Nënë Safa e qëllonte mushkën me një shkop thane. Pas dëgjohej zëri i saj: deee, deee! ... Kur hodhën urën mbi lumin e Shushicës dhe dolën në një shesh te gurët e Smokthinës, Hitoja ndali mushkën që t'i shkurtonte kapistallin. Dëgjoheshin zëra dhe të qeshura. Xha Selimi hoqi pushkën nën samar dhe e mbajti gati. Kur u afroan, ata e njohën dhe i folën xha Selimit. Ishin luftëtarë të fshatrave të tjera.

— Vdekje fashizmit, xha Selim! — i thanë partizanët që nxitonin në shtegun midis gurëve.

— Liri popullit! Pushka top ngado që të shkon, — ua ktheu ai.

Mushka bëri përpara në udhën mes pyjeve. Po Selim Hasani e mbante kokën pas e shikonte ata djem «skifterë» që vinin nga lufta dhe prapë shkonin në lufë. Te dera e spitalit partizan doli doktor Ibrahim Dervishi. Xha Selimi e njihte doktorin qysh më 28 Nëntor të vitit 1942, kur erdhë me Bësnikun dhe organizuan mitingun në fshat. E kishte njohur edhe kur ngriti infermierinë e parë partizane në shtëpinë e Damën Xhelos, në Brataj. Tani, Qarkori i Partisë e kishte udhëzuar që spitali të ishte në thellësi të maleve, sepse gjurmohet nga ballistët. Selim Hasanit i kishte mbetur më rarak vrasja e Damën Xhelos. «Do t'ia marrin hakun djemptë e Partisë, doktor, — thoshte shpesh xha Selimi. — Për mua është plaqë tjetër kjo vrasje e Damën Xhelos». Doktori e donte shumë Damën Xhelon. Ato ditë plaqën e kishte më mirë. Shpesh i shkonin për ta parë edhe të plagosurit e tjerë, së bashku me xha Sejdinin, një partizan i plagosur 60 e ca vjeçar nga Gorrishti. Gjithë ditën gjer vonë në mbrëmje ata u tregonin histori e këngë të plagosurve.

Të plagosurit kishin qejf të këndonin, e me ta këndonte shpesh edhe doktori, Donikë e Neshireja, infermieret e spitalit.

— Po na gjetën në befasi ballistët, gati na ke, doktor, ta shkrepim këtë të uruar mbi ta e t'i bëjmë kërmë, — dëgjonte ai zérin e xha Selimit, që dilte nga shpella në faqen e kodrës, ku bënин rojë partizanët e plagosur.

Nga fshatrat e Labërisë çdo ditë vinin dhe binin ushqime e veshmbathje për të plagosurit. Një ditë disa fshatarë nga Ramica iu lutën Selim Hasanit t'u ngrinte një këngë.

— Afrohuni e ngrini zérin; mbani iso ta dëgjojë edhe doktori e infermieret jashtë shpellës këtë këngë për spitalin partizan e doktor Brahimin:

*Në Boder përmbi Smokthinë,
të plagosurit i mblodha,
do t'ua bëj mirë jatrinë,
se kam ilaçe të holla,
Drashovicë e Peshkëpi,
italianëve ua mora.*

Qysh atë ditë të plagosurit e këndonin shpesh këtë këngë. Doktori tek e dëgjonte u thoshte infermiereve:

«Kënga e xha Selimit dhe humori i tij me të plagosurit është ilaçi më i mirë për t'i shëruar».

Në spital ndodhej i plagosur rëndë komandanti i batalionit të dytë të Brigadës V Sulmuese, Mevlan Dervishi. Doktor Ibrahim kishte netë që e gdhinte pranë tij, por plaga ishte e rëndë. Nëpër shpellë dëgjoheshin rënkimë të mbytura.

— E, doktor, si duket, do të shpëtojë gjallë? — e pyeti xha Selimi një ditë. Doktori iu afrua pranë dhe i hodhi dorën në sup. Xha Selimi dalloi në sytë e tij të mavjosur shqetësimin për të plagosurit. Për trima të tillë sa e sa herë Selim Hasani thuri këngë e hodhi valle në Brataj e në tërë Lumin e Vlorës!

Plagët e tij, që kishte marrë nga mortaja, po mbylleshin, por ende nuk ishin shëruar. Kur e përcollti doktori dhe infermieret, xha Selimi qëndroi te shtegu, hodhi sytë nga mali i Çikës dhe i Çipinit.

— Andej duhet të jenë shokët, doktor. Dhe ca kohë, e do t'i gjej prapë, bir i babait. — Doktori e puthi dhe e përqafoi. Pastaj iu kthye infermiereve: — Sa njerëz të mirë! Me këta e ke luftën të fituar!

XHA SELIMI DHE NIPI I TIJ BAKO TAFILI

Bako Tafili ishte djali i Xhikës, motrës së Selim Hasanit, që qe martuar në fshatin Gjorm. Në këtë fshat kishte futur përcarjen armiku i popullit dhe i Partisë, Sadik Premtja. Xha Selimi shkoi shumë herë në shtëpi të së motrës dhe bisedoi që Bakoja të lidhej me Luftën Nacionallirimtare, me Partinë Komuniste, dhe nipi po e përligjte besimin e tij.

Një mëngjes Bakoja kishte marrë herët udhën për në Brataj. Një bashkëfshatar i tij nga Gjormi, i gënjer, nga Lahe Nuroja, ballist me damkë, i informonte ata pér njerëzit e Partisë në fshat.

Xha Selimi, që e dinte këtë gjë, i tha të nipit të bisedonte me bashkëfshatarin dhe t'i thoshte se ajo rrugë që kishte zënë ishte qorre dhe të conte në greminë. Bako Tafili ia dërgoi fjalët e dajos bashkëfshatarit të tij, i cili hoqi dorë nga rruga ku kishte hyrë. Më vonë, kur xha Selimi e pyeti Bakon se ç'thoshte «miku», ai iu përgjigj: Miku më tha se do të marr një belxhik, si më tha xha Selimi, e do t'u bije vënce qenërve ...

Xha Selimit i kishte mbetur në mëndje dita e fundit kur ishte takuar me nippin. Atë natë Bakoja zbriti nga shtegu i dhive, kur bagëtitë po futeshin për në vathën e tyre dhe erdhi në shtëpinë e xha Selimit. Bako Tafili vishej me të leshta dhe mbante në kokë qylaf të bardhë,

— Sonte do të shkoj në Tërbaç, dajo. Nesër do të vij herët.

— Mirë, bir i babait, pushka top, — i tha të nipit. Të nesérmen Bakoja u kthye pa rënë drita, po nga ai shteg që u duk dhe në mbrëmje. Tri bombat e dorës dhe pushkën i vuri në dritare. Hitoja, djali i xha Selimit, i donte shumë armët. Ai kish mësuar të mbërrthente e të zbërrthente jo vetëm pushkët po edhe mitralozat. Nënë Safa u shtroi pak shëllirë dhe nga një kokërr qepë. Hitoja iu afrua armëve dhe mori në dorë një bombë.

— Ç'bën ashtu, more bir, — i foli xha Selimi. — Ua paske mësuar gjuhën edhe atyre. Hitoja e la në vend bombën dhe u largua përjashta. Miloja, djali tjetër i xha Selimit, i ulur pranë Bakos dëgjonte bisedat e tyre. Bakoja nxori nga xhepi një stilograf dhe ia zgjati Milos, i cili e mori në duar dhe po e shikonte Bakon drejt e në sy.

— Mbaje, Milo! Pas luftës do të mësosh të shkrushash e lexosh në shkollat e Partisë.

Papritur u dëgjuan ca pushkë. Bako Tafili e la bukën dhe doli në oborr.

— Ç'janë ato armë? — tha xha Selimi.

— Dajo, po iki unë, të puthem i tani, se luftë është e nuk i dihet kur do të takohemi. Qëndise mirë atë këngën për Sadik Premten që më ke premtuar, se do t'ia tregoj Laze Seferit, atij shokut tim.

— Kur të vish e ke gati këngën për «maçin e Stambollit», more bir!

Por xha Selimi nuk e takoi dot më të nipin. Pas dy ditësh, mori lajmin që trimi Bako Tafili ishte vrarë. Atë mbrëmje që i prunë lajmin e vrasjes së nipit, doli në oborr të shtëpisë dhe u foli fëmijëve të mblidheshin, se do të këndonin një këngë për Bakon. Ata nuk e dinin që Bakoja ishte vrarë, por e morën vesh nga vargjet e këngës.

Dhe kënga e xha Selimit për të nipin mori udhë si të tjerat, fshat më fshat. Një ditë, e ëma e Bako Tafilit kthehej nga Velça në shtëpi. Aty gjeti edhe xha

Selimin që kishte qenë në Kotë për një hejbe misër, se kishin ditë pa bukë. Ajo hyri në shtëpi dhe u gëzua që gjeti të vëllanë.

— Erdha, Selim, erdha, po u vonova në va të lumenit, se kish ujë.

— Hë, po ç'kishim andej nga Velçë?

— E, ja, takova dhe djalin, Bakon.

— Ku?! — u habit xha Selimi.

— Ja, atje në Krater të Velçës, shokët e tij partizanë ia kishin marrë asaj këngës «Të kërkon Delo Balili, o Bako, birbilo». Ndenja një copë herë me ta, u çmalla ... sikur u takova me Bakon ...

LUFTOJMË QE E BUKUR TË NA BËHET KËNGA DHE JETA

Nëntor i vitit 1943. Xha Selimi ekte nëpër rrugën shkëmbore dhe kur arriti tek ura e vjetër e fshatit, hodhi vështrimin në shpat për të parë shtëpitë. «Atje duhet të jenë, në shpellë», mendoi me vete për gruan dhe fëmijët. Sa e kishte marrë malli për ta, sidomos për Hiton, i cili kishte filluar të këndonte me grupin e rinisë së fshatit. I biri shpesh i thoshte: «Hë, baba, na bëj ndonjë këngë për ata «trimat» e Lahe Nuro ballistik, se pastaj ia gjejmë vendin ne të rinisë.» Dhe xha Selimi ua bënte qejfin. Ai i ngrinte këngët aty për aty, ata i shkruanin dhe i përhapnin. Fëmijët e priten babanë me gëzim të madh. Shtëpia e tyre ishte bujare. U kish te ardhur një partizan i plagosur.

— E gjejnë, e gjejnë, moj Safë, shtëpinë tonë njerëzit e Partisë. Të vijnë se ajo është shtëpia e tyre, — tha xha Selimi kur e shqoja i tregoi për partizanin e plagosur. Një kandil dhe prushi i zjarrit në vatër ndriçonin disi errësirën e konakut. Xha Selimi hyri në derën e shpellës e, pasi hodhi vështrimin pranë vatrës, pa partizanin e plagosur të mbuluar me një gunë të vjetër.

— Po ku je, more bir i babait, — i tha duke iu afruar te koka; i mbështeti dorën në ballë dhe nuk e la të ngríhej. I largoi rrobat dhe i pa në mes të shpatullave plagën që po i shërohej.

— Paske marrë plagë të rënda!

Nënë Safoja u fut në derë të shtëpisë me kandil
në dorë.

— Hollë është mbuluar ky djalë! — i tha së shoqes.
Nënë Safa s'kishte rrroba të tjera. Xha Selimi atëherë
mori kandilin nga dora dhe i tha:

— Na, hidhi këtë pallton time të vjetër se e mban
ngrohtë.

Xha Selimit i biri i kishte lexuar komunikatat, ndaj
e dinte gjendjen e luftës. Tek dëgjonte dhe djaloshin
plagosur, një zjarr i brendshëm sikur e digjte. Atë ditë
partizani dëgjonte të bijtë e xha Selimit, që këndonin
një këngë trimërie të grupit «Qazim Ademçë» të Smok-
thinës. U afrua dhe mbante iso. Xha Selimi kishte qenë
te rruga, me një shok të çetës territoriale. Kur djemtë
nuk këndonin mirë, i qortonte. Ndërsa tani, tek i dëgjon-
te kokë më kokë te stiva me dru, ashtu shtruar e ëm-
bël, u afrua ngadalë e mbajti edhe vetë iso.

— Ja këshfu, o djem, ka lezet kënga.

Partizani iu lut xha Selimit të ngrinte një këngë
të re, se kishte dëgjuar që ai i stiste aty për aty.

— Do t'u dërgoj dhe shokëve të mi, — shtoi ai.
Xha Selimi u ul mbi një gur, humbi sytë tutje
nga malet e Labërisë, Gryka e Kuçit e poshtë në rrje-
dhën e Shushicës dhe filloi: «Lufta më dyzët e trenë».

Partizani i plagosur e shkroi këtë këngë në blokun
që mbante nën kokë. Pas ca ditësh ua dërgoi shokëve
të tij.

— Sa e bukur, kjo këngë, xha Selim, — i thoshte
partizani.

— Ndaj luftojmë, more bir, që e bukur të na jetë
kënga dhejeta... i përgjigjej xha Selimi. Partizani pasi
u bë mirë u nis për në çetë, por nuk iu hoq nga mendja
xha Selimi dhe shtëpia e tij bujare.

Për atë ditë dhjetori të vitit 1943, një ish-partizan
i çetës së Bregut tregon:

«Ishim në luftime me gjermanë e tradhtarë në zo-
nën e Mesaplikut. Një ditë, kur gemë ulur mbi përra-

lle e shkëmbenj, partizani Laze Seferi* na tha: «Ja, ky është xha Selimi i Bratit! Ejani të këndojmë një copë herë!» Dhe ashtu bëmë. U grumbulluam rrëth tij. Te dëgjoja rapsodin duke kënduar dhe duke treguar historitë e këngëve mendoja se edhe unë, që isha nga Bregu, nuk i dija aq mirë atë pasuri të çmuar të këngëve himarjote dhe historitë e tyre, ashtu siç i dinte dhe i tregonte xha Selimi i Bratit.

— I këndon bukur këngët labçë ti, xha Selim. Po të rrimë me ty, duhet të këndojmë gjithë ditën, se në këngë na kujtohen shokët e rënë, — i tha Laze Seferi.

— E, more bir, sa herë të kam thënë, kënga, po s'i vuri shpatullat mbi luftën dhe gjakun e trimave, nuk ta sjell në hundë erën e barotit, për tu hedhur tutje istikameve, mbi armiqtë.

Çeta partizane e Bregdetit, që bënte pjesë në batalionin «Halim Xhelë», mori urdhër për shpartallimin e forcave balliste e tradhtare që ndodheshin në Lumin e Vlorës dhe në grykën e Mesaplikut. Ballistët, xhepis-tët dhe tradhtarët kishin zënë pozicione të forta. Komanda e batalionit e studioi planin e tyre dhe u drejtoi zjarrin nga të gjitha anët. Pas spastrimit të tradhtarëve në Gjorm e Lepenicë, forcat partizane të batalionit vazhduan spastrimin e tyre në të gjithë krahinën. Mbetën shumë armë, municione, ushqime e materiale të tjera ushtarake.

— Ua bëtë mirë, bir i babait, që i vutë përpara si lopë dhe ua latë kockat brinjave të Shushicës, — i tha xha Selimi partizanit Laze Seferi.

— Kështu do t'ua bëjmë të gjithë armiqve, xha Selim. Ja, ti ke parë shumë luftëra, por Parti s'kemi pasur. Partia po ngre më këmbë gjithë popullin, ndaj do ta fitojmë. Ti e pe vetë në Drashovicë. U mbush Shushica me gjak.

— E, more bir. Toka jonë s'e mban dot të huajin, ndaj djeg e përvëlon.

* Dëshmor i Luftës Nacionalçlirimitare.

— Xha Selimi nGRE këngë tË buKura, — tha Laze Seferi.

— Pse, ti pak tË fortA i nGRE këngët, o Laze?

Lazja uli kokëN pastaj hodhi vështrimin te shokët. Në çetëN e Bregut dHE nË batalionin «Halim XhelO» kishte grupe tË këngës labe dHE tË këngës himariote. Grupi himariot ia mori këngës së Nase Benit. Xha Selimi u afrua pranë tyre.

— E, more djem, si thotë kënga e si e kërcitët ju dyfekun, janë trimat e vendit tonë, — tha ai dHE, duke i hedhur dorën nË qafë partizanit Laze, ia mori këngës.

Kur mbaroi kënga, tË gjithë partizanët iu mbloDhën rrëth. Ai filloi t'u fliste për këngën e vjetër himariote, piluriote, vranishtjote, kuçjote... Ajo që u bënte përshtypje partizanëve ishte se xha Selimi dinte vargjet e shumë këngëve e historitë e tyre. Pasi kënduan dHE një këngë tË partizanit Laze Seferi, partizanët iu lutën xha Selimit tË këndonte edhe një këngë tjetër. Xha Selimi ia mori shtruuar-shtruuar këngës së tij për epopenë legjendare tË Drashovicës:

Ç'janë këto gjyle tË rënda,
atje poshtë nga Sirokëmba.

Pas këngëve, partizanët morën udhën për nË Gjirokastër, Polican, Përmet. Atje forcat e batalionit «Halim XhelO» do tË bashkoheshin me grupin e katërt e tË pestë dHE do tË sulmonin Këlcyrën, ku ishin grumbulluar shumë forca balliste e zogiste. Xha Selimit i mbe-tën nË mendje «ata djem levendë» që luftonin kudo me trimëri tË madhe.

PARTIZAN NË BRIGADËN E V SULMUESE

Më 20 janar të vitit 1944, në Bramyshnje të Tërbaçit, u formua Brigada V Sulmuese. Xha Selimi kishte marrë vesh nga shokët e Qarkorit të Partisë së Vlorës për grumbullimin e forcave vullnetarisht dhe kishte vendosur të shkonte vetë. Po plaga i dhimbte shumë e nga të ftohtit nuk i qe mbyllur mirë.

— Dërgo Hiton, të vejë me Partinë në brigadë, — i tha bashkëfshatari Goxho Aliu.

Dhe xha Selimi ashtu bëri. I vuri bustinën me yll të kuq të birit, i dha pushkën, e puthi dhe e përcollë deri te rruga. Po Hitoja nuk u pranua se ishte i vogël e, ca më keq, se nga trupi ishte shtathollë. Në Bramyshnje Hitoja pa rreshtimin e Brigadës dhe i mbeti peng që nuk e pranuan në radhët e saj. Hyso Nuroja, një partizan i vjetër i çetës territoriale të fshatit, bëri shaka me djaloshin duke i thënë se do t'i vijë radha Hitos, por kur të rritej edhe pak! Kjo shaka i mbeti gozhdë djalit të xha Selimit.

Ai ishte anëtar i Rinisë Antifashiste, shpërndante letra konspirative, municione, ilaçe në Gjorm, Lepenicë, Mesaplik, Brataj e gjetkë. Bashkëfshatarët tek e shikonin nëpër monopatet e udhët e Vlorës apo në rrugën malit për te partizanët, thonin «Ja, kaçiatori», se ishte i shpejtë.

Pas ca ditësh xha Selimi rrëmbeu dyfekun, e hondhi në sup e doli te dera. Safa, sa e pa iu afroa.

— U nise, tē goftë e mbarë udha! Këtej mos ki merak, se i mbaj unë fëmijët.

Ai e përqafoi tē shoqen dhe fëmijët dhe shkoi në radhët e Brigadës V Sulmuese.

Sa takoi komisarin, shokun Besnik, iu ankua:

— Nuk bëtë mirë, shoku komisar! Hiton nuk duhet tē ma kishit kthyer! Po më kthyet edhe mua, do tē prishem me ty dhe me komandantin!

Dhe xha Selimi mori udhët e luftës me pushkë në sup e këngë në buzë.

Xha Selimi bënte pjesë në batalionin e dytë, që ishte në krahun e majtë tē formacionit luftarak. Partizanët luftuan me heroizëm e trimëri në zonën e Qesaratit, Luarasit dhe tē Psarit të Zi. Këto forca, së bashku me batalionin «Hakmarrja», shpartalluan forca tē mëdha ballistësh, shumë prej tē cilëve i zunë robër dhe i quan në shtabin e brigadës. Disa të tjerë i kishin grumbulluar te dy gorrifica dhe u bënин roje. Partizanët ua kishin marrë këngëve. Haki Gjondedaj tregon se kur u afroan te xha Selimi, ai u ngrit në këmbë, e mbësh-teti pushkën te një ledh aty afër dhe hoqi një valle që u ka mbetur në mendje. Në fillim, pas tij në valle u kapën dy-tre partizanë, pastaj tē tjerë dhe kështu rrethi i valles u zgjerua. Disa nga vargjet e asaj vallëje tē kënduar ishin:

*Moj, Parti zoti tē faltë,
djemtë i mblodhe në brigadë,
luftë ditë e luftë natë... .*

Rreth valles u grumbulluan dhjetëra partizanë tē kompanisë e tē batalionit.

Komandanti i kompanisë, një burrë i shkurtër e shpatullgjerë, kaloi aty afër dhe tek e pa xha Selimin duke kënduar me shokët, pasi hoqën vallen, u ndal e tha:

— Të shkojmë te gorricat tē shohim si janë katan-disur ballistët.

— E ç'ti shohim, o shoku komandant. Një turi kanë «derrat», si ata që kemi kapur dhe herë tjetër në Gjorm dhe, në Dukat.

Partizanët ia dhanë të qeshurit. Të tjerët, që ishin në anë të lëdheve u afrojan ta dëgjonin më mirë. Aty pranë po kalonin disa ballistë të tjerë, të cilët shqëroheshin nga dy partizanë.

— Ja, shikoji, xha Selim, dridhen e falen sikur e kanë lepurin në bark.

— Çfarë the? — iu kthye xha Selimi. — Jo, o shoku komandant. Kur këndojnë belxhikët tanë, lepuri atyre u zbret në këmbë e ia mbathin pa nam e pa nishan.

— Ia mbathin si «Azis strategu»* i Memo Metos, — plotësoi komandanti i kompanisë.

Brigada XV dhe njësi të tjera partizane do të niseshin për në Veri. Selim Hasanin, Goxho Alinë dhe partizanë të tjerë i kishin thirrur në shtab. Komandanti i brigadës, Shefqet Peçi dhe komisari, Hysni Kapo, u thanë:

— Brigada ka udhë të gjatë. Luftëra të tjera të vështira e presin. Ju e bëtë detyrën tuaj. Tani kthehu-ni në çetën territoriale se dhë atje i duheni Partisë.

Xha Selimi që nuk e priste këtë iu kthye komandantit e komisarit:

— Erdha gjer në Shkumbin dhe të më ktheni? Dalleni, more djem se s'është kështu. Kush ia ka dhënë këto formata Partisë për mua? Jam argasur me luftëra unë! Është e katërtë kjo që bëj. E dini, apo nuk e dini?

Dhe kish bërë be se tamam «nashti e ndiente veten më të fortë», se «këtej e tutje do të bënte kërdinë fare mbi gjermanët». Po qe e kotë. Besniku i kishte thënë më në fund se ky është një vendim që është marrë nga komanda dhe, të mos i bindesh do të thotë të shkelësh disiplinën. Xha Selimi deshi s'deshi u detyrua të kthehej. Po mendjen atje e mbante, te shokët e batalionit, te par-

* Një nga krerët e Ballit Kombëtar.

tizanët e Brigadës që kishin marrë udhët drejt Veriut. Komisar Besniku i dha ca letra më vete.

Në fshat e në çetën territoriale vinin vazhdimisht komunikata, të cilat flisnin për luftimet e partizanëve të Brigadës V. Xha Selimi hiqte në zemër e thoshte: — Bëri mirë Goxho Aliu që nuk iu nda brigadës. C'më bëre, moj disiplinë! Më ndave ngashokët!

— Nëpërmjet — dhinte që është veshur — sëmundjeve që kanë ardhur, që shkaktojnë vdekjen e komandantit, —

— Nëpërmjet — dhinte që është veshur — sëmundjeve që kanë ardhur, që shkaktojnë vdekjen e komandantit —

— Nëpërmjet — dhinte që është veshur — sëmundjeve që kanë ardhur, që shkaktojnë vdekjen e komandantit —

— Nëpërmjet — dhinte që është veshur — sëmundjeve që kanë ardhur, që shkaktojnë vdekjen e komandantit —

— Nëpërmjet — dhinte që është veshur — sëmundjeve që kanë ardhur, që shkaktojnë vdekjen e komandantit —

— Nëpërmjet — dhinte që është veshur — sëmundjeve që kanë ardhur, që shkaktojnë vdekjen e komandantit —

— Nëpërmjet — dhinte që është veshur — sëmundjeve që kanë ardhur, që shkaktojnë vdekjen e komandantit —

NË OPERACIONIN ARMIK TË QERSHORIT 1944 DHE «EPOPEJA E BALLIT KOMBËTAR»

Selim Hasani bëri udhë të gjatë nëpër male, pyje, lumenj e fshatra. Kur doli në fshatin Velçë iu shfaq përparrë gryka e Lumit të Vlorës më gjithë madhështinë e vet.

«Do t'i cojmë letrat në Ramicë sonte, mendonte me vete, duke ecur udhës. Sonte, more, medoemos. Kështu më porositi Besniku. Sa të mbërrish të shkosh drejt e në Ramicë, në këshill e t'u dorëzosh në dorë letrat se janë me rëndësi.»

U ngrit nga ajo buzë ledhi ku ishte ulur për t'u ghodhur dhe mori rrugën për në Ramicë. Nxitonte që darkata zinte në Brataj. Në këshillin e Ramicës njerëzit u gëzuan kur morën letrat e Besnikut.

Xha Selimit i kujtoheshin fjalët e komisarit. Edhe atje në Brataj na duhesh ti xha Selim, edhe atje është njësoj si këtu, në front.

Ishte 11 qershor 1944. U dha sinjali: tri pushkë dhe një bombë. Sinjali u përsërit fshat më fshat të asaj krahine. Xha Selimi mori pushkën e tij e doli te shkëmbi buzë honit, shikoi nga gryka e Drashovicës dhe tha me vete: Prapë, moj e uruar, do të fillosh të këndosh këngën tënde. S'i lëmë gjermanët të ngjiten grykës së Mesaplikut.

Të shtegu i shtëpisë i folën shokët e çetës territoriale. Ato male, skërkë e gryka Selim Hasani me shokë i njihte pëllëmbë për pëllëmbë. Njëzet pushkë oishin

gjithsej. Zunë shkëmbinjtë e Qyramengës, në udhën nga po vinin gjermanët e ballistët. Fshatarët e tjerë do ta drejtonin zjarrin e tyre nga maja e Çekut, në Trapin e Zi e Rrypat e Shelegëve. Maja e Qyramengës, 1864 m mbi nivelin e detit, u bë varr për armiqjtë. Sulmet e ballisteve e të nazistëve fshatarët e Bratit i sprapsën me zjarrin e tyre të dendur dhe me shkëmbinjtë që rrrokullisnin nga lart. Ballistët, duke parë që s'e mirrin dot atë lartësi; »dhanë sinjalin me fraketë dhe kërkuan mbështetje nga ortakët e tyre», siç thoshte Selim Hasanit për ushtarët nazistë, për t'i mbështetur me zjarr artillerie. Filluan goditjet e artilerisë nga bregu i lumit të Shushicës në lartësitë e Qyramengës e të Stogoit, të cilat u mbuluan nga tymi dhe flaka. Hedhja e Brigadës VI Sulmuese në kundërsulm e detyroi armikun të tërhiqej i çorganizuar dhe me humbje të mëdha. Armiqjtë e dogjën dhe e shkatërruan fshatin, shtëpitë e arat, por populli i Bratit e i krahinës së Mesaplikut qëndroi i patundur. Në këto luftime u vra trimi Bajram Nexhipi. Xha Selimi me bëshkëfshatarët iu ndodh pranë dhe e puthi në ballin e skuqur nga gjaku.

— U vrave, bir i babait, po gjaku juaj do t'ia forcojë themeljet Shqipërisë. — Dhe aty për aty i qëndisi vargjet e asaj këngë aq të njohur, që këndohet në të gjithë Lumin e Vlorës:

*Bratin e zuri kusuri,
gjermani luftëni e zuri,
topat tek shkollá i vuri,
iqéllon lart nga Pingadhuli,
u dogj dhieu, u tret guri.*

Në këtë luftë u shqua përfshirë luftëtarë Xhafer Cania, i cili ishte pranë Selim Hasanit. Ai njérin sy e kishte humbur nga punët e rënda që kishte bërë në jetë dhe kështu Selim Hasanit në këngën që i ngriti aty në illogore, ku luftonin së toku, i tha këto vargje:

O Xhafer Cania ynë, Në fitofshim dot lirinë, në Zvicër do ta vemë synë.

Një natë shtatori të vitit 1944 Selim Hasani ishte ndodhur në Sevester. Sa ishte gjëzuar plaku që kishte takuar Shevqet Musarain, i cili kishte ardhur ato kohë në ato anë! Xha Selimi e njinte Shevqetin dhe atë natë diskutuan rrëth «këngës së gjatë», «Epopeja e Ballit Kombëtar». Por prapseprapë xha Selimi nuk e mësoi dot se kush e kishte ngritur atë «këngë». Shevqet Musarai e ngacmoi disa herë plakun. Në bisedë e sipër, xha Selimi i tha:

— E, more bir i babait. Në këtë këngë mua më duket sikur ja, më delnin përpara ata ballistët që kam njohur në këto anë. E i them djalit: E shikon, ky «Buburicka» e ditka mirë të ç'marke janë ballistët...

Të gjithë qeshën në atë dhomë të thjeshtë të atij fshatari të varfër të Sevesterit. Çoç i dogji muhabeti plakut të Bratit se e dinte që Shevqeti ngrinte këngë dhe vjersha e shumë herë ai ia kishte tjerrur edhe xha Selimit, sidomos nga ato që kishte bërë kur ishte në shkollën tregtare. Por plaku mendoi se kushedi kush do të ishte «Buburicka». Biseda rrođhi në të gjitha ngjarjet, pastaj ndaloj te komunikata që kishte në dorë një i ri i fshatit, e cila fliste për luftimet e Brigadës V e të Divizionit I në Veri. Aty në Sevester, duke biseduar me Shevqet Musarain, dikush i dha lajmin plakut të Bratit se në luftë, diku në kufi, në fshatin Morinë të Kukësit ishte vrarë shoku i tij i luftës, Goxho Aliu.

— Të rrallë i kishte shokët Goxho Aliu, — thoshte Selim Hasani. Ndaj nisi të tregonte për vuajtjet e tyre e për luftërat ku kishin shkuar tok nga Mesapliku gjér në Shkumbin...

Pas ca ditësh, kur ishin kthyer nga Kongresi i Rinisë i Helmësit në krahinën e Mesaplikut, dha shfaqje grupei teatral i rinisë të qarkut të Vlorës. Një natë ata e kaluan në shtëpinë e Selim Hasanit në lagjen Kon-

golëm. Perlat Hasani, njëri prej anëtarëve të komitetit qarkor të rinisë vlonjate, në kujtimet e tij thotë:

«Aty nga fundi i muajit shtator 1944 ndodhesha te rapsodi i famshëm Selim Hasani nga Brataj. Më kishte thirrur për darkë. Në bisedë e sipër i thashë plaku 60-vjeçar se një shok i Partisë ka sajuar një vjershë të gjatë për organizatën e Ballit dhe ia recitova nga kreu në fund. Plaku u kënaq shumë se edhe ai ishte humorist i vërtetë. Nga është ky Buburicka, — pyeti xha Selimi. — Nuk e di, — iu përgjegja, — ku mund ta dish, nga është. Duhet të punojë brenda në qytet, ndaj nuk e tregojnë emrin.

— More, more, — tha xha Selimi, — ky duket se është nga Brataj ose Smokthina, tamam gjuha që flasim ne. Pastaj kërkoi: filloje edhe një herë aty te pulat, të keqen babai, sa e bukur qenka! Dhe unë fillova aty ku e deshi rishtaz xha Selimi.

Nga vatë ju burra,/ ju humbtë vula,/ harram i paçi/ byrek e pula.

Pas një javë ndodhesha në Sevaster. Aty më erdhi në mend një bejte e xha Selimit, që e kishte kurdisur për një ballist, i cili gjatë operacioneve me gjermanët s'kishte lënë gjë pa plaçkitur në Brataj:

*I shtinte pulat nga trari,
e s'na la as rracë gomari.*

Pas Çlirimtit u takova me xha Selimin në Vlorë. Pjetja e parë që më bëri qe nëse e kisha mësuar kush ishte ai që kishte shkruar atë vjershë për Ballin.

— Eshtë Sheyget Musaraj, i biri i Halim Musarajt nga Matogjini, — i thashë.

— Mos, more! Edhe më dogji mua që do ta kish bërë ai, prandaj edhe pyeta. Pastë uratën! E kish kurdisur ashtu siç desha unë, — më tha xha Selimi. Po edhe unë ama pas një javë që dëgjova vjershën e Sheygetit, ia kurdisa mirë... E mësove apo jo?

— Po, po, xha Selim, e mësova menjëherë, — i thashë. Ma sollën në Sevaster, shumë e bukur ishte.

Dhe xha Selimi sa é sa herë u ka recituar të rinjve a bashkëfshatarëve të tij vargje nga «Epopeja e Ballit Kombëtar» të Shevqet Musarajt! Ajo ka qenë një nga vjershët më të dashura të tij.

— Në këtë vjershë të Shevqëtit i gjeta ballistët siç i kam parë me sytë e mi në luftë, — thoshte xha Selimi.

LIBRI I TIRANA 1982 LAKU I TETIV SII

“Dhe xha Selimi, sa herë u ka recituar të rinjve a bashkëfshatarëve të tij vargje nga «Epopeja e Ballit Kombëtar» të Shevqet Musarajt! Ajo ka qenë një nga vjershët më të dashura të tij. — Në këtë vjershë të Shevqëtit i gjeta ballistët siç i kam parë me sytë e mi në luftë, — thoshte xha Selimi.”

“DHE XHA SELIMI,
SA HERË U KA RECITUAR
TË RINJVE A BASHKËFSHATARËVET
TË TËJ VARGJE NGÀ «EPOPEJA E
BALLIT KOMBËTAR» TË SHEVQET MUSARAJT!
AJO KA QENË NJË
NGA VJERSHËT MË TË DASHURA TË TËJ.
— NË KËTË VJERSHË TË SHEVQËTIT I GJETA BALLISTËT
SIÇ I KAM PARË ME SYTË E MI NË LUFTË, — THOSHTE XHA
SELI MI.”

“Dhe xha Selimi, sa herë u ka recituar të rinjve a bashkëfshatarëve të tij vargje nga «Epopeja e Ballit Kombëtar» të Shevqet Musarajt! Ajo ka qenë një nga vjershët më të dashura të tij. — Në këtë vjershë të Shevqëtit i gjeta ballistët siç i kam parë me sytë e mi në luftë, — thoshte xha Selimi.”

NE VITET E PARA TE CLIRIMIT TE VENDIT

Clirimi i Atdheut qe gëzimi më i madh për xha Selimin. Edhe pse i moshuar, ai mori pjesë në ndërtimet e urave dhe të shtëpive të djegura e të shkatërruara nga lufta në krahinën e Mesaplikut.

— Do të bëjmë edhe socializmin, si në Bashkimin Sovjetik të Stalinit, — thoshte rapsodi dhe i kënaqej shpirti tek shikonte rininë e fshatit në punë. Mes të rinjve e bashkëfshatarëve Selim Hasani mori pjesë në rregullimin e urës së Gjormit dhe të rrugës Vlorë-Kuç. Të rinjtë e Mesaplikut, kur punonin për rindërtimin e urës së Gjormit i kërkuau xha Selimit t'u ngrinte një këngë.

*Shqipëri, moj e uruar,
shumë ke heq e ke vuar,
je djegur, je përvëluar;
populli duke ndërtuar.*

Sa e sa herë brigadat e punës të rinisë, jo vetëm në Lu-min e Vlorës, por edhe në ndërtimin e rrugës Durrës-Tiranë, Peqin-Elbasan, e kanë kënduar këtë këngë!

Xha Selimin e caktuan rojë në shtëpinë e kulturës në Vlorë. Ndenji pesë a gjashtë muaj dhe shkoi prapë te trojet e shtëpisë së djegur, në bregun e Kongolëmit. Kur e pyesnin, u thoshte: E po, s'rrija dot si hu gardhi në derë të vatrës së kulturës. Edhe ditën e pazarit, nuk më linin të lozja nga vendi brenda orarit e të piqesha me fshatarët që vinin nga ana e anës në Vlorë.

Në vitin 1946 në shtëpinë e Selim Hasanit, disa herë të djegur nga lufta, punuan disa ustallarë për rindërtimin e saj. Midis tyre ishte dhe një fshatar nga Smokthina, të cilit Selimi i ngriti këtë këngë, ku shpreh me humor e realizëm varférinë e viteve të sapodalë nga lufta:

*I shkreti Hajro Sheh,
punë e tija mersele,
ndërton shtëpitë ndër ne
dhjetë ditë e bukë s'pe,
ndahej qulli me qemshe,
edhe magja mykur qe.*

Në tetor të vitit 1947 xha Selimi me bashkëfshatarët e tjerë zbritën në festën e Drashovicës ku do të vinte edhe Komandanti, shoku Enver Hoxha. Kishte takuar minatorët e Selenicës dhe, ja tanë, vetë Komandanti po vinte drejt tyre, në sheshin e repreve. Midis popullit të Labërisë ai takoi e përqafoi edhe Selim Hasanin, që po hiqte valle e këndonte për Partinë e Shqipérinë e re. Selim Hasani tek shikonte e dëgjonte Komandantin që fliste në tribunë i kujtoheshin udhët e luftës, «shokët e trimat partizanë», «çetat e batalionet», «djemtë e Partisë levendë», këngët që kishte ngritur për ta e për Partinë në ato ditë të vështira të operacioneve armike e betejave të ashpra pér çlirim. Ja tek ishte vetë Komandanti që fliste përpëra popullit.

Të gjitha ato për të cilat fliste Komandanti, «përtrimat e luftës», «Stalinin e madh», «jetën e re», «Shqipérinë bahçë me lule» ai i futi te kënga e tij e bukur kushtuar shokut Enver Hoxha, «Si bilbili në selvi».

Tek ligjëronte udhëheqësi i dashur i Partisë e i popullit, një shok i komitetit të Partisë për Vlorën i tha xha Selimit se ishte caktuar për të marrë pjesë në mbrëmjen tematike që do të organizohet në Vlorë për ndër të Komandantit. Ai ishte ulur pranë rapsodit popullor Xhebro Gjika dhe babait të dëshmorit Spiro Gjiknuri. Komandanti shëndetin e parë e ngriti për popullin he-

roik të Vlorës. Të gjithë u quan në këmbë dhe thërrisin: «Rroftë Komandanti!». Këngët labçë të ngritura aty për aty endezen flakë sallën. Në fillim xha Xhebroja, ky luftëtar i vjetër nga Tërbagi, ia nisi këngës:

*O popull, vet'e kërkove,
këtë ditë madhështore,
more pushkën e luftove
Komandantin vetë e nxore,
Shqipëria popullore.*

Kënga e xha Xhebros u pëlqye shumë. Selim Hasani i hodhi dorën në qafë shokut të tij dhe pastaj e përqendroi vështrimin te Komandanti, i cili ngriti gotën e tha për xha Xhébron: «Ta pimë shëndetin e këngëtarit që ka qenë një luftëtar i mirë dhe që sot është një punëtor i palodhur»¹.

Pastaj nisi Selimi këngën e vet. Të gjithë dëgjonin se është dinin që ai i «qëllonte» këngët. Në fillim këndoi «Në njëzetë e katër maji». Kjo këngë u duartrokit gjatë dhei ai lexoi në sytë e të gjithëvensikur i thonin të këndonte një tjetër, ta dëgjonte edhe një herë Komandanti. Dhe s'ua prishi, këndoi këngën: «G'bën, moj Shqipëri sermaja».

«Kjo vjershë e thjeshtë e kënduar nga një çoban i maleve të Vlorës, që ndoshta nuk di dhe të shkruajë, trëgon shpirtin kryengritës dhe fisnik të fshatarëve tanë që nuk janë mposhtur kurrë dhenë kohët më të zeza të historisë sonë. Kufrë nuk pushoi davaja, — thotë ky këngëtar i thjeshtë i popullit dhe për çudit të të gjithëve, Shqipëria luftoi çdõ okupator, luftoi shtetet më të fortë të Evropës imperialiste, luftoi ata që kishin ushtri të mëdha dhe flota të tmerrshme, por asnjëherë s'pranoi të përkulej nën robërinë e tyre»². Sa herë e kënduar Selim Hasani këtë ditë dhe ajo mbeti në kujtesën e tij «ditë e shenjtë».

1) Gazeta «Bashkimi», 3 tetor 1947

2) «Literatura jonë», tetor 1947

NETE GUSHTI TE VITIT 1948

Xha Selimi ishte ulur në qoshen e dhomës e kujtonte me djemtë e tij udhët e luftës dhe ditën e fitores, nëntorin e 1944-ës. Lufta ishte fituar me gjak e sakrifica. Armiku nazifashist la kockat, nëpër këto brigje e gërxhe. Ja Murroja, qeni i shtëpisë së xha Selimit, si pinte hirrë në një helmetë nazisti, që Hitoja e kishte zgjedhur midis një grumbulli helmetash në Drashovicë. Ato ditë Selim Hasanit i kishte ardhur një letër nga të rinjtë vullnetarë të brigadës «Zonja Çurre», që punonin për ndërtimin e hekurudhës së rinisë Durrës-Peqin. Të rinjtë dhe të rejat shkruanin për këngën «Natë e ditë të punojmë» se e këndonin jo vetëm ata, vullnetarët e brigadës së Vlorës, por edhe shokët e brigadës së Tepelenës, Përmetit, e Skraparit. Në kursin kundër analfabetizmit në qytezë mësuesi një ditë, në një dërrasë kishte shkruar vargjet: Natë e ditë të punojmë, shkë, vullnetarë të shkojmë! Shqipërinë ta lulëzojmë! — dhe ua shpjegonte të rinjve të brigadës së Sarandës se këtë këngë e ka ngritur xha Selimi që rron në Brataj të Mesaplikut; se ai ka ngritur edhe këngë të tjera për Komandanit e Shqipërisë... (Këtë këngë e kishte shkruar Hitoja në një letër dhe ia kish dërguar një shokut të tij të grupit të këngëve të Bratit që ishin vullnetarë, në hekurudhë). «Djemtë punojnë për ta ndërtuar Shqipërinë e re, — mendonte plaku, — dhe armiku vërtet theu qafën, por prapa ai ka lënë rrënjen, të cilat duan të lëshojnë degë».

Ja, atyre maleve ku ishin strehuar partizanët dhe Hitoja e djemtë e tjerë të fshatit kishin çuar ushqime e veshmbathje, letra e trakte, tanë aty-këtu fshihnin kokën banda të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit. Ata kërkonin dhe ndihma nga «miqtë» dhe «aleatët» e fuqive të huaja që të minonin e të rrëmbejn pushtetin. Këto bisedonte xha Selimi me djemtë, ndërsa në qill u dëgjua një zhurmë aeroplani që mori tutje mbi malet e Kurveleshit. Këta aeroplanë hidhnin fletushka, ku i bënin thirrje popullit të ngrihej kundër pushtetit të tij. Ndaj plaku gulçonte e hiqte në zemër.

— Është kockë e vjetër shqiptari dhe s'i ha kollaj këto, more djëm! Komandanti nă ka thënë ta mbajmë barutin të thatë dhe ne e kemi pushkën top, — u thoshte xha Selimi.

Hitoja, që kishte mësuar të shkruanë e të lexonte, mbante në dorë një fletore të nënë Safës. Ajo kishte mbajtur disa shënimë për organizatën e gruas së fshatit gjatë Luftës Nacionaclarimtare dhe në ditët e para të Çlirimt. Diku djaloshi ndali dhe levoi me zë të lartë, ta dëgjonin edhe të tjerët. «Tani fshatarët po rregullojnë shtëpitë e djegura nga lufta dhe ustallarët gjetën një grusht me gëzhoja italiane. Si këto gëzhoja mbaj mend se morëm një arkë me fishekë gjatë operacionit, te shtëpia e Gjysh Muhametit dhe e dërguam për në Mesaplik. Tek úra e fshatit i quam natën. Kishim marrë edhe dhjetë palë çorape e tetë triko e xhamadanë, që i kishin bërë gratë e fshatit. Vena Brokaj hoqi trikon e saj dhe kështu ato u bënë nëntë triko. Ashtu bëra dhe unë. E hoqa trikon time dhe e futa në hejbe. — Do t'u duhen djemve se po afron operacioni, moj motër, — më tha Vena, dhe rrugës kujtonim ata që kishin ikur nga fshati në luftë».

— Mos e humbni këtë fletore se do t'u duhet, more djem! — tha xha Selimi. Atje kishte emra të grave të fshatit, trikot që kishin dhënë për luftën, ndihmat dhe materialet e tjera. Por atë çast bisedën e ndërpren një batare armësh që u dëgjua matanë lumit të Shushicës.

— Ç'të jetë kjo, — tha plaku dhe doli në dritare.

Krismat u dëgjuan përsëri. Veshi i stërvitur i xha Selimit e ndjeu se matanë lumit, në Ballaban, po kërciste pushka.

— Pushkën! — i tha djalit dhe doli së bashku me të në udhën e fshatit për tek ura që lidh Bratin me Smokthinën. Gjithë fshati u zgjua. Me përvojën e kaq luftërave ata, pa zhurmë, rrëmbyen armët dhe morën udhën tutje. Edhe Shushica që gurgullonte në këmbët e atyre maleve ishte e shqetësuar si vetë njerëzit. Forcat e Sigurimit të Shtetit i kishin bërë pritë kriminelit Lahe Nuro dhe një bande diversantësh. Ky lajm u përhap gjithandej, shtëpi më shtëpi dhe lebërit zunë shtigjet. Pas betejës, në të gdhirë, u vra në përpjekje ish-partizani Hyso Nuro. Në brigjet e këtij lumi Hysos i ishte vrarë edhe i vëllai, Laze Nuro, zëvendëskomandant batalioni në Brigadën V Sulmuese.

Pranë trupit të Hyso Nuros atë mëngjes u gjendën Hitoja dhe një djalë nga Ramica. Hitoja u ul në gjunjë, i ledhatoi plagën në cepin e ballit dhe i ngriti kokën me pëllëmbën e dorës së tij.

— Tani më erdhi radha edhe mua, Hyso!

— Do ta mbrojmë pushtetin popullor me gjak. Po si na iku kështu Hysua?! — thoshte xha Selimi dhe vriste mendjen të thurte me atë dhimbje vargjet e një kënge. Kënga që ngriti u mor vesh brenda javës në Ramicë, Smokthinë, Brataj, Lepenicë, Velçë, Bolenë e gjetkë.

*Të bijtë e Nuros u vranë,
jetën për Partinë e dhanë.*

Hitoja, tek dëgjonte këngën e të atit, solli ndër mend punët që kishte bërë: bari me dhen, punonjës telefoni, infermier, punëtor në guoren e Drashovicës. Në të gjithë punët kishte punuar me dëshirë. Po atij i pëlqente shumë të ishte ushtarak. Ndaj iu lut të atit të shkonte me forcat e ndjekjes të MPB. Xha Selimi nuk i tha asnjë fjalë, veçse e puthi në sy e në ballë të birin dhe nga gëzimi zbriti gjer në Vlorë për ta përcjellë në krye të detyrës.

«Dhe nisi për djaloshin Hito Minga ajo jetë mundimesh, privacionesh e sakrificash aq të përngjashme me ato të partizanëve dikur. Dhe u mat ai, si qindra shokë të tij, kushedi sa herë me vdekjen, jetoi ditë e net me radhë i izoluar nga stuhit bore në shtigje malesh dhe shpella ujqish, pa bukë, pa zjarr, pa rroba, në pritë, në përgjim të bandave të diversantëve. Zbuloi planet dherë lëvizjet e tyre dredharake, u ndesh me vdekjen grykë më grykë, dhe vuri në rrezik jetën e tij, që populli të jetonte e të gëzonte i lirë.»¹⁾

Xha Selimi gëzohej shumë kur merrte letra nga komanda që djali i tij i kishte «zbatuar porositë e babait» dhe «i kishte zbardhur faqen përpara Partisë e Komandantit».

Në kujtimet e tij në një blok të zhurbavitur Hito Minga shkruante: «Sa e sa herë me shokët e njësitet në shpellat me borë, në repart e qafa malesh këndoja edhe këngët e babait. Një këngë e tillë ishte dhe ajo «Dërgon Titoja spiunë», të cilën babai e ngriti për shokët e mi para ca kohësh kur isha me leje në shtëpi.»

MBAHET BABAI KRYELARTË

1) Shevqet Musaraj, «Mbahet babai kryelartë», revista «Në shërbim të popullit», Nr. 1, 1979.

XHA SELIMI DHE MALESORI I HOTIT NE MAJ TE VITIT 1950.

Atë maj të vitit 1950 xha Selimi, tek rrinte në oboirin e shtëpisë në fshatin e tij, mori lajmin e gëzuar: Do të shkonte në Tiranë, të votonte në emër të popullit të Vlorës, aty ku do të zgjidhej deputet udhëheqësi i dashur, shoku Enver Hoxha. Hodhi pallton krahëve dhe u nis për në Vlorë, në Komitetin e Partisë. 28. Maji i 1950-ës xha Selimi u qjeti në Tiranë. Qyshe herët në mëngjes ishte ngritur së bashku me një shokun e tij nga Hani i Hotit ei do të këtotonin për Komandantin Malësori i Hotit kishte ende në mendje tabelën e madhe që ishte vënë në strungut e gështenjës, ku bëheshin mbledhjet e fshatit në Hot e shkruhej: «Lufta për realizimin e planitështë lüftë përnjë jetë më të mirë për popullin». Dhe në mendje plaku bluante diçka. Ky plani dashka të na sigurojë bëze, lëpinga, sheqer, vajguri. Po të na i sjellë ujët e maleve e të ruginave në katund, fshatarët e berrat s'kancë me u djegë ma për ujë si janë djegë deri më sot! Po mendja nuk i mbushej kollaj se do të zgjidhej një çështje kaqe madhe, prurja e ujtit në katundet e 'Malësisë së Madhe'.¹⁾

— Dhe po 'nuk' e prunë ujët e bjeshkëve, do të çpojnë malin si në Dajt, — i tha xha Selimi.

— Mos, more! — iu kthyesh plakut i Hotit dhe i rroku dorën xha Selimit. — S'kangja që s'ban Partia dhe Komandanti.

1) Shevjet Musaraj, «Literatura Jonë» nr. 6, 1950.

Malësori i Hotit i tregonte xha Selimit për jetën e re të fshatit, për shkollën që kishte hapur Partia. Pastaj biseda rrođhi te «mbrojtja e Shqipërisë nga qentë e Titos, që po na ngatërojnë atje në kufi».

— Nuk na çart qeni Tito ne, se kemi Komandantin të fortë, — tha malësori i Hotit.

— Kur foli Komandanti për Titon e zagarët e tij, unë u thashë disa bashkëfshatarëve: Tani Titoja u lidh si qeni në zinxhirë, ja ktheu xha Selimi. Selim Haxhani dhe malësori i Hotit dëku hedhur krahët njëritjetrit në sup, bënë tutje për nga kutia e votimit, te zona elektorale nr. 108. Ora s'kishte vajtur akoma 6 e mëngjesit dhe malësori i Hotit e xha Selimi shikonin ndërtimet e reja të Tiranës, bulevardin, shatërvanin në lulishtë përpara komitetit ekzekutiv. Oshëtima e sirenave në kryeqytet lajmëroi për hapjen e kutive të votimeve. Delegatët këndonin e brohoritnin për njeriun më të dashur të Shqipërisë.

Pleqtë u futën në qendrën e votimit. Pranë kutisë ishte fotografia e Komandantit, rrëthuar me trëndafilë dhe lule të njoma. Malësori i Hotit iu afroa kutisë së votimit, e zuri me të dy duart dhe e puthi me dashuri fotografinë e Komandantit. Pas tij e puthi xha Selimi. Malësori i Hotit u kthye nga kutia pa kandidat dhe tha: «Kjo është kutia boshe, Selimi. Për ne popullin e varfër bosh ka qenë tërë jetën.» Xha Selimi shtoi:

— Bosh e lëmë, dhe do ta lëmë këtë kuti, gjersatë vdesim, se votat do t'i japim për Komandantin. Pastaj xha Selimi bëri tutje nga shokët e grupit të Vlorës, që po e thërrisin.

Në mes të atyre njerëzvë dikush e kapi për krahu dhe bënë tutje. Po xha Selimi nuk e lëshonte malësorin e Hotit. Aty për aty xha Selimi shpërtheu në këngë:

O Selim se të kërkojnë,
të këndosh që të dëgjojnë,
Enver Hoxhën e votojmë...

— Të lumtëgoja, ibre burrë! — iu hodhë në qafë

plaku i Hotit, xha Selimit kur mbaroi këngën. Pastaj e pyeti: — Si thue, he burrë, a kemi me u pa me Komandantin? — Malësori e shikonte xha Seliminë në të dy sytë, sikur e kishte ai në dorë. Së përfundoi e shtypet.

— E, ç'më pyet mua, a i vrarë! — Semjës di unë më shumë nga ti! E di programi atë punë, s'ë dimë ne.

— Hallall i kjoftë programit! Po a s'ban me i kja hallin atij programit? Se për tanzonë, asht marre me u kthye në katund pa takue Komandantin.¹

Të dy, plaku i Hotit e xha Selimi, tek ishin në radhë të parë të delegatëve shikonin nga udha e hapur. Pionierët që e panë të parët Komandantin, vrapiuan t'i dhuronin lulet. Xha Selimi dhe plaku i Hotit bënë përpara.

«Të dy pleqtë që janë në radhë, të parë të delegatëve e humbasin durimin. Këmbejnë shpejt e shpejt nga një vështrim në mes të tyre, dhe sikur e bënë me fjalë, u shkëputën nga kolona e shokëve.

— Disiplina është disiplinë, — tha nëpër gojë xha Selimi. Po edhe të tilla raste s'vijnë kollaj për ne.

— Edhe ty të lumtë goja! — ia priti malësori i Hotit. Se kenkemi të dy në një mendje. — Dhe që të dy iu hodhën e zunë nga një shteg të mirë.

Xha Selimi priti dhe përqafoi i pari Komandantin. S'iu ndodhën lule, as dhurata për njeriun e dashur që takoi, po vetëm dy vargjë:

Rroftë Enver Hoxha që thonë, Shqipëria gjet të zone².

Më tej, malësori nga Hoti i doli përpara Komandanit e pasi e përqafoi, i tha: «Tu njatëjeta, se djale ma të mirë s'ka pasë ndonjëherë Shqypnia! Shoku Enver, e kam shtëpinë afér kufinit, po kurrë ma të forte s'e dij vedin e ma të sigurt shpin se sot. Nuk i kena aspak

1) Shevqet Musaraj, «Literatura jonë», nr. 6, 1950.

2) Shevqet Musaraj, «Literatura jonë», nr. 6, 1950.

frigë qent e Titos, se jena të fortë e kena mik Stalinin».¹

Atë pasdreke delegatët i guan për të vizituar kombinatin e tekstileve që po ndërtohej dhe stacionin e misrit në Kamëz.

— Mës, more, — thoshte xha Selimi, — më kishte thënë mua djali se në Tiranë, po ndërtohet një fabrikë e madhe për beze e basma për popullin po nuk marrte mendja si do të jetë!

— Nuk do ta harroj sa të jem gjallë këtë fabrikë, e kam me ba çmos me ardhë edhe një herë, por të mbarohet krejt — tha malesori.

Të dy pleqve ulur tek oborri i Pallatit të Brigadave, nuk u harroheshin fjalët aq të dashura të Komandantit kur u tha te kutia e votimit se do të ishte kurdoherë biri i popullit, një ushtar i thjeshtë i popullit dhe i Partisë, që do të luftonte me të gjitha forcat deri në vdekje për popullin dhe Partinë.

Ja tani, ata prisin përsëri të takoheshin me Komandantin në Pallatin e Brigadave.

«Jashtëzakonisht i madh është entuziazmi i delegatëve, të cilët të zënë dorë për dorë me Komandantin në mes, lozin valle. Vjershëtari i njojur popullor Selim Hasani nga Bratajt e Kurvelëshit deklamon një vjershë të tijën kushtuar gjeneral armate Enver Hoxhës.»²

Të nesërmen xha Selimi u nda me malësorin e Hotit

Me gjëzim të madh ai u kthye në Vlorë dhe mori rrugën për në Brataj. Bashkëfshatarët iu lutën t'u tregonte për takimin me Komandantin. Ai u foli me gjëzimin më të madh për Komandantin, për kombinatin e tekstileve «Stalin», për lagjet e reja... Donte si e si t'i kënaqte. Pastaj, e vazhdoi bisedën me këngë. Të gjithë u mblohdhën rrëth tij dhe kënduan:

1) Gazeta «Bashkimi», 29 maj 1950.

2) Gazeta «Bashkimi», 29 maj 1950.

DITE FESTE NË DRASHOVICË

Ish te 14 shtator i vitit 1952. Nga gjithë fshatrat e Labërisë po zbrisnin lebërit me këngët e tyre për tek ura legjendare, pranë rrepeve të moçëm. Selim Haxhiu hodhi sytë në të dy brigjet e lumiut, pastaj te ura ku u plagos nga mortaja atë ditë shtatori të 1943-shit.

Në kodrat e Kallafetit krisën batare pushkësh. Këto krisma i tërroqën vëmendjen rapsodit dhe ai bëri tutje nga rrepet e moçme.

— Hajde, xha Selim, hajde t'ia marrim një këngë, — i thanë ca të rinj nga Ramica. Ai i përshëndeti dhe u ul pranë tyre te trungu i një rrapi degëgjerë dhe ia nisi shtruar-shtruar: «Moj Parti, t'u shtoftë nami,/ S'u tunde nga istikami».

Xha Selimi këndonte dhe herë-herë hidhte vështrimin mes njerëzve nën rrepe se mos i kishte ardhur i biri, Hitoja.

Tri ditë më parë, tek arra bri shtëpisë e ledheve në Brataj, i kishin lexuar letrën që i biri i shkruante nga Kruja. Atë copë letër babai ia mbante në xhep, me ato fjalët që i kish shkruar i biri: «Baba, shokët e repartit më kanë thënë se do të më japid leje për të ardhur në festën e Drashovicës. Sa shumë do të gëzo hem kur të takoj ty, shokët e bashkëfshatarët për të cilët më ka marrë malli! Ti, baba, patjetër do të kesh ngritur ndonjë këngë të re. Mos harro se dhe unë do të këndoq në grupin e fshatit.» Kishte pesë ditë që e kishte nisur Hito Minga atë letër për në shtëpi.

Atë mëngjes, herët, kur do të nisej për në shtëpi, shokët e uruan:

— Udhë të mbarë! — Të fala xha Selimit dhe i thuaj të ngrejë ndonjë këngë të re për ne, se ia marrim së toku me armët tonë.

— Patjetër, do t'u bie ndonjë këngë të re, — ua ktheu Hitoja.

Dhe Hitoja rrëmbeu çantën e doli në udhën mes shkrepave. Po zilja e telefonit ra me një sinjal të vazhdueshëm, të tendosur. Krisma pushkësh u dëgjuan në luginë.

Ai dhe shokët duhej të shkonin në krye të një detyre të papritur. Në shpellat e Mamurrasit kishin rënë në gjurmët e një bande diversantësh.

Në atë pritë buzë përroit dhe shpellës së Mamurrasit, — tek shtrëngonte në gjoks automatikun, fuste dorën në xhepin e xhaketës dhe dora padashur i prekte në paketat e cigareve që i ruante për t'ia dhënë të atit kur të kthehej në shtëpi. Ato paketa i kujtonin atë këngë të dashur të babait të tij. «Titon me gjithë spiunë, / për gryke si mec i zumë.» Me automatikun të mbështetur në gjoks, Hitoja me shokë zuri shtegun mbi lumë. Dhe pritën ashtu një copë herë. Pastaj breshëria e automatikut të Hitos i hodhi të gjithë në sulm në grykën e shpellës. Flakët përzhitën edhe shkurret e gështenjat përreth. Dy orë vazhdoi beteja. Duke iu afruar grykës së shpellës Hitoja ua bëri me shenjë shokëve të dëgjonin zërat që brenda saj. Po atje nuk dëgjohej asnjë zë. Hito Minga doli nga shkëmbi dhe u hodh në grykën e shpellës. Midis 16 diversantëve që ishin shtrirë të vrarë, njëri ishte ende i gjallë. Ai nxori revolen dhe shtiu mbi Hito Mingën. Te dera e shpellës Hitoja, duke u mbështetur për rrasën e shkëmbit, belbëzonte këngën më të dashur të babait, «Moj Parti, t'u shtoftë nami».

Shokët e ngritën në krahë dhe e çuan ashtu peshë në repart. E donin shumë Hiton. Të nesërmend trupin e tij e nisën për në fshat.

Në sheshin e rrepeve të mocëm të Drashovicës njerëzit grupe-grupe ua kishin nisur këngëve të tyre të

dashura. Xha Selimi dhe bashkëfshatarët, e tij u ngriten nga rrapi shekullor dhe bënë tutje për nga podiumi i festës, sepse po afronte ora e mitingut. Vështronte andej-këndej, po Hiton nuk e pa dot në festë xha Selimi. Tek bënte atë copëz udhë buzë Shushicës, iu kujtua përsëri i biri t'ia merrnin njëherë këngës bashkë. Sa i kishte marrë malli! Hitoja i donte këngët shumë. Që gjatë luftës, ai i lutej të atit të ngrinte ndonjë këngë që ta këndonin në grupin e organizatës së rinisë komuniste të fshatit.

Nga i ati dhe xhaxhai i tij, Matoja, kishte mësuar shumë këngë të kryengritjeve kundër Tanzimatit dhe të luftës së 1920-ës.

Njerëzit po grumbulloheshin në miting, Selim Hasani hodhi shikimin përpëra.

— Kanë ardhur nga Tirana, — tha Matoja.

— Paska ardhur Besniku, — tha plaku dhe bëri tutje në mes grumbullit të njerëzve për ta takuar e për të kujtar kohën e shkuar.

«Kish marrë fund tashti për Selim Hasanin ajo jetë zie dhe mjerimi në shpellën e Stogonisë buzë Shushicës, rrëzë maleve të Vetëtimës, ku kishte banuar vite me radhë. Po prapë ishte e pamundur që në këtë valë gëzimi të mos u kujtohej udha gati 70 vjeçare, e mundimeve. Ja ku i shfaqej si nëpër mjegull shpella e errët që buronte ujë, kusia me hithra të ziéra varur në kramastar, Safa, shoqja besnike e jetës tek, përpëlitez nën ethet e lindjes dhe fëmija i parë Hitoja, tek lindi në atë shpellë. Gëzim i madh pat qenë ky djalë për prindërit, por edhe plagë në zemër njëkohësisht. I që shtuar familjes edhe një gojë. Me se do të ushqeqeja dhe rritej ky fëmijë? Megjithatë fëmija u rrit si i ati, me lakra pa vaj dhe bukë lëndësh lisi, se mungonte misri. Dhe kishte arritur moshën e 14-vjeçarit ai, kur ishte ndezur lufta kundër fashizmit dhe tradhtisë. Kishte njuhur cizmen e rëndë të të huajit gjatë operacioneve kur i vinte zjarrin fshatrave dhe vriste e varte pa gjyq djelmt dhe vajzat e popullit. Kishte parë të atin e plagosur në luftën e Drashovicës dhe i kishte ndenjur mbi

kokë gjersa u shërua. E kishte pushtuar Hiton e vogël një urrejtje e thellë ndaj armikut dhe një dashuri e madhe për lüftën partizane.¹ Këto mendonte xha Selimi për të birin e jetën e tij, tek dëgjonte të deleguarin e Komitetit Qendror të Partisë, shokun Hysni Kapo, që fliste përparrë popullit në sheshin e rrrepeve. Nën rrepet e moçëm u ulën të hanë drekë. Njerëzit i luteshin xha Selimit dhe ai ua merrte këngëve njëra pas tjetrës. Kur mbaronte këngën, i thonin: «Të këndofte zëmra, xha Selim!» Pastaj xha Selimi u kthyte nga i deleguari, dhe shokët e tjerë, duke mbajtur gotën në dorë.

«Kam parë disa luftëra unë, se jam i vjetër, po kam parë edhe shumë trima kam jetuar, folur dhe kam luftuar bashkë me ta. Më kujtohet Sali Murati, Toto Bolena, Kanan Mazja, ai djali i bukur e trim si asllan që ia prishi bukurinë plumbi i hasmit. E kam ndër sy Selamin e gunat mbi telat me gjemba dhe italianët kur i hodhëm në det. Po partizanët e partizanet e këta të sotmit që erdhën pas tyre e bënë beli se të ç'gjaku ishin dhe ku e morën fuqinë. Hajdeni, shokë, ta pimë këtë gotë për Partinë dhe Enver Hoxhën.² Të gjithë u quan në këmbë dhe e pinë me fund. Xha Selimi ia nisi prapë këngës së tij: «E tunde, Parti, e tunde».

— Kjo është këngë e re, xha Selim?

— Po, more bir, — iu kthyte ai një djaloshi që kishte pranë. E ngrita këto kohë në Tiranë, në Lidhjen e shkrimitarëve. Gjithëjeta jona është këngë, ndaj ne shqiptarëve s'na hiqet kënga nga buzët.

— Gëzuar, xha Selim! — i tha i deleguari. Ta pimë për Partinë dhe shokun Enver!

— Gëzuar, të na rrojnë e të marrin edhe nga ditët tona! Ti thuash shokut Enver në Tiranë se xha Selimi dhe shokët e tij do ti këndojnë gjithnjë Komandantit

1) Shevqet Musaraj, «Mbahet babai kryetartë», revista «Në shërbim të popullit», nr. 1, 1979.

2) Zihni Sako, «Për nësimin e për në pritë», gazeta «Drita», 30 nëntor, 1975.

dhe Partisë, se ne shjemi vetëm për punë e pushkë, por edhe për këngë.»

Xha Selimi e piu gotën krah për krah me të deleguarin. Pas pak të deleguarit i thanë për lajmin e vrasjes së djalit të xha Selimit.

Shoku Hysni Kapo tek e shikonte xha Selimin mes këngëve dhe njerëzve të tij të dashur, ia nguli sytë thellë. Letrën me lajmin për vrasjen e djalit të xha Selimit e kishte në dorë. Në të shkruhej: «xha Selimit nga Bratajt i është vratë djali, Hitoja, në përpjekje me bandat në rrethin e Krujës». E tani nën rrepet ku bëhej festa, kishte ndalur edhe makina me trupin e vratë të Hito Mingës.

— Ku është xha Selimi? — pyeti Besniku, duke vështruar me cepin e syrit, se e dinte ku ishte.

— Këtu jam, — iu përgjigj xha Selimi.

Besniku iai dha lajmin e vrasjes të të birit drejt për drejt se e dinte me ç'neri kishtë të bënte. Xha Selimi vetëm e pyeti:

— Ku u vra, biri i baba, pse u vra?

— Në përpjekje me bandat e diversantëve përmbrojtjen e pushtetit popullor, në rrethin e Krujës,

— i tha Besniku dhe e përqafoi veçanërisht për atë qëndrim burrëror. Njerëzit u quan nga trapeza dhe bënë tutje në sheshin e trepeve.

Selim Haşani bëri ç'bëri ashtu i rënduar, ia mori një këngë. Rethi tyre u mblohdhën njerëzit, mbanin një iso të myllur, të thellë dhe epike:

Drashovicë bëhet festimi, vjen i vratë Hito Selimi.

Kënga me historinë e vrasjes së djalit dhe qëndrim burrëror të xha Selimit u përhap në të gjithë fshatrat e Labërisë dhe të Myzeqesë së vogël. Qe pasdite. Frynte një erë e lehtë në grykën e Mesaplikut e lumen

¹⁾ Shevqet Musaraj, «Mbahet babai krygjantë», revista «Në shërbim të popullit», nr. 1, 1979.

e Shushicës. Mbi malin e Tartarit e të Çikës shtëllunga resh, herë të bardha, herë të errëta, lëviznin drejt perëndimit.

Shoferët i nisën makinat në udhën e Kuçit për në fshatin Brataj.

Fshati, kur mori vesh për vrashjen e djalit të madh të Selim Hasanit, u grumbullua i gjithë në oborrin e shtëpisë së tij. Disa gra të lagjes Kongolëm, që e panë makinën të parat, ia nisën kujes e të qarave sipas ligjeve të Lumit të Vlorës. Selim Hasani tek pa gjithë fshatin të mbledhur në oborrin e shtëpisë, ngadalësoi çapat. Balli iu vrenjt nga dhimbja e mallëngjimi. Por i foli vetes. Mos edhe ai duhej t'ia niste kujes? Iu afroa Safës, gruas së tij, e mori për dore dhe duke iu afroar sofatisit tek arra bri shtëpisë, u tha njerëzve që të futeshin brenda. Pastaj u kthyte prapë nga e shoqja, e pa drejt në sy dhe i tha:

— E shikon, moj Safë, se ç'djalë na rriti Partia?!

— Hallall e pastë, Selim! Hallall e pastë, se na ndëroi me Partinë e me Shqipërinë, — ia ktheu ajo. Njerëzit zbritën arkivolin nga makina dhe e futën në shtëpi. Shoku i luftërave me emër, Muço Deloja, iu afroa Selimit pranë dhe dicka i tha në vesh. Xha Selimin ai vetë e kishte ngritur në krah kur u plagos në bêtejën e Drashovicës më 1943. E kish njohur dhe më 1920 në luftën e Kaninës, ndërsa tani, në festën e Drashovicës, qe kjo që qe!

— Gjithnjë kockë e fortë ky njeri, — tha me vete Muço Deloja.

Selim Hasani, plaku i rrahur nga aq erëra të forta, u fut brenda në shtëpi, në odën e yetme që i kishte hedhur çati të re. Një pjesë të shtëpisë ende nuk e kishte rregulluar. Ajo kishte mbetur e djegur dhe e rrënuar që nga koha e luftës. Xha Selimi çoku kish, bëre shaka me të bijtë, e sidomos më Hiton:

— Tani që fituam luftën, do të bëjmë kala. Se gurë e drurë kâ mali plot.

Në oborrin e shtëpisë dëgjoheshin zëra fshatarësh që kishin ardhur aty.

— Hitoja i Selimit, djale i rrallë në fshatin tonë.
— E paska marrë plumbi ndënë sisë.

— Kockë e fortë xha Selimi! ...

Bisedat vazhdonin në oborr dhe zërat nga dritarja pranë arrës hynin brenda. Selim Hasani, për të thyer heshtjen, u tha njerëzve aty në odë:

— Ia kemi bërë hallall Partisë djemtë, se ajo i mësoi të vritten me nder kundër armiqve të Shqipërisë!
Pastaj nisi t'i recitojë vargjet me zë të lartë:

*Djale, ndaj të kisha rritë,
për sot e për këtë ditë,
për në sulm e për në pritë*

Të gjithë njerëzit e shikonin rapsodin patriot në dritë të syrit me dhimbje dhe me adhurim. Sa herë e kishin parë nëpër festa, dasma e gëzime! Sa herë kishin hequr valle e kishin kënduar për Partinë dhe për shokun Enver! Sa hëre e kishte marrë me vete për të gjetur një dorë misër në Llakatund e në Armen! Një natë, para një viti të ri, Hitoja i kishte thënë të atit:

— Tani ne, baba, luftojmë që të mbajmë pushtetin e popullit e ta forcojmë, se armiqtë duan të na i marrin nga dora e të na bërdhin për një copë bukë në Llakatund e Selenicë, si dikur. Po Partia dhe Komandanti janë të fortë dhë kujtdo që do të na cenojë do t'ia kthejmë patkonjtë nga dielli!

Dhë ato që kish thënë, i vulosi me gjakun e tij. Njerëzit u bënë gati ta nxirrin nga shtëpia për ta quar në várrezat e dëshmorëve në Vlorë. Ata dolën pas arkivolit. Xha Selimi i hodhi krahun gruas së vuajtur e të rrähur tok në aq luftëra e halle. Befas ajo u doli para njerëzve:

— Pa daleni, daleni, se kam edhe unë për të thënë!

— Ndali pak, vështroi trupin e të birit të shtrirë në arkivol dhe filloj me një zë të dhimbshëm, vaj e këngë tok, t'ia thotë asaj këngë të xha Selimit që tani i dilte nga shpirti si asnijëherë:

Kum... Plumbin nën sisë e more, mi kështet qëndrues
ne maj të asnjë fjalë nuk e fole, tashmë këtë Vlorë për
të vënë treg pér tokë e pushove.

Njerëzit e ardhur dhe bashkëfshatarët shikonin në
në Safën. Ngritën arkivolin dhe u dukej sikur s'e mba-
nin mbi supe, por mbi shtratin e asaj këngë që sapo
kishte kënduar e ëma sipas vargjeve të të shoqit.

XHA SHKU PËRSHPEMBER TE BIRRI
SI CDO LUNETITARI

Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë
vjeç. Kurrut është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.

Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.

Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.
Xha Shkulli që do t'i kështet qëndrues dëgjave
përveç Kurrut që është i lindur me këtë vjeç.

...
...
...
...
...

...
...
...
...
...

XHA SELIMI I KËNDON TË BIRIT SI ÇDO LUFTETARI.

Xha Selimi çdo vit në festat popullore ngrinte këngë. Kur iu vra i biri zemra e tij shpërtheu në këngën «O Hito, trimi me vulë». Këngën për të birin ai e përpunoj në vite, prandaj e gjejmë në disa variante. Xha Selimi punonte vazhdimisht me këngët e me vargjet përtak thënë gjithçka sa më të përmbledhur, përtë shprehur më mirë dufin e shpirtit të tij. Kënga përtë birin është një këngë e përvajshme. Dhimbja e të afërmve që shprehet në vargjet e këtij vajtimi jepet me një bukuri të rrallë. Këngëtari popullor vlerëson trimërinë dhe fisnikérinë e trimit, i cili bie për një çështje të madhe. Ai i këndon të birit siç i ka kënduar çdo luftetari. Këtë këngë e dëgjon edhe në gojën e shumë fshatarëve në Tërbaç, Ramicë, Brataj, Kotë e gjetkë.

Variantin tjetër «Shokë do t'ia marr një çikë», xha Selimi e ka ngritur në vitin 1958. Atëherë nxënësit e shkollës së fshatit i kërkuan t'u fliste përvrasjen e djalit e të shokëve të tij në përpjekjet kundër bandave të diversantëve. Xha Selimi e ndiente veten ngushtë në këtë bisedë. Ai donte ta bënte thjesht, por e brente diçka. Si t'i kënaqte njerëzit e sidomos nxënësit e shkollës së Bratit, që e kishin ftuar me rastin e 20 marsit, ditës së Armës së Sigurimit të Shtetit? Dhe nisi këngën.

Vargjet e saj shprehin një dhimbje me dritë të brendshme, duke mishëruar një bukuri e madhështi të rrallë.

Kurse kënga «Porosi nga xha Selimi është ngritur në maj të vitit 1963 kur Selim Hasani zbriti në Vlorë për të vënë një buqetë me lule mbi varrin e të birit. Ja tek ishte në mermér emri i tij. Babai iu ul te kryet dhe i ledhatoi yllin. Pranë ishte varri i Bako Tafilit, nipi të vrarë në luftën e Gjormit. Siç tregojnë bashkë-fshatarët, atë ditë në varrezat e dëshmorëve ishte edhe e shoqja, Safa. Ajo kur dëgjoi këngën e xha Selimit, shtoi vargjet e saj, që dëgjohen të ligjerohen në lumin e Vlorës.

U derëzeza, o djalë,
në endërr të kam parë,
sikur të keshja te gjallë,
ashtu si trimat me pallë,
erdha e të pashë varrë,
të kuqon ylli në ballë,
plumbi në sisë të kish marrë,

Në koncertin e dhënë në Sheshin e Flamurit me rastin e 1 Majit 1963, ndër më të bukurat ishte kënga e grüpuit polifonik të Bratit me titullin «Porosi nga xha Selimi», të cilën e hogi dhe e këndoi vetë xha Selimi aq i moshqar.

Një nga këngëtarët e vjetër të grüpuit të Bratit, Sefer Memë tregon: Mbaj mend që kur ngriti këngët për Hiton në vitet 1952-1960, të gjitha janë bëqur valle. Xha Selimi rrinte në mes e hidhët vargjet. Grupi i valltarëve hiqte vallen mbajtur krah më krah të njëri-tjetrit. Çdo valle ka ndryshim nga tjetra, — edhe pse ato i këndoheshin trimit Hito Selimi.

Ka kaluar një kohë e gjatë dhe ato i gjen të gjalla në dasma e festa.

... mësimdhënës i cili ka qenë Selimi, së bashku me të tjerët, u kthye në Shqipëri. Në vitin 1965, Selimi u bë pjesë e komandantit të popullit Enver Hoxha, që iu dha rangu si një kryesues i rindërtimit socializmin. Në këtë vjeçantë, Selimi u bë pjesë e komandantit të popullit Enver Hoxha, që iu dha rangu si një kryesues i rindërtimit socializmin. Në këtë vjeçantë, Selimi u bë pjesë e komandantit të popullit Enver Hoxha, që iu dha rangu si një kryesues i rindërtimit socializmin. Në këtë vjeçantë, Selimi u bë pjesë e komandantit të popullit Enver Hoxha, që iu dha rangu si një kryesues i rindërtimit socializmin.

SEЛИM HASANI DHE AMANETI I TIJ

Edhe në vitet e fundit të jetës së tij deri më 1965, Selimi s'pushoi së kenduari për Partinë, popullin, At-dheun, Komandantin e dashur e të shtrenjtë Enver Hoxha, që «na bëri me fuqi të plota», për fshatin e tij «që punon pér të ndërtuar socializmin në shkëmbinjtë e Kon-golëmit», siç thoshte në bisedë me bashkëfshatarët. Në ato vite Selim Hasani ngriti edhe këngët e njohur «Votoni sot fshati i Bratë» e kenduar në të gjithë krahinën.

Në këto vite, u bënë të njohura në dasma, festa e gëzime, sidomos këngët. «Të pëlcasin inatçinjtë», «Në Bukuresht kur u mbledhë» dhe «Të tjerë i pamë armiqjtë». Kjo këngë u kendua nga grupei polifonik i fshatit në 20-vjetorin e Clirimt, në podiumin e festës në Sheshin e Flamurit në Vlorë. Ajo bëri jehonë të veçantë pér polifoninë e qëlluar si dhe pér vargjet e goditura:

«Hrushovi, pse ë mërzitë?

Mo na erdhi pér vizitë

Na paska dashur tapitë

Adriatik e kufitë

Po Shqipëria ka bijtë

Enverin me komunistë.

Xha Selimi mbeti gjithë jetën një këngëtar i fuqishëm i ngjarjeve të mëdha politike, por edhe një këngëtar gazmori.

Në vitin 1965 në fshatin Brataj një mbesë e Selim Hasanit (që sapo ishte martuar) i lutet t'i ngrinte një këngë edhe asaj. Selim Hasani e dinte që mbesa nuk bënte byrek për të qenë, ndaj i thotë të bënte një yshmer (byrek) të mirë, se do të shkonte për darkë me disa pleq të tjera të mëhallës. Dhei nusja ashtu bëri. Sadoqë u mundua petët s'i dolën mirë. Kur po hahin Bejkoja, një fshatar, po mbytej dhe i dhanë ujë. Nusja e pyeti: — Çeço, qysh ish bërë yshmeri? Xha Selimi tèrë humor ia tha me këngë:

Çeço, qysh ish bërë yshmeri?

Holluar kartë defteri,

Si këpucë bersalieri!

U mbyt Bejkua i mjefi,

qenkej opingë zehéri.

Dhe shakaja e humorit s'po pushonte.

Në fund të nëntorit 1965, Sélim Hasani u sémur. Hapte shpesh dritaren dhe që andej mbushte sytë më të ikür me malet, fushat e lumen e Shushicës që rrithë buronjave të Kuçit, me tèrë grykën e Lumin të Vlorës. Fshatarët jo vetëm nga Brati, por edhe nga fshatrat e tjera të Mesaplikut vinin për ta vizituar. Ai si zakonisht me shaka, humor e qyfyrë ndizte bisedat në shtëpinë e tij. Në ditët e para të dhjetorit 1965 shokëve dhe të rinjve që i kishin ardhur u tha të këndonin një këngë, se i digje shpirti të dëgjonte e të këndonte si atje në festë në Vlorë a mbi shkëmbin e Kongolëmit në Brataj.

Të rintjtë iu mblodhën rreth shtratit e ia morën këngës. Ishin vargjet e asaj këngë që kishte ngritur e kënduar grupi i fshatit në Vlorë me rastin e festave:

Në male të Shqipërisë
te u me këmb' i kam gjesdisë,

së bashku me komunistë,

me flamurin e lirisë.

Bashkë me ta këndoi edhe xha Selimi.

— Të këndoftë zemra, xha Selim, — i thanë bashkë-fshatarët dhe xha Matoja që ia merrte këngës.

— Këngë paci gjithë jetën, më Partinë e Komandan-tin Enver Hoxha, — tha xha Selimi. Pastaj, filloi të këndoje një këngë tjetër, pastaj një tjetër . . .

Fshatarët që kalonin pranë shtëpisë së tij dëgjonin këngët dhe u bëhej zemra mal pér xha Selimin, që siç u duket, atyre po bëhej më mirë. Kishte kohë që plan-kun s'e kishin parë në sheshin e fshatit.

Një mbrëmje thirri të bijtë Pelivanin e Milon, e u tha:

— Dëgjoni, bijtë e babait, kur të vdes dua që varrin të ma bëni ndanë xhadesë, që sa herë të kalojnë kësaj udhe njerëz, t'i përshëndes e t'u këndo këngë.

Ky qe amaneti i xha Selimit, të Bratit. Një varr në mermer ngrihet mbi një kodër pranë rrugës automobi-listike Vlorë-Kuç, në të hyrë të fshatit Brataj. Aty shkruhet; Këngëtar i Labërisë Selim Hasani 1884-1965. Dhe, pér këtë këngëtar, shoku Enver Hoxha në telegramin e ngushëllimit që i dërgon familjes së rapsodit të shquar më 4 dhjetor 1965, thotë: «Le të jetë jeta e luftëtarit partizan, pjesëmarrësit qysh në ditët e para në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, vjershëtorit popullor xha Selimit, një shembull frymëzimi pér brezin e ri të vendit tonë.»

Shoku Hysni Kapo në vitin 1975 duke bërë një vizitë në krahinën e Mesaplikut, u ndal pranë varrit të xha Selimit, vuri mbi pllakën e mermerit një tufë me lule dhe u tha njerëzve që u grumbulluan përreth:

— Kushdo që kalon këndeje, duhet të ndalet e të përshëndetet me xha Selimin e Bratit, luftëtarin trim të pushkës e të këngës.

Pas vdekjes, Presidiumi i Kuvendit Popullor e vlerësoi me titullin e lartë «Artist i Popullit» i RPSSH më 4.5.1979. Në vitin 1966 nga Instituti i Kulturës Popullore u zgjodhën dhe u botuan këngët e tij në vëllimin «Rapsodë popullorë — Selim Hasani». Në gjurmimet e reja që janë bërë hidhet dritë e plotë mbi jetën e Selim Hasani si poet i shquar popullor. Studiuesit

tanë më në zë kanë studiuar e shkruar për jetën e kri-jimtarinë poetike të këtij këngëtari të shqar popullor. Vetë populli i fshatrave Brataj, Pilur, Kudhës, Drashovicë, Tërbaç, Vranisht, Gjorm, Lubonjë, Velçë, Smokthinë e Kallarat i ka thurur këngë, figurës së këtij artisti të shqar.

Akademia e Shkencave dhe Institutit i Kulturës Popullore vazhdimisht kanë gjurmuar e pasuruar arkivin me materialë të reja nga jeta dhe krijuartaria e këtij artisti të popullit, që mbetet aq i shqar e i nderuar në artin e bukur të poezisë popullore shqiptare. Ky është nderimi i popullit dhe i Partisë për artistin popullor.

VEÇORI TË KRIJIMTARISË POETIKE TË SELIM HASANIT

Karakteristikë e gjithë krijimtarisë së Selim Hasanit është se ajo lindi e u zhvillua si një mjet i edukimit politik, për t'i lehtesar popullit hallet kryesore të jetës që i rëndonin me shekuj në shpatulla. E mbi të gjitha, këngë e tij u bë armë e popullit për çlirimin kombëtar të tij. Ajo u përdor si pushka në luftërat kundër armiqve. Kjo flet për atë të vërtetë të madhe të artit shqiptar, që këngët janë të lidhura ngushtë me shqetësimet e popullit, me luftën për lirinë e përparimin. Shoku Enver Hoxha në letrën që u dërgon nxenësve të gjimnazit «Asim Zeneli» në Gjirokastër me rastin e '50-vjetorit të saj, shkruan: «Populli ynë nuk e ka ndarë kurrë «dyfekun me gjalmë» nga libri, shpatën nga pena, trimërinë nga dituria, luftën nga puna. Pushka dhe abetarja kanë qenë kurdoherë dy binjake në duart e popullit shqiptar, në të njëjtat llogore të luftës së tij për liri, pavarësi, tokë, të drejta e përparim.»¹

Krijimtaria e këtij rapsodi është e lidhur ngushtë me epokën kur këngët u kënduan dhe u përhapën. Gjatë Luftës Nacionallçlirimtare ato shënuan një hop cilësor në përbajtjen e tyre ideoartistike. Xha Selimi duke qenë dhe vetë partizan, sado i moshuar, pa nga afër kujdesin e Partisë për lulëzimin e këngës. Në ditët e zjarra të luftës ai pa si këngët e tij përhapeshin shpejt te shokët, bashkëluftëtarët. I dëgjonte ato shpesh edhe

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1972-1973», f. 429.

në luftës. Xhebró Gjika, një shoku i tij, tregon se xha Selimi kishte një këngë shumë të dashur për të, ajo që thoshte: «Ç'jan' këto gjyle të rënda». E kishte ngritur një mbrëmje pranë zjarrit. Një partizan nga Bolena e shkroi dhe të nesërmen u dëgjua në dy-tri grupe. Po të gjithë e dinin, atë e kishte ngritur xha Selimi. Një ditë xha Selimi po bisedonte me disa partizanë për shokët e rënë në fushat e betejës. Shumë këngë kishte ngritur xha Selimi për trimat e rënë, si Laze Nuron, Hysen Çinon, Kamber Rustemin e Resul Velin, Bako Tafilin që ishin të pranishëm në çdo pritë e në çdo shteg më shokët bashkë.

— Me ne janë dhe ata, o djem, — thoshte xha Selimi.

— I dëgjoni belxhikët e tyre? Hysen Çinua — luau, Laze Nurua — bilbil, Resul Veliu — vetëtimë. E ç'djem që qenë, të gjithë leveridë!

Të nesërmen në të gjitha batalionet e brigadës që dëgjuar një këngë. Ishte kënga e «Dëshmorëve të Mesaplikut». Në vargjet e saj thuhet: Mesaplik, o moj krahinë / të bukur trima të iknë!

Me pak fjalë jepet një luftë e tërë, një tablo e gjerë epike. Duket qartë se hapësira e këngës së tij është një libër i madh, ku lexojmë autobiografinë e popullit tonë, vështirësitë e hallet që ka pasur ai, si i ka përballuar ato me gjenialitet e vitalitet. Këto këngë që vijnë të gjalla deri në ditët tona kanë frymëzuar masat në luftërat dhe në përpjekjet e tyre pa fund përmësim politik e shoqëror. Duke vlerësuar ngjarjet e ditës në sfondin dramatik të tyre, xha Selimi nuk ka munguar të na japsed me drita të qarta të nesërmen, ëndrrat e popullit e të revolucionit. Këngët i përshkon tejembanë optimizmi, që buron nga energjitet e pashtershme shpirtërore e fizike të kombit. Poeti popullor e quan këngën e popullit «Këngë e madhe». Këtë të vërtetë ai e materializon në krijimtarinë e tij poetike. Xha Selimi, ky këngëtar i talentuar, e njihte shumë mirë folklorin e krahinës. Qindra vargje dinte përmendësh dhe t'i thoshte në bisedë e sipër, si këngët

lirike të dashurisë, ashtu edhë të dasmës, ligjet, këngët e trimërisë, të lëvizjeve fshatare të Jugut kundër Tanzimatit, të Shpalljes së Pavarësisë etj. Ai dinte po aq mirë dhe historinë e krijimit të tyre. Për ngritjen e flamurit në Vlorë, ai dinte shumë këngë. Por edhe vetë kishte ngritur po aq. I kishte lënë mbresa të thella figura e shquar e Ismail Qemalit kur e ngriti flamurin në Vlorë dhe sidomos vizita e tij në Vranisht të Vlorës. «Dua të ngre një këngë, — tha xha Selimi, — që të shikoj flamurin në të sa herë ta këndoja.» E tillë u bë kënga e tij «Flamuri në Vlorë u ngre». Në hyrjen e librit «Rapsodë popullorë — Selim Hasani», 1966, me të drejtë po-hohet: «Ashtu siç ndodh zakonisht me shumë poetë të tjerë popullorë që frymëzohen nga ngjarjet e mëdha të jetës së tyre të përditshme, po ashtu edhe xha Selimi nën entuziazmin e luftimeve heroike të epopësë së Vlorës më 1920, thuri vargjet e para.»¹

Shumica e këngëve të kësaj periudhe për çetën e Bratit, Vranishtit, Mesaplikut, Shkozës, u ngriten nga xha Selimi. Në këngët për luftën e 1920-ës «Ç'u zu dyfeku në Vlorë», «Kryetarë të mbëlidhi», «Kush ia bëri protoforrë», «Ç'ka që po rënkon Sazani», «Ç'bën, moj Shqipëri sermaja?», «Shqipëri me nám të lartë», «Një kuje nga Matogjini», del në pah karakteri i kësaj kryengritjeje, fryma kombëtare e klasore për të cilën janë ngritur e luftojnë fshatarët shqiptarë. Në këngën e tij kryengritja e madhe e popullit del e organizuar: në fillim «u mblodhën komisionet» dhe kështu me disiplinën e me përvojën e qindra viteve që populli ynë kishte fituar gjatë luftërave për dritë, liri e përparim shoqëror, shpërtheu si një duf oqeanesh. Ndryshe nga kryengritjet e mëparshme, kjo jepët në mënyrë të qartë e të vetëdiçhme, si luftë për unitetin e kombit, të Athdeut. Skena të tëra më përmasa epike zbulojnë para nesh heroikën e luftës popullore si dhe shtrirjen e saj

1) «Rapsodë popullorë — Selim Hasani», f. 4, Instituti i Folklorit, 1966.

masive, pjesëmarrjen e grave si Sado Kashena me shqipëri. Zbulohen në planin shoqërор kontradiktat klasore, urrejtja ndaj armiqve si për shembull «Kush ia bëri protoforra». etj. Këngë e tij arriti një shkallë të lartë zhvillimi. Linjat e saj zbulojnë ligjësinë e fenomeneve të zhvillimit të revolucionit mbi shtratin e elementeve të vetëdijes kombëtare. Gjatë periudhës 1920-1939 xha Selimi ngriti edhe këngë të tjera, por ato u kufizuan brenda Lumit të Vlorës. Një pjesë e tyre janë harruar. Talenti i tij shpërtheu me forcë gjatë Luftës Nacionale-çlirimtare, qysh në ditët e themelimit të PKSH. Në përmjet fjalës së figurshme të bukur ka dhënë në mënyrë sintetike e plot gjallëri luftërat përfunduese mbrojtur mëmëdhënë, gjuhën, zakonet e traditat e të parëve, dashurimë përfunduese, punën, familjen, përpjekjet përfunduese, kulturën, tokë e përparim shoqërор. Në këtë krijimtari ai ka shprehur edhe qëndrimin e tij përfundues që i kanë rënë popullit në kokë gjatë historisë; transformimet e mëdha të jetës përfunduese përfunduese natyrës të mirat materiale; rindërtimin e vendit dhe ndërtimin e shoqërisë socialiste. Ato janë historia e kënduar në vargje e popullit tonë luftëtar, punëtor dhe artist në të gjitha kohërat. Si një thirrje e fuqishme e protestës popullore janë këngët e lirikës shoqërore, satirike, kundër shtypjes shoqërore, këngët e punës përfunduese, liri e përparim shoqërор.

Duke i studiuar si grup të vëçantë, në këngët popullore të Luftës Nacionale-çlirimtare dalin në pah vetitë morale dhe motivet që i çojnë drejt vdekjes dëshmorët e heronjtë, me bindje të thellë se luftojnë e vdesin përfunduese qështje të madhe. Te figura e tyre ne shohim të mishëruar guximin e patriotizmin popullor, shpirtin e sakrificës e qëndrimin burror. Tema e Atdheut, lufta përfunduese e tij, urrejtja ndaj armiqve dhe klasave sunduese është e pranishme në shumë krijime. Lufta e klasave jepet në epoka të ndryshme, shihet e lidhur ngushtë me ndërgjegjen kombëtare, shoqërore e klasore të masave popullore. Gjatë luftës së 1920-ës ideali i popullit tonë ishte «të hidhët breshkaxhinjtë

në det», ndërsa gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ky çlirim kombëtar u gërshtua më gjërë me luftën klasore. Këto këngë i përshkoi tejembanë fryma heroike. Në to nuk ka ujë, por rrëke gjaku me të cilat janë shkruar. «Duke karakterizuar historinë kombëtare dhe shpirtin liridashës e luftarak të popullit, rapsodi me pak vargje, na ka dhënë tabanin historik të optimizmit popullor në këtë luftë kur thotë: Shqipëri, moj rrënjjëdalë, / s'pate dert nga asnjë valë, / po gjithnjë dorën në pallë. Aq, përgjithësuese e karakterizuese janë këto vargje sa mund të përdoren jo vetëm për të kaluarën, por edhe për qëndresën aktuale të popullit tonë.»¹

Me themelimin e PKSH populli ynë hallemadh, i shumëvuanjtur, dhe i robëruar, qartësoi perspektivën dhe rrugën ku duhet të ekte. Këto momente historike poeti popullor na i jep me pjekuri politike. Dashuria për Atdheun, patriotizmi popullor, jepen në lidhje të ngushtë me idealin e lartë komunist. Moj ideja komuniste, /rrofsh, mcj, rrofsh, që e bitise, / atë rrugë që e nise, / gjerman e dega fashiste, /ç'i këpüte bisqë-bisqë.

Shumë këngë me karakter politik, bartin një theks të qartë novator në formë dhe në përbajtje. Kënga bëhet shprehëse e vijës së Partisë, e luftës së vendosur të popullit tonë dhe e perspektivës së tij duke theksuar edhe më mirë karakterin e saj popullor.

Në qendër të këtyre këngëve vihet trimëria e popullit dhe ideali i tij i lartë, ditari i heroizmave dhe sinteza e mijëra akteve burrërore për botën e re, botën komuniste. Xha Selimi ngriti këngë më 1920, 1944 dhe pas Çlirimt të vendit. Në qendër të tyre spikatin tema të mëdha. Rapsodit i intereson madhorja, epikja, heroikja. Ajo ështëjeta. Prandaj edhe është e bukur dhe e dashur, prandaj edhe duhet mbrojtur. Këtë pohon poezia e Selim Bratit. Heroi lirik i këtyre këngëve shpreh ide të qarta me figura të bukurë artistike të mbrujtura me idealet më përparimtare të kohës, duke dhënë kështu edhe ndriçimin që poeti huazon nga e nesërmja. Heroi i këtyre

1) Razi Brahimi: «Kur flasim për poezinë», f. 244.

këngëve është në jetë, në luftë, në llogore, tek «këndon» me grykë pushke. Ngrohtësinë lirike e gjallërinë vitale poezisë ia mban të ndezur entuziazmi i luftës popullore partizane.

Në këngë jepet qartë p.sh. tabloja e një beteje: Moj Sirokëmba në grykë, / duman një natë e një ditë, / barut e flakë e jeshiltë ...

Sic dihet, kënga popullore i pasqyron ngjarjet aty për aty. Më vonë, duke u rikënduar, vijnë duke u arrirë gjithnjë e më shumë. Mendimi artistik kalon nga detajet në përgjithësimet, ku nuk kemi më vetëm një hero e një ngjarje autentike, por një përgjithësim artistik të ngjarjeve, një hero më të plotë si ide e dukuri historike. Hërë-hërë edhe në temat shoqërore xha Selimi jep edhe brendinë e tyre politike. Këtë gjë autor i realizon duke e shikuar të lidhur ngushtë me situatat e ngjarjet si dhe me problemet patriotike të kohës. Këtë gjë më mirë e përcaktojnë edhe karakteret shoqërore të caktuara: ballisti, gjermani, kulaku, teknokrati, burokriti, revisionisti, imperialisti. Kështu autor i duke shpalosur para nesh tablotë e luftës, jep këtë luftë klasash përmes figurash të gjallë që ndeshen me njëratjetëren nga faktet konkrete e historike që kap rapso di. Në mënyrë të qartë në shohim edhe qëndrimin e xha Selimit kur i zbulon këto kontradikta të kohës midis nesh dhe armiqve, apo edhe në gjirin tonë. Poezia popullore e xha Selimit është e mbushur me detaje ngajeta, me përvjetimin shpirtëror të këtyre dukurivë. Ai hyn thellë e spontanisht në atë që këndon. Tema e qëndresës dhe e heroikës së popullit dhë Partisë sonë është parë e lidhur ngushtë me dukuri të tjera të jetës. Dhe suksesi i parë i poezisë duhet kërkuar tek vëzhgimet e drejtpërdrejta që bën ai duke i konceptuar në mënyrë konkrete, të shkrira në ndjenjat e tij. Në një pjesë të mirë të krijimtarisë që iu përgjigjet flakë për flakë ngjarjeve, zbulohen histori konkrete të temës së qëndresës, jepet qëndrimi aktiv i njeriut ndaj luftës, punës, lirisë e dukurive të tjera. Origjinalitetin dhe bukurinë e këngëve të tij në e vëmë re së pari te konkretësia dhe ngrohtësia e tyre.

Këngët, duke na dhënë edhe kushtet historiko-shoqërore të kohës, kanë një informacion të dendur historik, ekonomik, etnografik, shoqëror. Me vlerat poetike monumentale këto këngë, duke u mbështetur në përvojën artistike shekullore të popullit, jepin modele të një mjeshterie të lartë artistike. Xha Selimi të krijon imazhe reale tek ia dëgjon ose ia lexon këngën. Përpara syve të lëvizim heronjtë epikë apo lirikë, ngjarje e tablo të heroizmit masiv, vendi, koha etj. Në këto këngë heroi pozitiv, është në qendër dhe luan rol aktiv. Një rol jo pak të rëndësishëm luan edhe informacioni në këngë, i cili të bën ta jetosh të gjallë realitetin e fakteve në epokën së cilës i takon. Pasurimi i brendisë patriotike të këngëve është dhe rritja e ndërgjegjes klasore të mësave në rrjedhën e historisë. Me themelimin e Partisë, idealet e marksizëm-leninizmit i dhanë këngës e krimtarisë popullore të xha Selimit një bazë të re ideologjike, kundërshtimin e së keqes armiqësore, në plan kombëtar e shoqëror, nga pozitat e botëkuptimit komunist. Në një këngë të xha Selimit kjo shprehet qartë tek vështrimi që hedh poeti: «...nga Partia,» se duke ndjekur rrugën e Partisë «Shqipëri e varfëra / sot ka dalë në dynja». Prandaj edhe kur kujtojn vuajtjet dhe sakrificat e së kaluarës populli është optimist, ose siç thotë rapsodi: Kur kujtojmë këto halle, / u këndojmë këngë e valle, ... atyre që luftuan dhe u sakrifikuau përlirinë dhe lumturinë e popullit.

Lartësi të reja marrin këto veti në këngët e periudhës së ndërtimit të shoqërisë socialiste. Këto janë këngë të një fushe tjetër të gjerë, ku spikatin vëtitë e larta moralo-politike të popullit tonë. Veçoria e këngës së krijuar në këtë periudhë është se xha Selimi, këtë luftë të popullit tonë, si më 1920, 1939-1944 dhe në revolucionin socialist, e shikon të lidhur ngushtë me luftën e popujve të tjerë të Ballkanit, Evropës dhe botës. Figura e Leninit dhe e Stalinit, jepen si shembull nga mëson bota. Ja si këndon ai: C'u ngrenë djemtë fjamë, / me dhëmballë e prisnin plumbë, / me dhëmballë e hanë barunë, / Enverin ndër krye vunë, / me Stalinë

ngushtë u zunë. Në disa këngë si «Xha Selimit pse s'i thatë», «Mësojnë djemtë në shkollë», «Në Bukuresht kur u mblohdhë», «Në dorë kazmë e dyfekë», «U ngeci plori në rrënjet», apo «Shokë, do zémë një valle» patriotizmi socialist shprehet në qëndrimin ndaj punës, në luftë kundër shfaqjeve të huaja mikroborgjeze e kapitaliste si dhe te heroizmi i masave të gjera për realizimin e idealeve të Partisë. Heronjtë e këtyre këngëve janë zëdhënësit e fjalës së Partisë të çliruar nga prangat e shtypjes e të shfrytëzimit, të mbrujtur me idealet komuniste, ata që qëndrojnë në llogoret e PPSH. Të rintjtë e të rejat, brezi i ri i dalë nga lufta, me po atë vrull si në luftë punojnë, të poezia e xha Selimit, në kantierin e madh të punës ndërtimtare në tërë Atdheun. E, këtë luftë e punë xha Selimi e shikon të lidhur ngushtë me luftën kundër revizionizmit titist, hrushovian e të qdo ngjyre qoftë, për mbrojtjen e ideve të mëdha të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit. Këngët e punës në krijimtarinë e xha Selimit kanë dallime rrënjesore nga ajo krijimtari që bart këtë temë në të kaluarën. Në këtë këngë, puna për të ndërtuar jetën e re ka dritë, se u këndon pesëvjeçarëve që ia zbardhën faqen Atdheut dhe ia bënë jetën pranverë Shqipërisë. Te kënga e mirënjohur dhe shumë e përhapur «Shokë, do të zémë një valle», ai thotë: Shokë do zémë një valle, / bëjmë ligj e shtrojmë plane!, / Me brigada vullnetare, / bëjmë rru-
gë, cajmë male.

Poeti popullor me pak vargje që herë-herë marrin edhe trajtë proverbiale, jep qëndresën e Partisë e të popullit tonë. Me pak rreshta, sidomos te këngët «Moj ideja komuniste», «O Parti, që u këpinte», «Partia me nam të lartë», «Shqipëri, moj rrënjëdalë», «Komandanti Enver Hoxha», «Enveri-Stalini rroftë», trajtohen faqe nga historia e Partisë derdhur në ditarin e madh të krijimtarisë së poetit. Karakteri epiko-lirk i kësaj këngë spikat në hyrje, në vargjet e para, ku ndihet optimizmi, shprehet gëzimi i masave punonjëse për ato q'kanë arritur dhe do të arrijnë.

Në krijimtarinë e popullit tonë gjatë shekujve, kra-

has luftës së tij me «pushkë» e me «këngë» pér liri, dritë e përparim shoqëror, gjemë edhe konceptet e tij pér të bukurën, të madhërishmen, komiken, të ulëtën, të shëmtuarën, fisnikën etj., të cilat theksojnë karakterin estetik të poezisë së xha Selimit. Shumë dukuri e fakte të jetës që këndon xha Selimi kanë si karakteristikë të përgjithshme të tyre skena e tablo të gjera të heroikes e të madhërishmes. Kjo e bën edhe më të pasur e më aktive brendinë e këngës. Shoku Enver Hoxha thotë: «Me shëllirë e ka ngjer kafshatën në të kalarën populli ynë, por pjetën e drunjtë e kishte të skalitur si s'ka më bukur. Ndjenja e hollë pér të bukurën dhe shija e tij e lartë estetike kanë spikatur kudo, në rapsoditë e mrekullueshme, në kostumet fantastikë, në vallet e mahnitshme, në shkrimet e rilindësve apo në këngët «rebele» e të ndritshme partizane. Shkurt, gjenia artistike e popullit tonë duket ngado që të hedhësh vështrimin, ngado që të vësh dorën.»¹

Në shumë këngë Shqipëria shpaloset në vargje me profilin e saj të bukur, madhështor; krenare, e pamposhtur ndaj dallgëve e stuhive të kohërave: Shqipëri, ç'të nxori harta, / Shkëmbej e male të larta. Kjo këngë tregon se heroikja, e madhërishmja, e bucura janë parë bukur nga poeti popullor, shtrirë në hapësirë e kohë. Populli ynë duke u ndeshur në historinë e tij shekullore me armiq pa fund e të mëdhenj qëndron «me dorën në pallë», duke u lartësuar në beteja të mëdha e të vazhdueshme. Në mënyrë më të dukshme kjo u materializua gjatë Luftës Nacionalçirimitare dhe në luftën e PPSH kundër revisionizmit. Në këto këngë Partinë, Shqipërinë e luftës dhe të socializmit, njeriun tonë (partizan apo ndërtues i shoqërisë sociale) i gjemë të mishëruar në syrin dhe mendjen e kthjellët të poetit si forma më e lartë e së bukurës, heroikes, së madhërishmes. Poeti në shumë këngë e quan Partinë «diell», «dritë», «famëmadhe». Këto epitete populli ynë i ka

1) PPSH, «Dokumente kryesore», Vëllimi V, f. 713.

ruajtur për gjërat më të shtrenjta, më të dashura dhe më intime.

Partia ngrihet si një mal i lartë përpara stuhive të kohërave të vjetra e të reja, duke qëndruar në «istikamet» e marksizëm-leninizmit, mbështetur «tek ylli me pesë cepe». E lidhur me popullin e vet si mishi me kockën, Partia u ka bërë ballë rrebesheve pa mbarim. Këtë të bukur, këtë të madhërishme e heroike na jep poeti. Pamposhtshmerinë e PPSH e të Shqipërisë ndaj armiqve poeti e shpreh: «Moj Parti, t'u shtoftë nami, / s'u tunde nga istikami ...» Dhe diku tjetër: «Shqipëri, moj rrënjosdalë, / s'pate dert nga asnjë valë, / gjithënjë dora në pallë».

Edhe pas Çlirimt, xha Selimi e quante «istikam» pozicionin e luftës së PPSH ndaj revizionizmit e imperializmit dhe këtë luftë e jep të ndriçuar nga një botëkuptimi i shëndoshë, nga idealet tona social-estetike. Poeti popullor e ka qëmtuar të bukurën në ashpërsinë e maleve, në gurgullimat e ujëvarave, në kushtimin e luftës për liri, në bukurinë e pambaruar të natyrës shqiptare dhe të jetës, që njerëzit e ndërtojnë me mendjen dhe duart e tyre. Nga ana tjetër të bukurën, xha Selimi e gjen në jetën tonë të re socialistë, në marrëdhëni e reja politike, familjare, ekonomike, shoqërore. Mbi të gjitha ajo shkëlqen te njeriu ynë i ri, i brumosur me idealet komuniste. Shoku Enver Hoxha në Kongresin e 5-të të PPSH ka thënë: «Në jetën e popullit tonë, në realitetin tonë artistët tanë gjunjë frymëzimin e krijimit, tingujt e këngës, ritmet e valles, pastërtinë e gjuhës, hovin e punës, shembullin e heroizmit e të sakrificës, virtytet e larta të tjeshtësisë dhe të drejtësisë popullore.»¹

Xha Selimi thoshte se e drejta dhe liria qëndrojnë në grykë të belxhikëve. Humbjet e shokëve në fushën e betejës për liri janë të dhimbshme, po jo kokulura nga pikëllimi. Në këngë e ardhmja shikohet plot dritë. Kjo

1) Enver Hoxha, «Raport në Kongresin e 5-të të PPSH», Tiranë, 1966, faqe 141.

i jep vlera akoma më të mëdha poezisë popullore. Heronjtë e këngëve luftojnë për interesa e qëllime të larta, «për një botë të re». Xha Selimi në shumë këngë, duke u kënduar trimave sipas ligjeve të Labërisë, na jep elementet heroike që mishërojnë ata kur bien në beteja, duke u bërë kështu bartës idealesh e qëllimesh të bukurë. Një fakt i tillë kuptimplotë është kënga për Kanan Shkozën, të cilin e merr plumbi nënofulla, e poeti i këndon: «Kanan, t'u prish bukuria» dhe luftëtari ia kthen: Ç'ka se mbeta unë pa gojë, /Shqipëria le të rrojë!

Një veçori e rëndësishme e këngëve të xha Selimit është se rënia e luftëtarëve në fushën e nderit i bën njerëzit të hidhërohen, por nga ana tjetër u jep vendosmëri për t'u hedhur me të gjitha forcat në luftë kundër armiqve. Vetëmohimi i heroit tragjik është cilësi e karaktereve heroike, të vetëdijshëm për të rënë burrërisht. Vdekja e partizanëve Hysen, Laze, Kanan, Hito, Mujdin, Mitat, Memo, Kamber, ndodh në rrëthana të caktuara dhe është e zakonshme, njerëzore. Kjo mishëron edhe madhështi, edhe bukuri. Poeti qëmton më të domosdoshmen e asaj që lufton, punon, krijon, jeton e fljohet. Pastaj këtë fakt jetësor e përgjithëson natyrshëm. Heroiken dhe të madhërishmen poeti i gjen në jetë, në luftën dhe në punën e njerëzve që e kanë kthyer atdheun në kantier madhështor. Kështu, poeti popullor, si një arkitekt i madh, na ka gdhendur në vargjet e këngëve të tij madhështinë dhe heroiken që bartin me vete Partia dhe populli.

Te këngët e xha Selimit e bukura, e madhërishmjë, heroikja bartet nga vetë njeriu ynë. Poeti popullor me mjeshtëri artistike na paraqet virtytet morale të njerëzve si bujarinë, ndershëmérinë, shpirtin e sakrificës e të vetëmohimit. Xha Selimi ishte njeri pa shkolillë, nuk dinte as të shkruante, por në këngët e tij e gjejmë të madhërishmen, të bukurën, heroiken në piedestal të vargut. Kjo ndodhi se xha Selimi, si qđo artist popullor, me intuitën e tij artistike e me forcën e fjalës që gdhend edhe gurin ditë të sintetizojë e të ngrejë në art jetën në tërë shfaqjet e saj. Populli

ynë ka krijuar këngë me një bukuri të rrallë gjatë ko-hërave. Duke ruajtur traditat si gjënë më të shtrenjtë, shqiptari i bëri ato forcë reale në jetën e përditshme, në luftën kundër pushtuesve të huaj dhe kundër klasave që e shfrytëzonin. Kjo krijimtari shërben si dokument historik, si vlerë ideoartistike dhe edukative. Këngët e luftëtarit që luftoi me pushkë e pendë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në luftërat për liri e pavarësi dhe në luftën për socializëm. «Shqiptari është trim dhe këtë e ka në gjak», thoshte xha Selimi. Këto trimëri të shqiptarit në epopenë e madhe të Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare spikatën me forcë të rrallë e vazhdojnë më me forcë sot në luftën për ndërtimin socialist të vendit dhe mbrojtjen e fitoreve të arritura. Trimëria, guximi etj., janë të lidhura me tipare të tjera si besa, mikpritja, bujaria, ndershmëria. Pasqyrimi i të gjitha këtyre cilësive në këngën popullore na jep portretin heroik të shqiptarit në periudha të ndryshme të historisë.

Në këngët e para të viteve 1920 konceptimi mbetet në një plan disi të ngushtë. Më vonë këngët e xha Selimit vijnë duke marrë një fizionomi dhe hapësirë më të gjerë. Kënga «Kush ia bëri protoforra» është ndër krimet e hershme të poëtit. Ç'forcë të madhe kanë vargjet e këngës kur patrioti Osman Haxhiu ngre shkopin dhe qëllon marshallin pushtues. Shqiptari është mësuar ta shohë armikun përballë, ndaj u drejtohet: Dil steresë e jo limanit, / Të shoq të zotët e vatanit! ... Populli «me dyfekun lidhur me gjalmë», «me bomba e me sakature», «luftë bë e armë s'pati» është mishëruar më së miri në këngë. Por ajo që u jep vitalitet e gjallëri këngëve, është njeriu shqiptar që lëviz në to, është kuptimi i tij i qartë për lirinë, tokën, Shqipërinë, Partinë, popullin. Është dhënë Shqipëria e vendosur e «trime», «yll», «dritë», që u bë «varri» i armiqve.

Në këngët e tij lartësohet njeriu shqiptar edhe në burgje, internime, pushkatime, shkatërrime që i sollën armiqtë e deri në ditët e sotme që u bë zot i gjithçkaje. Këtyre njerëzve, siç del nëpër këngë, u duhej të kapër-

cenin lodhjen, torturat, masakrat, thikën e varfërisë gjer në kockë. Dhe këto veti të larta të shqiptarëve i kanë pasur rrënjet tek ajo që ata e dinin pse luftonin e për kë luftonin. Ky është botëkuptimi i thellë i popullit tonë të shumëvuanjtur. Kjo ide merr vlerë të veçantë në kushtet e Luftës Nacionalçirimitare të udhëhequr nga Partia dhe del qartë, ndërmjet të tjerave, edhe te kënga: «Lufton Partia bajrake, /Të madh guxim që pate, / Moj e shkretë pse s'u prapse?» Sa e vendosur që Partia për të luftuar e për të fituar mbi armikun! Dhe vargjet marrin ngarkesë të madhe emocionale, kur tregojnë se Partia e çoi deri në fund vendimin e marrë për Shqipërinë e lirë. Për këtë ideal ajo ngriti në këmbë gjithë popullin. Liria nuk dhurohet por fitohet me gjak. Të kesh besim në luftën me armikun, do të thotë të jesh i guximshëm, i disiplinuar, gjakftohtë, me botëkuptim të shëndoshë, të dish pse lufton e për kë lufton. C'është më e rëndësishmja, në këngët e xha Selimit njeriu shqiptar na jepet me pikësynime të qarta dhe me vullnet të fortë. Ky pikësynim përcaktohet nga bindjet që i ka rrënjosur Partia. Vendosmëria dhe këmbëngulja jepet në vargjet: Komuniste do ta kthejmë, / Ja themelet do kërrejmë. Partia dhe figura e saj jepet në një cikël këngësh që nga lufta e deri në ditët e sotme.

Moj Parti, t'u shtoftë nami, / S'u tunde nga istikami!

Gjatë gjithë kohërave populli ynë këngët, shakatë dhe romuzet i ka përdorur me sukses. Letërsia dhe arti përparimtar revolucionar i popullit tonë kanë dhënë në një plan të gjërë e të thellë ndeshjet e forcave të progresit me ato të regresit dhe triumfin mbi këto të fundit. Rol të madh te ne kanë luajtur, sidomos në kohën e pavarësisë e më vonë gjatë Luftës Nacionalçirimitare, veprat satirike e humoristike. Elementet e para të humorit dhe satirës të Selim Hasanit duhet t'i kërkojmë në radhë të parë në mjedisin e fshatit e të krahinës, ku muhabetet, shakatë e bisedat bëheshin «me të qëlluara», «me të grishura» e «të shpuara» pra, siç thoshte vetë rapsodi: «Njerëzit e këtyre anëve thumbonin gjithnjë

njëri-tjetrin dhe kështu ata nxirrnin në dritë mendimet e tyre për jetën, hallet e dertet.»

Në sytë e rapsodit xhandari dhe taksidari i rrëmbyen një fshatareje tri pulat e vetme që kishte në qymez, sepse ajo nuk kishte me se të paguante taksat. Rapsodi ia qëndisi aty për aty vargjet:

*C'do na thotë Hanko zonja,
që s'ka as pula, as zoga,
një samar me katër dhoga,
ta mbaj mbi vete Nikolla?*

Ja si e qesëndis ai Nikollën, taksidarin, duke nxjerrë nga ana tjetër edhe realitetin e jetës së fshatit të atë-hershëm. Shumë këngë të Selim Hasanit të bëjnë të qeshësh mendueshëm sepse e qeshura, ironia, tallja, sarkazma janë dhënë sa thellë, konkrete, aq dhe me finesë. Në to nxjerrin veten e vetëdemaskohen qehajai, fajdexhiu, tregtari, politikani, dallkauk, tradhtari, push-tuesi, ballisti, syleshi, gjithë ata që së bashku krijojnë një galeri tipash negativë të humorit dhe të satirës sonë. Prandaj dëgjesi i këngës së xha Selimit i beson rapsodit për të gjitha ato që thotë, edhe kur godet keqas dhe me fjalë të rënda, sepse ai është i singertë dhe i besueshëm.

Ajo që duhet theksuar më shumë për satirën dhe humorin e xha Selimit është se atë e karakterizón prirja për trajtimin e problemeve të rëndësishme të jetës politiko-shoqërore. Humori në këngë popullore si «C'bëjnë inglizi e Amerika», «Moj Parti, me luftë e tundë», «Gjemon Kuçi e mali Brate», «Kush ja bëri protoforra», «Dërgon Titoja spiuënë», «Lufta e 1920-ës», tregojnë se klasat reaksionare kanë qenë objekt i parë i satirës popullore. Elementi satirik përshkohet të gjithë shtratin mbi të cilin qëndron kënga. Poeti popullu përcakton edhe fatin, kur u thotë se pas lufte:

«Me dhën e me dhi do shkoni, /me bucela do ngarkoni,/ në mos u «mbegin këmishat shkarpave / si në gry-kën e Gjormit».

Lufta Nacionallirimtare vuri përballë vegjelinë, të udhëhequr nga Partia, dhe në batakun e tradhtisë pasanikët, shtypësit që u mbështetën te fashizmi.

Rapsodi na i jep bejlerët dhe agallarët me siklet, ndërsa popullin të gjëzuar e të gjallë. Kjo shpreh më së miri ndërgjegjen klasore të popullit tonë. Lufta Nacionallirimtare e poqi edhe më shumë humorin dhe satirën e rapsodit. Për këtë dëshmojnë edhe një sërë historish që tregojnë bashkëfshatarët e rapsodit e bashkëluftëtarët e tij. Në shumë këngë, me një humor të hollë e të mprehtë, ne shohim edhe qëndrimin e prerë të rapsodit. Në këngën e tij shkrihet motivi politik me motivin shoqëror. Kështu ai jep paralajmërimin përfatit e përbashkët të shtypësve, shfrytëzuesve dhe fashistëve. Duke e parë në gjerësi humorin e satirën në këngët e rapsodit ato janë siç thoshte vetë xha Selimi: «belzhiku ynë për të vënë në shenjë të keqen dhe të këqinjtë». Në humorin, satirën e sarkazmën e poetit popullor, ku fshikullohen veset e këqija, klasat shfrytëzuese, morali borgjez, autori mban qëndrim të hapur ideomocional. Pas Çlirimtës ai i forcon këto karakteristika të humorit dhe të satirës me cilësi të reja, me pohimin e gjithanshëm të realitetit socialist.

Në krijimtarinë e xha Selimit kumbon një tingëllim i fuqishëm poetik. Ai ka individualitetin e tij, ka zërin e tij në rrjedhën e gjerë të krijimtarisë së popullit tonë. Kënga popullore e xha Selimit është përhapur e dashur dhe e fuqishme. Ajo ruan karakteristikat e këngës historike tradicionale, sintetike në paraqitjen e ngjarjeve, me një gjuhë të bukur e plastike, me vargje të skalitura e elemente të mirëfillta poetike. Atij i derdhet figuracioni popullor me një mjeshtëri të rrallë. Vetëm në pak vargje di të japë një tablo të gjerë e të thellë ngajeta dhe realiteti. «Moj Parti, t'u shtoftë nami, / s'u tunde nga istikami .. Ose: Lëvon topi, tundi dhënë, / populli maleve mbenë.

Dhe diku tjetër poeti thotë: Vate more shokë, vate / u nda bota në dy kampe, / njëri luftë e tjetri

pae... Rapsodi Selim Hasani është mjeshtër i pëndo-
rimit të figurave, sidomos të krahasimeve, metaforave,
epitetave, përsërityes së vargut, personifikimeve, simbo-
leve. Këto figura s'janë stoli, por e bëjnë poezinë të tin-
gëllojë me zërin e thellë njerëzor. Kështu, kemi epite
e personifikime të goditura si: moj parti, q'e zure
prima!...; ç'bën moj Shqipëri *sërmaja*...; Shqipëri,
luleburbuqe; Shqipëri, *baçja me lule* / rrofsh, moj,
rrofsh që *s'u përule!*...; o flamur i kuq me vija, / ti
me zhgabë e na më yja. Duke shfrytëzuar në mënyrë
krijuese këngët popullore të mëparshme, gjuha e xha
Selimit është më vepruese sidomos në vargun tete rrokësh,
ku fjala merr një tingëllim aq të fuqishëm. Më jnë
fuiten e tij xha Selimi shikon shprehjen e vetëtimave
dhe jep paralajmërimin për të ardhmen.

Xha Selimi thoshte shpesh së këngët duan themelë
të forta se përndryshe i kanë ditët të shkurtra. Dhe
themelet e këngëve të xha Selimit ishin të tillë, ndaj
këngët rrojnë e këndohen nga brezat e do të këndohen
edhe më vonë. Në plenumin e 15-të të Komitetit Qen-
dror të PPSH më 26 tetor 1965, shoku Enver Hoxha,
duke këshilluar disa muzikantë që ta mbështetin muzi-
kën në krijimet më të arrira, thotë: «... populli vetë i
ka vënë në muzikë dhe i ka kënduar me shekuj vjershat
e xha Selimëve ...»¹ Këngët e xha Selimit, që janë
kaq të përhapura në popull, ndikuan edhe më vetë
zhvillimin e folklorit duke e çuar atë në një fazë të re,
më të lartë, të zhvillimit ideoartistik. Si mjeshtër t'vër-
tetë Selim Hasani ishte dhe punoi për shtratin polifonik
të këngëve e të melodive të tyre. Për të konkretizuar
dunën e palodhur në këtë drejtim po marrim vetëm
këngën «Moj Mavrovë e Drashovicë», e cila është e për-
hapur në 107 fshatra të Shqipërisë. Ajo shquhet për një
melodi burrërore, luftarake, heroike. Karakterin e ven-
dosur luftarak e heroik të melodisë së «marrësif» e yazh-
don dhe e përforcon ajo e «kthyesis». Është permbaitja
e re që e detyron solistin e dytë, «kthyesh», të fillojë

¹⁾ Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 218.

mëlodinë e vet kur «marrësi» sa e ka filluar mendimin. Të filluarit e shpejtë të këngës prej solistik të dytë përbën mbështetjen në një anë të tillë të formës së traditës që duket, mund ta shprehë më mirë këtë përmbajtje. të re.

«Edhe në këngë, artisti Selim Hasani ka përdorur elemente të kësaj traditë — ai këtu ka shfrytëzuar karakterin epik të valles labe, duke na dhënë në këtë mënyrë në këngë tip-valleje burrërore, të fuqishme e luftarake. Përmbajtja e re ka diktuar edhe një strukturë forme përshtat saj, insistimi tri herë me radhë mbi fjalën «Moj Mavrovë» krijon tri bloqe emocionale të një épizmi heroik-luftarak me një rritje graduale të emocionit.»¹ «Kënga e xha Selimit vajti kaq vite dhe është e gjallë. C'e bën atë të gjallë? Se kënga e shqiptarit ka qëndruar si ai në rrebeschët e shqotat. Prandaj kënga duhet parë e lidhur ngushtë me jetën dhe fatet e rapsodit dhe të popullit të tij.»² Po kush mund të flasë më mirë për një këngëtar populor si Selim Hasani, se sa vetë poezia e tij?

1) Spiro Shituni, «Figura e partizanit në këngët popullore», Nëntori 8, Tiranë, 1979.

2) Shënimë të nxjerra nga një bisedë e shokut Hysni Kapo, më 21 qershori 1979.

NGA KRIJIMTARIA
E SELIM HASANIT

АМЕРИКА
ТИНА МИЧ

Ç'BËN MOJ SHQIPERI SERMAJA

Ç'bën, moj Shqipéri sermaja,
qysh të qirti haritaja?
gjithë brigje e gjithë maja,
të mbuloi katanaja,²

të shoi topi e murtaja.

Pse nuk t'u shua davaja,
që kur është zënë dynjaja??

Lufton shtetet e mëdhaja,
se kërkon flamur' e saja.

Çuditetë gjithë bota
që bën luftë me Evropën;
s'pate mitraloz' e topat,
s'pate kredharakë flillata.

FLAMURI NË VLORE U NGRE

Më dymbëdhjetë sene
flamuri-në Vlonë u ngre,
me shkabënë Skënderbe.

1) harita-jas: harta gjeografike.
2) katana-jas: balloni; këtu aeroplani.

Pesëqind vjetë ku qe?

— *I kishnë vënë perde.¹*

— *Kush e qiti shiqare?²*

— *Ai plaku hallev,*

patrioti Smail Be;

me gazeta nënë dhe

me shokë nja dy a tre.

Mbretit vajte e i the:

— *Dua sha përmbylqe,³*

do të hap një modë të re;

do vë lule një bahçe!

— *Unë të shoh ç'mëndje ke*

po, sa të mund, do të çkre

Ç'U ZU DYFEKU NË KOTË

Ç'u zu dyfeku në Kotë,
top e mitraloz i fortë
Ç'u vranë ca djemtë zotë
Ziguri⁴ me smokthinjotë
Kanan Mazja⁵ djalë i sorrë
ç'e mori plumbin ndë gojë,
për gryke ç'e zuri topnë,
ç'ja rëndoi këmbë e dorë.

1) Me kuptimin e figurshëm: e kishin lënë në errësirë.

2) shiqar-e: haptazi. Kush e nxori në drithë?

3) ylqe-ja: mbretëri.

4) Zigur Lelo, Hero i Popullit nga fshati Smokthinë i Vlorës, komandant çete në luftën e Vlorës të vitit 1920.

5) Kanan Mazja, Hero i Popullit, nga fshati Shkozë i Vlorës, komandant i çetës në luftën e Vlorës të vitit 1920.

KANINA NËN KALA

Kjo Kanina nën kala, i cili
ç'u ndodh vendi me xhefa,¹
ç'i qëllon halla-halla;² qëllat që
topi vreshtave mëdha;³ që
— Kush u hodh tütje në ta bëj,
Deli Begiri⁴ me ca;
edhe Alim Cania,⁵
Brataj, Memo Meteja.
Dolli vetë Bozua,⁶
vuri dylbitë e pa.
E shkreta kjo kaza,
të bukur trimë që ka!

SELAM MUSA SALARIA

Qysh e mori historia
luftë e Italisë së parë,
ç'u fitua Shqipëria,
hëngri shumë shqiptarë.
Selam Musa Salari⁷

1) Xhefa-ja: vuajtje, mundime.

2) Deli Begiri nga fshati Gumenicë, ra qëshmor në luftimet përmarrjen e kalasë së Kaninës, në Luftën e Vlorës të vitit 1920.

3) Alim Canoja, luftëtar i shquar në Luftën e Vlorës të 1920-ës.

4) Bozoja (Ulise Bozio), agjenti i ministrit fuqipotë të qeverisë së Romës, për të përcarë radhët kryengritëse në Luftën e Vlorës të vitit 1920.

5) Selam Musai, Hero i Popullit, nga fshati Salari i Tepele-nës, një ndër udhëheqësit, e shquar legjendare të Luftës së Vlorës të vitit 1920.

të dy me Dule Dalanë,¹⁾
 në Qafë²⁾ ju bë pusia,
 në ulli përmbi spitalë,
 ç'i vrau artileria,
 të dy bashkë me një djalë.
 Selam, të qajnë fëmja:
 Ç'e gjeti Selam Musanë!?
 Qajnë gjithë miqësia
 të zon' e kalit me shalë.

QAJ, MOJ VLORE RRËNJEDALE

Qaj, moj Vlorë rrënëjëdalë,
 qaj për Ismailë Qemalë,
 ngriti flamurin me shkabë,
 si e ngriti ashtu e lanë.
 Ca godoshë, endresanë,³⁾
 me cifligje me dyqanë,
 prandaj e shitën vatanë,
 prunë Duçen, italianë,
 na zuri Pashalimanë,
 me topa mbushi Sazanë,
 po ia muarr djemtë tanë,
 pöpulli, bujqë e çobanë,
 Enveri me partizanë.

-
- 1) Dule Dalani nga fshati Dhëmblan i Tepelenës, bashkëlindi të tari i Selam Musait, u vra në sulmin e përgjithshëm për qërimin e Vlorës në vitin 1920.
 2) Qafa e Koçikut mbi qytetin e Vlorës.
 3) endresanë: interesaxhi.

Ç'KANË MÄLET QË GJEMOJNË

Ç'kanë malet që gjemojnë? Partizanët po luftojnë, në male pa bükë rrojnjë, pa opinga udhëtojnë, vritten e ngërënë shoshojnë, s'kishin me së t'i mbulojnë. Nëpër shi e nëpër bërë, ca pa këmbë e ca pa dore, s'kish spitale që t'i shtrojnë, as doktorë t'i shërojnë, Nënrat i qajnë, i vëjtöjnë, edhe rrugëve vështrojnë, mos u vinë t'i ndërrojnë, që t'i qepnë t'i andrójnë, bukë e gjellë t'u dërgojnë.

PARTIA PO NA MBËLEDH

Shqipe, t'u qasnë në lëth, gjermania nga të erth?

C'ta rrethosi rréth e rréth! Partia po na*mbëledh:

— Mo trëmbi se do ta heth!

Do luftojmë me ullinet, djem e vajza me dyfek,

me murtaja breg më breg.

U derdh gjaku u bë pellg!

Pasaniku ná u prek,

Komunizmi ná u qép!

1) Këtu me kuptimihi: të mbështetur pas murit, të zënë ngushtë.

NJËZET E TETË NËNTORI

Njëzet e tetë nëntori,
dita që bëhej festim, që jashtëzakonisht
doli një studentë foli:
— O shqipetarë, ku jini?
Qysh erdh dita që duronzi s'arran
flamurët pse nuk i ngrini?
— I ngrini po pushkatohi,
është urdhër nga Musolini!
— Barbarë, mo na shtrëngoni,
se shqiptarët i njini!
Mos thoni se da fitoni,
se kockat në vend do lini!
Filloi revolucioni!
U vra Qemal Stafa, trimisë

LUFTA NË DYZET E DY-NË

Lufja në dyzet e dy-në,
gjithë bota u habinë,
gjith'u dogjnë e u çzhurinë.
vranë shoshojnë e u grinë,
komunisti me zengjinë
— C'jemi na, cili je ttnë?
— Këto lulë ngalna mbinë?
U lidhë djemptë me Partinë,
«Vdekje fashizmit» thërrisinë.

1) Më 28 Nëntor 1942 në Vlorë u organizua një demonstratë kundër pushtimit fashist në krye të së cilës qëndronin komunistët e qarkut të Vlorës.

2) Aludon për Luftën e Vlorës të vitit 1920.

KUSH QE TIMONI, DREJTIMI

Hysni Kapo, Hysni trimi,
komunist që nga fillimi.
Kush qe timoni, drejtimi?
Enveri mendjefloriri,
që atë ditë që u bë betimi,
ditën që u bë Thëmeli.

E TUNDE, PARTI, E TUNDE

Shqipëri, baçja me lule,
rrofsh, moj, rrofsh, që s'u përule!
E tunde, Parti, e tunde!
Përpara si pak enzurë,
me ca të rralla kobure:
ca prita, ca mina vure,
me djemtë e vajzat si nure,
ato që mbathnë poture,
me dyfek, me sakature,
me opinga prej lëkure.
Ballistat që mirrë çuje,
tok me gjermani përzurë.

ME 24 MAJ

Me njëzet e katër maji,¹
gjithë Europa e dëgjoi:
Kongresi Parë filloi.

1) Më 24 maj të vitit 1944 u mbajt Kongresi i Përmetit.

O shokë, kush e besoi?
Ato pika që kërkoj,
Enveri i rregulloj,
divizionet i formoj,
Shqipërinë e çlitoj,
tradhëtarët i qëroi,
i lidhi, i pushkatoi,
popullinë e shpëtoi.

SHQIPERI, SHKËMB E GURË

Shqipëri, shkëmbenj e gurë,
kështu ka qënë qëkurë,
vrite, prite për flamurë,
bota hiq e tinë vurë,
Europa lësho, ti zurë.
S'vijnë po i kishnë prurë,
ca' bejlerë ca-barunë,¹
me pallavra nà këpunë...
Kërkoje shkoll' e s'të funë,
të kishnë lënë ndë gjumë.
Ç'ju ngrenë djemtë fyatunë,
të pabuk'e të pagjumë,
me dhëmball' e prisnë plumbë,
me dhëmb'e hajnë barunë,
Enverë në krye vunë,
me Stalinë ngushtë u zunë!

1) barunë — këtu me kuptimin: të pasur.

C'U MBUSH SHESHI ME DËSHMORE

C'u mbush sheshi me dëshmorë, Kucbaba¹ për mënë. Vlorë, me flamurën e me kurorë, me tabella me shkronjë, emër për emër këndojnë, janë ata që u përpojnë. Gjaknë të mos ha harrojnë, të prasmit të trashëgojnë.

DYZET E GJASHTË SENEJA

Dyzet e gjashëtë seneja, tashmë për ç'u formua Asambleja:² — Ktheja, moj, prej balli ktheja, çkule derrë nga soleja, ata që s'ua kish mideja. Ishn'ata që bëjnë grënje, përpiken, po s'kanë c'bëjnë, u ngeci plori në rrënje, e kërkojn'endouta gjejnë.

1) Vendi ku janë vendosur varrëzat e dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të rrethit të Vlorës.
2) Asambleja Kushtetuese, e cila ishpalli Shqipërinë Republikë Popullore më 11 janar të vitit 1946.

QASI, SHÖKE, TË KËNDONI

Qasi, shökë, të këndoni,
erth' ajo që dëshironi!
Hapni krahet të punoni,
tokënë ta lulëzoni;
armikun ta kundërshtoni,
Enver Hoxhën ta nderoni,
me shekuj ta trashëgoni.
Po të parat mos harroni.

MOJ PARTI, QYSH E FILLOVE

Moj Parti, qysh e fillove,
të bukur pllane punove,
fshatarëtë qysh i xgjove?
I mblodhe, i këshillove;
Me dyfek e me revole,
në sulme me bomba dorë,
pa pozicion, pa llogore.
Enverin në krye naxore,
hapi ligje, irregullore.
Në Paris¹ kur e kërkove,
rrofsh, o djalë, na nderove!
si bilbili kuwendove,
dëshmorëtë s'i harrove,
me numër i numërove.

1) Është fjala për Konferencën e Paqes që u zhvillua në Paris në vitin 1946.

MOJ MÄVROVË E DRASHOVICE

Moj Mavrovë e Drashovicë,
ç'hatë bërë atë ditë?
me topa me alitrikë,
seç e bëre natën ditë.
Bomb'me bomb'e thik më thikë,
Hysni Kapua petrit,
përmbi tela ç'u vërtit.
Gjermanë në gju' ç'u flit:
— Dörzoni, more jezitë,
s'ke parë djemtë e Shqipërisë,
me jekë e pa këmishë,
i marrin plumbat në sisë!

BILBILI ME GJUHE SHUMË

Bilbili me gjuhë shumë,
pse s'këndon po qan, o lumë?
Për ata djemtë fjetunë;
me dhëmballë e presin plumbë.
Për ata djemtë levendë,
vanë në luftë e s'u kthetë.
Luft' e Dytë botërore,
të bukur trima që more,
një nga një me dorë i zgjodhë.

NATËN LUFTE, DITËN MALIT

Natën luftë, ditën malit,
Shqipëri zemrëstërrulli,
ç't'u vranë një radhë djali:

*Hasim¹⁾ re Dervish Hekali,²⁾
Hysen Çinua rrënëjëdali,
dhe Perlat³⁾ qafëkuqali
ç'u sos në Shkodër i pari.
Dëshmorët e Shqipërisë,
të mirë qenë të gjithë,
i dhanë jetën lirisë.*

VOTON SOT FSHATI I BRATE

*Voton sot fshati i Brate,
të madh gëzimin që paske,
votat si belxhik i mbajte.
Shqipëri, ylli që ndrit,
Partia ty të jep dritë.*

DRASHOVIC BEHET FESTIMI

*Drashovic bëhet festimi,
vjen një lajmi nga sigurimi;
— Të flitetë Xha Selimi,
se i ë vrarë i biri!
Dhe kur vate xha Selimi,*

1) Asim Zeneli, Hero i popullit, nga fshati Progonat i Kurveleshit. Ra në betejën që u bë më 2 korrik 1943, në grykën e Mezgoranit kundër forcave fashiste.

2) Dervish Hekali, Hero i Popullit, u vra trimërisht në luftimet që u zhvilluan kundër forcave gjermane në Kuç të Kurveleshit më 12 prill të vitit 1943.

3) Perlat Rexhepi.

plot me gjak mbushur qefini.
— Dua ta shoh pa ma bini,
vetëm një të falë kini,
në dëshmorë të ma shpini,
nga Kallarati Mumini,
nga Tërbaçi Aredini,
atje dhe Bako Tafili,
tek Laze gjuhëbilbili,
Vlorën kundruall ta kini!

NË FILLIM KUR BËMË BETË

Në fillim kur bëmë betë:
— Ja ashtu si duam vetë,
ja po themeli përpjetë,
Enver Hoxha s'ka të metë,
qiti popullin në jetë,

SENEJA MË PESËDHJETË

Xha Selimi plak i vuar¹
i plagosur, i mësuar,
në Tiranë kish qëndruar,
nga populli i dërguar,
delegat për të votuar.
— Pa llafos, ç'na ke dëgjuar?
Marshalla, ç'ish rregulluar!

1) Në maj të vitit 1950 rapsodi populor Selim Hasani qe dërguar në Tiranë delegat nga Vlora për të votuar në zonën elektorale 108, ku u zgjodh deputet shoku Enver Hoxha.

*Me pllanëra lulëzuar!
Me Komandantin takuar,
shumë na ka pérnderuar,
tosk' e gegë të bashkuar,
jemi puth' e pérqafuar,
ka llafosë e këshilluar,
na përccoli të gëzuar,
me jetë të trashëguar!*

NË BUKURESHT E FILLOVE

*Në Bukuresht e fillove
lule, o shoku Enver!¹⁾
Hysni Kapon e mësove,
Hrushovin ta demaskoje,
lakërat në shesh ja nxorre
dhe marksizmit i qëndrove,
si trime, si kaçandone.*

1) përsëritet pas çdo vargu.

Dekret mbi dhënien e titullit «Artist i Popullit»

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË

I JEP

(Pas vdekjes)

SELIM HASAN MINGËS

Titullin

«Artist i Popullit i RPSSH»

Rapsod i shquar, këngëtar zemërziarrtë dhe vjershëtor popullor, në krijimet e tij i këndoi trimërisë le gjendare të popullit shqiptar në luftë për liri e pavarësi kombëtare.

Tiranë, më 4.V.1979

Dekret Nr. 5897

PASQYRA E LËNDËS

Telegram dërguar familjes së patriotit Selim Hasani (Brataj)	3
Nderim Selim Hasanit	5
Mqediset ku u rrit Selim Hasani dhe kënga e tij	11
Selim Hasani, në Luftën e Vlorës të vitit 1920	21
Vuajtjet, hallet e luftërat në këngë	26
Një këngë në burgun e Bratajt	31
Në betejën e Drashovicës, dhe në spitalin partizan të Ramicës	35
Xha Selimi dhe nipi i tij, Bako Tafli	40
Luftojmë që e bukur të na bëhet kënga dhejeta	43
Partizan në Brigadën V Sulmuese	47
Në Operacionin armik të Qershoret 1944 dhe «Epopeja e Bällit Kombëtar»	51
Në vitet e para të Çlirimit të vendit	56
Net gushti të vitit 1948	59
Xha Selimi dhe malësori i Hotit në Maj të vitit 1950	63
Ditë festë në Drashovicë	68
Xha Selimi i këndon të birit si çdo luftëtar	76
Selim Hasani dhe amaneti i tij	78
Veçori të krijimtarisë poetike të Selim Hasanit	82
<i>Nga krijimtaria e Selim Hasanit</i>	99
Dekret mbi dhënien e titullit «Artist i Popullit»	115

Gaçe, B.

Xha Selimi i Bratajt. [Red.: A. Shehu, N.
Muçaj, T., «8 Nëntori», 1986.

...f. me il.

(B.m.): 398.8(092)

+ 92:398.8 [Hasani, S.]

(B.v.): 398.8(092)

+ 92 : Hasani, S.

H 29